

Petraq Kolevica

***Lasgushi
më ka thënë...***




Sulit

dhe

Mimit

Per kujtim

Babi



, 27.10.92

LASGUSHI MË KA THËNË...

(SHËNIME NGJA BISEDAT ME
LASGUSH PORADecin)

Redaktore: Frida Idrizi

LIBRARY
UNIVERSITY OF ALABAMA

Kopertina: Besnik Trungu

PËRMBAJTJA

	Faqe
— HYRJE	» 5
— Lasgushi në kujtimet e veta	» 15
— Lasgushi për artin dhe poezinë	» 67
— Pranë poetit	» 149
— «Kamadeva»	» 175
— Lasgushi njeri	» 189
— Të tjerët për Lasgushin	» 209

1111/1011

1011

1011

1011

1011

1011

1011

1011

1011

1011

HYRJE

Kam bërë një gabim që letërsia dhe kultura shqiptare s'duhet të ma falin.

Pata miqësi pothuaj dhjetëvjeçare me Mit-rush Kutelin.

Ai-mjeshtër i njohur, në moshë të pjekur. Unë — një djalosh i ri që vraponte pas muzave, por që ai, me zemrën e tij të madhe, gjithmonë më ngrinte e më vinte pranë, në vendin e shokut.

Kam kaluar plot orë të bukura e të vlefshme, në atë dhomën e tij të vogël me një tavolinë në mes përplot me libra dhe me makinën e shkrimit...

Tek ajo dhomë gjendej edhe për mua, përherë. një karrige e lirë. Vija shpesh. Me aq sa gjykoja atëherë edhe rezervohesha në vizitat, se e dija që do t'i merrja nga koha e vlefshme, kohë që do t'ia hante pastaj natës dhe gjumit. Megjithatë, dëshira e zjarrtë e zemrës për të qenë pranë tij, për ta dëgjuar, ma mundte gjithmonë arsyetimin e ftohtë, se kush e kapërcente prakun e asaj dhome të vogël, kur dilte që atje, dilte me krahë!

Ai njeri i lodhur nga jeta, i plakur pa kohë, i ngarkuar pa masë me punë e i sëmurë, ku e

gjente tërë atë forcë për t'i frymëzuar të tjerët me idealin e madh të punës krijuese?

Pa le sa madhështore dhe e shndritshme bëhej ajo dhomë e vogël kur rastiste të vinte aty plaku i urtë, patriarku i pedagogëve të Shqipërisë, profesor S. Papakristo, që sillte me vete të gjallë, të tërë botën e bukur dhe heroike të lashtësisë greke!

I lumtur jam që kam jetuar disa nga çastet e ritit solemn në atë tempull të kulturës...

Në atë dhomën e vogël në dimër, apo nën hijen e manit të bardhë në oborr, në verë, kur i dërgonte fëmijët në Pogradec, rrinim e bisedonim gjatë. Po më mirë të them: ai rrëfente e unë dëgjoja. Rrëfente duke pirë kamomil e lule bliri dhe një grusht me barna për të ulur tensionin arterial, por nënqeshja nuk i hiqej nga buza dhe zërin e kish gjithmonë të butë e të ëmbël.

Ato biseda ishin vetë bota e artit, por nga gjithë sa kam dëgjuar prej gojës së tij, nga shprehjet, nga tregimet e larmishme, ku dilte në pah kultura e gjerë, thellësia e mendimit, humori i hollë, atdhedashuria e madhe, zemërbutësia e tii e pashoqe, nga gjithë këto s'kam mbajtur asnjë shënim.

Ja! Këtë gabim kam bërë.

Isha i ri, kujtesën e kisha të patronditur, mbi të gjitha s'e prisja ta humbisnim Mitrushin aq shpejt.

Me Lasgushin ndodhi ndryshe.

U njoha me të në atë vit që pata njohur Mitrushin, por atëherë Lasgushi m'u duk shumë

plak dhe i sëmurë. Frika e humbjes së tij të shpejtë ma rriti dëshirën të mbaja shënime nga bisedat me të dhe të ruaja korrespondencën që, nëpërmjet tyre, ndonjëherë, të hidhja një dritë më të qartë mbi këtë figurë të dashur e të veçantë të poezisë sonë.

Vit pas viti u grumbulluan plot bukurira të cilat po i rendit sot para jush i bindur se s'do të kaloni përmes tyre si vizitorë të ftohtë.



Si gjithë të rinjtë e kohës sime, që i joshte muza, edhe unë, vjershat e Lasgushit i dija përmendësh që në vitet e para të gjimnazit. Shpesh ngjitesha lart, në dhomë, në katin e dytë dhe i lexoja me zë që të më ngopnin.

Në atë kohë, në Korçë, unë nuk e dija rronte e s'rronte Lasgushi. Disa fragmente të përkthimit prej tij të «Eugjen Oniegin», që u botuan në «Literatura jonë» (Nr. 1/1952) më entusiazmuan se më thanë që ai rronte dhe ma shtuan dëshirën për ta njohur, po ku? Si? Një shoku im atëherë kishte dëgjuar nga të tjerë dhe më tregonte se Lasgushi na qënkësh me flokë të bardhë, se na mbajtk një kostum të bardhë e bastun dhe se s'pranoka të përkthejë më shumë se një varg në ditë.

Mirë bën — thoshim ne — prandaj e paska përrë kaq të bukur letrën e Tatjanës!

Me këto të dhëna unë e ndërtoja në ima-

gjinatën time, ashtu si më pëlqente, figurën e Lasgushit.

U bënë gati tridhjet vjet njohje me Lasgushin, por sa herë mbyll sytë dhe përpiqem ta kujtoj, gjithmonë më del përpara jo pamja e vërtetë, por ajo figurë imagjinare, e idealizuar, e përfytyrimit tim të atëhershëm.

Sa mirë! Kështu i kujtofshi dhe ju njerëzit e dashur, të idealizuar! Jo të rënuar e të dërmuar nga pleqëria, sëmundjet dhe brengat.

Për shumë vite Lasgushi më mbeti i dashur e i afërt me vargjet, ndërsa si njeri, i mbështjellë me një aureolë të shndritshme adhurimi, ishte i largët po aq sa dhe Fan Noli.

Pesë vjetët që kalova në Institutin Politeknik, në mes të mësimëve dhe vizatimeve inxhinierike, u rrukullisën rrëmbimthi si një masë amorfe ngjyrë hiri. Herë-herë kjo masë e hirtë ndriçohej kur muza më zgjonte e më vinte të thurja poezi, por edhe ajo muzë ishte e drojtur dhe s'guxoi të më fuste nëpër dyert e rretheve letrare të kryeqytetit.

Lasgushin e njoha në vjeshtën e vitit 1958.

Kisha mbaruar Fakultetin e inxhinierisë, kisha grisur fletoren me poezitë e mia, të para dhe sa pata filluar përkthimin e «Demonit». Punë, plot. Ëndrra, plot. Dëshira, plot. Entuziazëm, plot. Këtyre iu shtua edhe një gëzim. Gëzim i përzierë me dhimbje. Kjo, ishte njohja me Lasgushin. Po këtë më saktë do ta përshkruanin fjalët e Hëlderlinit: «O, es war ein liebes Bild,

gewebt von Grösse und Leiden!»¹ (O, ishte një pamje e dashur, e endur prej madhështie e dhimbje!). Lasgushi atëherë ishte i sëmurë, me moshë të madhe, me dy fëmijë të vegjël. Bisedat tona të para ishin të përgjithshme, të zakonshme, degë më degë, pa interes. Mua më pengonte respekti, drojtja. Atë — mosnjohja.

Pas pak kohe Lasgushi shkoi për kurim në Sanatoriumin ekstra-pulmonar në Vlorë.

Ndarja nuk zgjati shumë. Rasti e solli ta rrihja shpesh rrugën e Vlorës, madje ndenja disa muaj me punë atje.

Në Sanator² Lasgushi ishte në një dhomë në katin e dytë, bashkë me tre të sëmurë të tjerë. Rrinte në një shtrat hekuri pranë portës. Nga të sëmurët kishte miqësi më shumë me Fatoshin, një qenie njerëzore të vogël, të pakët, kurrizo, por të dashur dhe me sjellje-fisnike. Ai merrej me pikturë dhe më kujtonte Lë Tulus-Lotrekun (Le Toulouse-Lautrec). Lasgushi e inkurajonte: Fatosh, ti ke talent — i thoshte. Dhe Fatoshi punonte, punonte...

Kam plot kartolina të dërguara nga Lasgushi, ose më mirë të them copa letre vizatimi që Fatoshi mendohej t'i bënte si kartolina, duke i zbukuruar me lule me ngjyra akuareli.

Në Sanator e vizitoja shpesh. Mbasditet i

1) HOLDERLIN «HYPERION».

2) Po e përdor kështu këtë fjalë-Sanator-se ashtu i thoshte Lasgushi atij spitali.

kisha të miat. Rrija në ata shkëmbinjtë buzë detit, matanë Ujit të Ftohtë, në mes natyrës aq të bukur, në ato vite pa asnjë brengë. Detin e kisha përpara, jetën e kisha përpara. Në mes të këngës së ëmbël të valëve që lëpin shkëmbinjtë pranë këmbëve të mia,, rrija dhe lexoja Leopardin...

*Lingua mortal non dice
quel ch'io sentiva in seno...(1)*

Pastaj, kur dielli fillonte të ulej nga Sazani, merrja përpjetë dhe ngjitesha te Lasgushi.

Nga oborri përpara Senatorit hapej një panoramë madhështore mbi det dhe gjer tutje nga Vlora e më përtej, nga Narta.

*Primavera, d'intorno
brilla nell'aria, e per i campi esulta...²*

Ishte pranvera e vitit 1959.

Shëtisnim aty, në oborr. Ishte i sëmurë, por gjithmonë i gatshëm të bisedonte për artin, për poezinë.

Aty filloi të më hapej pak ajo deriçka e ngushtë për të hyrë në rrugën e gjatë e të ndërlikuar, që të shpinte në zemrën e thellë të Lasgushit. Nëpër këtë rrugë kam ecur me

1) Gjuha e vdekshme s'ë thotë atë që ndjeja në gjil... (Xh. Leopardi, «A. Silvia»)

2) Pranvera përreth,

Shkëlqen në ajër, e nër fusha ngazëllohet (Xh. Leopardi; «A. Silvia»).

durim vite me radhë. Deri ku kam arritur?
S'e di.

Kam njohur disa nga ata që thonë se e kanë njohur Lasgushin dhe kam parë se s'kanë njohur asgjë prej tij.

Thelpinjtë e ëmbël të zemrës së Lasgushit ishin brenda lëvozhgës së hidhur të çaçanikut.

Përbrënda zhguallit me gjemba të gështenjes ishte buka e butë dhe e bardhë e shpirtit të tij. Mbrapa fjalëve të rëndomta, të rënda, shpesh herë dhe banale që ai përdorte, fshihej një edukatë fisnike.

Këto e bënë të vështirë miqësinë me Lasgushin, po të mos ishte tolerant. Këto gjëra nuk mundën t'i kuptonin disa që e patën njohur, se e patën parë nga jashtë, në sipërfaqe.

Për të kuptuar deri diku *psenë* e natyrës së mbyllur të Lasgushit dhe shpesh herë raportin e tij të vështirë me ndonjë nga njerëzit e ambientit që e rrethonte, duhet lexuar poezia e mëposhtme e Franc Ginckai;

WIE ES KAM

*Er pochte an manche Herzenstür
und drinnen rif's: Herein!
Er bat um einen Bissen Brot,
man gab ihm einen Stein.*

*Und so bekam er Stein für Stein.
Er trug sie heimatwärts*

*Und baute sich ein Mauerwerk
Rings um sein eignes Herz.*

Këtë poezi jam munduar ta jap në shqip kështu

*Në dyer zemrash trokiti shpesh.
Hyrë! — i thoshin dikur.
Një copë bukë ai desh,
Porse i jepnin gur.*

*Kështu i mbloodhi gur e gur,
I çoi në shtëpi
Edhe me ta ndërtoi një mur
Përreth zemrës së tij,*

Desha të flas diçka më gjërë mbi karakterin e Lasgushit, por më duket sikur Françesko de Sanktis i thotë të gjitha ç'desha të them unë për Lasgushin me ato që shkruan ai mbi karakterin e Dantes, prandaj e lashë atë të flasë:

*„, nessuno si e piu di lui sentito superiore a'suoi
Contemporanei, nessuno si è da se posto si in
alto al di sopra di loro... (1)*

Në rrugën e jetës Lasgushi eci i heshtur e i vetmuar, i mbështjellë, si ato malet e larta, me mjegullën e krenarisë së vet,

Njohja shumëvjeçare më ka ndihmuar që herëpashere ta depërtoj këtë mjegull me të cilën ai

1) — ... askush më shumë se ai nuk u ndje më lart se bashkëkohësit e vet, askush nuk e vuri veten atë lart përmbi ta...

rrinte gjithmonë i mbështjellë dhe atëhere kam mundur të shoh atë katedralen madhështore të kulturës Lasgushiane, të bukur, të plotë e solide, të mbështetur mbi themele të fortë.

Aty, përmes ylberëve të shumëngjyrshëm të vitrazheve të shprehjeve të tij, me orë të tëra dëgjoja akordet solemne të organos që ekzekuton-te «Missa Kamadeve».

Kohë pas kohe jam përpjekur të vizatoj skica të shpejta fragmentesh nga interieret e kësaj katedraleje dhe i mbledha në këto faqe që vijnë.

Një dorë mjeshtri do të kishte mundur t'i bënte më të gjalla, më të plota. Dora ime e pastërvitur u ndihmua vetëm nga dashuria. Kaq munda të bëj për ata që do të vinë më vonë dhe do të duan të dinë gjithçka për atë që atëhere do të ketë mbetur tepër larg...
Dhe De Santis më ngushëllon:

*...A questi esseri solitari fugga il presente,
ma l'avvenire e loro! (1)*

Ndonjë dashamirës i historisë së letërsisë shqiptare ndoshta mund të thotë me keqardhje:

«Po ky Petraqi, që e pati njohur për kaq

(1) — ... këtyre qenieve vetmitare u ikën e tashmja, por e ardhmja është e tyre.

kohë Lasgushin si s'na bëri një biografi të mirë, të hollësishme të tij?»

Duke u përkulur me nderim e adhurim përpara veprës së shkëlqyer të Xhorxho Vasarit, Stefan Cvajgut, Romen Rolanit, Irving Stounit dhe të shumë biografëve të tjerë, përsëri guxoj të them se të tërë biografitë dhe autobiografitë janë me ngjyra të errëta apo të shndritshme në ato anë që i ka pëlqyer dhe si i ka pëlqyer autorit. Shumë skuta të botës së brendshme të njeriut, që shpeshherë përmbajnë thelbin e qënies dhe të jetës së tij, mbetën të panjohura, mbeten të pashkruara.

Për të më përkrahur në këtë mendim po thërres në ndihmë poezinë e Uollt Uitmanit:

DUKE LEXUAR NJË LIBËR

Duke lexuar një libër, një biografi të lavdishme, Pse, këtë (thashë unë) qojtka autori jetë njeriu? Kështu, kur të vdes, do ta përshkruajë ndokush edhe jetën time?

(Se mos di ndokush diku diçka me të vërtet për jetën time,

Po edhe unë vetë, mendoj shpesh, di pak ose aspak nga jeta ime e vërtetë...)

Shkrova, pra, ç'më tha Lasgushi, ç'më thanë për Lasgushin. Këto mund t'ju ndihmojnë të ndërtoni në imagjinatën tuaj figurën e Lasgushit dhe një variant të biografisë së tij.

**LASGUSHI
NË KUJTIMET
E VETA**

Parafjalë

Te Lasgushi shkoja shpesh, por jo përditë. Gjatë verës, që ai e kalonte në Pogradec, mbe-teshim me muaj pa u parë. Herë-herë, me anën e ndonjë shërbimi të sajuar enkas, kthehesha e qëndroja një ose dy ditë pranë tij, sa për të nxjerrë mallin.

Në shtëpi, në odiçkë, në kafenenë e hotel turizmit «të vjetër», apo duke shëtitur deri vonë buzë liqenit, i palodhshëm, i papërtuar, i papër-sëritshëm, më fliste për çështje nga më të thjeshtat, më të zakonshmet, më të kuptueshmet, më të ndërlikuarat, më të lartat, më eteriket.

Nga merrte shkas? Nga hiç ose nga gjithçka!

Një njeri, që kalonte rastësisht, një flutur, një zog, një fëmijë që qante, një valë që mend i lagte këmbët, por mbi të gjitha një varg i kujtuar pa-dashka, mund ta ngacmonte për të filluar të hapte portat e digës, që mbante rezervuarin ko-losal të kulturës së tij dhe rrymat e fuqishme të dijenive lëshoheshin tatëpjetë të pandalshme.

Si të kishte qenë të belvederja pranë ndonjë ujvare gjiqante, ku të buçasin veshët nga jeho-nat e të lëburen sutë prej ngiurave të ulberit të dritës së zbërthyer nëpër çiklat e stërkalave, ashtu largohet njeriu pas bisedës prej një ore me të. — Largohej i lumturuar, por dhe i hutuar

nga lodhja prej ngarkesës që mbartte në kujtesë.

Ndaheshim. Unë ikja i ngopur, ai mbetej me vetminë e poezisë atje lart, në kullë, por shpesh takohesh me miqtë pogradecarë të cilët e donin dhe e nderonin me gjithë zemër.

Pastaj, kur Dheri i mardhur prej thëllimit dirgjej heshtur nënë brymë dhe Frynte veriu në Mal të Thatë me zemb-
rim e me fërtymë, aty nga fundi i Nëntorit, Lasgushi soste në Tiranë!

Vizitat e mia shpeshtoheshin, drutë në sobë shtoheshin, bisedat gjallëroheshin. Kjo gjë u përsërit për vite me rradhë. Disa nga historitë, ndodhitë, poezitë, të treguara apo të recituara prej tij, më ka qëlluar t'i dëgjoj dy a tri herë, por gjithnjë ai i rrëfente me një mënyrë të veçantë dhe ato të dukeshin të reja, të freskëta. Duke i dëgjuar me vëmendje, që t'i përpija, më përpinin! Mbetesha atje i harruar me orë të tëra.

Për orët e bukura të kaluara me Lasgushin kam kënaqësinë të them se ishin ashtu siç e përshkruan poeti Viland kohën e bisedave me Gëten:

«Me të dhe ditët si orë kalonin
Dhe vetë orët si çast fluturonin»

Sa kthehesha në shtëpi mundohesha të shkruaja besnikërisht ato që kisha dëgjuar. Me besimin se një ditë do të shihnin dritë dalënaadalë shënimet u shumuan e morën trajtën që do të gjeni te faqet në vijim...

*** Të parët e familjes sonë kanë ardhur në Pogradec nga Rrëmënji, një fshat aty pranë, po në Rrëmënj kanë ardhur nga Kolonja. Atje, në Ersekë, ishin bujq e blegtorë njëkohësisht. Ishin njerëz punëtorë e të urtë, po për punë nderi të një çupe ranë në hasmëri me komshinë. Ranë në hasmëri se bënë një vrasje. Bënë vrasjen dhe një natë, për tërë natën, ngarkuan plaçkat, pleqtë e fëmijët përmbi mushkat, dhe ikën. Ikën dhe erdhën në Rrëmënj, që të ishin sa më larg një hasmi.

*** Kur isha unë fëmijë, në shtëpinë tonë bënim një jetë të thjeshtë familjare, patriarkale. Kështu, ishte jeta atëherë. Kjo jetë u prish në kohën e Luftës së Parë Botërore dhe nuk u ndreq më. Ne ishim tetë fëmijë; katër vëllezër; Vançi (Jovani), Vangjeli, unë (Lazari) dhe Pandeliu. Katër motra: Zografina, Naumka, Aspasia dhe Maria. Pra, tetë. Nëna, nëntë, Babai dhjetë. Dhe këta dhjetë shpirt i mbante babai.

Babai, kishte dyqan në Pogradec. Dyqanin e kishte nja tre minuta rrugë larg shtëpisë. Dyqani ishte me tri të ndara: Njëra ishte depo, tjetra ishte dyqani vetëm dhe një si dhomë ngjitur me dyqanin e kishte që priste miqtë e dashur. Atje nuk hynte kushdo. Babai ngrihej që pa gdhirë. Nëna ngrihej edhe më përpara. Kur ngrihej babai, nëna e kishte ndezur zjarrin në vatër dhe i kishte vënë kafënë, Babai pinte kafënë dhe shkonte në dyqan.

Ç'nuk mbante babai në dyqan!

Kusi e perusti, mashë e kaci, saç e jastagaç, qereste, hekurishte, pëlhurë, basme. Të tëra i gjeje atje! Edhe syze mbante, Vije ti i provoje, Po të shikoje mirë, i merrje, Jo? — i lije. Babai mbante me vete gjithnjë kobure, revole. Kur vinte në shtëpi dhe binte të flinte, revolen e mbante atje, pranë jastëkut.

Të mos harrojmë se flasim për kohën kur ishin dy duar për një kokë, dhe kjo kokë kishte

një revole në jastëk dhe një pushkë të varur në musandër, prapa derës!

*** Babai im punonte për Shqipërinë. Tani këta i quajnë patriotë, po atëherë ju thoshin shqiptarë. Babai quhej Sotir, po i thoshin Tirkë, «Tirka i gjatë», se babai ishte i gjatë, po më shumë i thoshin «Tirkë shqiptari». Kështu ishte edhe xhaxhai im edhe disa të tjerë. Njëri ishte «Gjokë shqiptari». Këta kishin lidhje me komitet. I strehonin, i ndihmonin. Në shtëpinë e një kushëriut tim vinte dhe Themistokliu me të vëllanë, Telemakun, ose me të tjerë. Vinin natën, fshehtas, dy-tre veta bashkë, të armatosur.

Themistokliu ishte trim dhe vinte nganjëherë edhe vetëm.

Me kë ke ardhur e pyeti një nusja e kushëririt tim. Themistokliun, dhe ai iu përgjigj; Me Themistoklinë!

Po në Pogradec kishte dhe grekomanë dhe turkomanë.

Turkomanët më të liq ishin bejlerët e Starovës. Ata e zunë Telamak Gërmenjin, të vëllanë e Themistokliut, dhe Menduh Zavalanin dhe i mbytën në liqen me nga një gur në qafë.

Grekomanët e kishin inat babanë. Babai vinte kur e kur në Korçë ose në Manastir për të blerë mallra për dyqanë. Njëherë kur do të shkonte babaj, bashkë me xhaxhanë për në Korçë i thotë një nga këta grekomanët:

O Tirkë, shpjere një çikë këtë letër në filani, në Korçë, Mirë, thotë babai, dhe e mori.

Kur po afroheshin në Korçë babai i tha të

vëllait: ore, se mos harrojmë atë letrën pa e shpënë!

Për të shpënë është kollaj, tha xhaxhai, që ishte më i madh në moshë, po pa nëma ta këndoj njëherë se ç'thotë:

Kur e lexoi, në letër shkruhej:

«Këta të dy janë ata që na prishin punë. Të prishen».

Ja kështu shpëtuan.

***Babai ka pasur një dashuri të jashtëzakonshme për shkollën. Nuk e lëvdoj se e kam baba, po them kështu se kështu ka qenë. Djalë i madh e dërgoi në gjimnazin grek të Manastirit. Djalë i dytë e dërgoi në gjimnazin turk të Manastirit, për oficer, se thosh: Kur të bëhet Shqipëria do të ketë nevojë për oficerë. Mua, që isha i treti, më dërgoi në gjimnazin rumun të Manastirit. Kur filloi lufta e parë botërore, gjimnazistat u mbyll dhe unë u ktheva në Pogradec.

Shkoi ca kohë, po babai s'më shikonte dot ashtu, pa shkollë.

Të shkosh — më tha — në Greqi, të vazhdosh shkollën.

Atëhere vetëm Greqia nuk kishte hyrë në luftë, se qenë dy parti të forta: një palë me mbretin, që desh të hynte në luftë në anën e gjermanëve një palë me Venizellon që desh të hynin në luftë në anën e Aglisë e të Fracës.

Të mos harrojmë se në Pogradec ishin gjerman-

nët, në Korçë — francezët. Pra, duhej kaluar vija e frontit.

Ka qenë tetor i vitit 1916.

Bëhu gati — më tha babai — se do të shkosh.

Kishte gjetur njerëz të më përcillnin të kaloja për matanë. Bëji edhe një qese — i tha nënës — që të mbajë paratë. Qesen, më tha, ta varësh në qafë dhe ta mbash në mish, ndënë këmishë. Babaj më dha pesëdhjet napolona.

Nëna tha: Kam edhe unë nëntë, t'ia jap? Jepja — tha babai. Po unë thashë: S'i mbaj paratë në qese, do t'i mbaj në portofol.

Gjashtëmbëdhjetë vjeç djalë.

Atëherë babai më shau. Babai, jo që s'më kishte rrahur, po as që më kishte sharë deri atëherë ndonjëherë.

Vajta në dhomën time dhe po qaja. Erdhi murga nënë. Më pa që po qaja dhe lajmëroi babanë në dyqan. Erdhi ai, më mori me të mirë dhe më tha: Mjaft tani, hajde, merr flautin dhe bjeri. Flautin e kisha që i bija në gjimnaz, në Manastir.

Të nesërmen u nisa. Kufirin e kaluam pas mesit të natës. Me varka të vogla prej trungjesh shelgu të gërrvera nga brënda. Kemi kaluar nënër kënetën e Maliqit, ndënë hijen e kallamishteve që ndricoheshin nga hëna pesëmbëdhjetë. Ata më shoqëronin, dy veta, zgjodhën pikërisht natën me hënë, se nga rojet ruhej më pak. Varkat, apo më mirë trungiet, seicili i lëvizte jo me lopata, po duke përdorur duart si lopata, ngadalë na zhurmë, duke shkuar e duke ngrënuar. Herë-herë ndalonim kur na bënte shenjë ai që

ishte përpara. Pastaj, me kuaj të qiraxhijve, shkova në Korçë, Kolonjë dhe gjer në Prevezë. Nga Preveza në Pire dhe që atje, nga njëzet minuta rrugë arrita në Athinë.

Rrugës, në trenin për në Athinë, më doli fjala e babait. Në tren kishte plot njerëz, ulur, në këmbë. Edhe unë, më këmbë. Erdhi fatorinoja që kërkonte biletat. Bëra të nxjerr portofolin. S'e gjeta! Ma kishin vjedhur, po atje s'kisha para. Paratë ishin atje, thellë, në qeskë, ku tha babai.

Në Athinë kishim një kushërinë tonë, të pasur. Pasi zura hotel vajta tek ai. Një ditë ky më shpuri të më njohë me Qirie Skëndherin, një grekoman, që nxirrte gazetën «O Pellazgos» dhe bënte propagandë greke kundër shqiptarëve. Ky qirie Skëndheri ishte një burrë nga pesëdhjetë e pesë vjeç, po mua më dukej plak. Sa më pa, u ngrit dhe filloi të më fliste për gazetën. Ja, dhe ne — tha — po përpiqemi t'u mësojmë cave të kuptojnë se ç'janë. Ky kushërirë im, që e dinte se nga shtëpia ime ishin kundra grekomanëve, i bëri me sy atij qiries dhe i tha: Ka ardhur të regjistrohet në Liceun Francez.

Ai menjëherë ndërroi qëndrim dhe biseda mbaroi shpejt.

*** Liceu që mbarova në Greqi ishte shkollë shumë e mirë. Në dëftesën e notave e kish të shkrojtur:

Lycés Français, Lionais, dirigée par les Freres Mariste (1).

dhe më poshtë:

Ouvre les portes a tous les Universite du monde. (2)

Drejtohej nga vëllezërit Maristë, priftërinj, por shkolla ishte laike jo fetare.

Kur u ktheva në Poradec, pas lufte, më pritën nëna, motrat dhe shtruan të hanim darkën.

Po Buba kur vjen? — pyeta unë, se ashtu i thoshim babajt, Buba, emër ky që të fuste frikën asi kohe.

Jo, jo, babai që i urtë, po atëherë respekti që i madh për më të mëdhejtë dhe të vegjlit s'flisnin para tyre, para babait dhe prandaj na thoshin nënat: pusho, se vjen Buba!

E kur pyeta unë, murga nënë më tha:

Babanë e ndjeu perëndia.

— Po a la, moj nënë, ndonjë porosi për mua para se të vdiste?

— Po hiç, o bir, ja, tha: të vazhdojë shkollat...

*** Nëna ime kishte talent, fantazi të madhe, i krijonte vetë përrallat. Kam marrë prej prindërve pak a shumë atë që pati marrë Gëte, siç shkruan ai vetë:

*Vom Vater Hab'ich die Statur
Des Lebens ernstes führen,*

1 — Gjimnaz francez, i Lionit i drejtuar nga vëllezërit Maristë.

2. — Hap portat në të gjithë universitetet e botës.

*Vom Mütterchen die Frohnatur
Und Lust zu fabulieren (1)*

Po unë kam edhe shtatin prej nënës.
Nëna, kur ishte e re, kishte një fytyrë shumë
të ëmbël.

*** Për jetën time s'kam mbajtur shënime. Po
dhe për t'i treguar, s'tregohen të gjitha ato që
kam vojtur. Ato do t'ja tregoj varrit. Ku rrë-
fehen ç'kam hequr në Rumani... Flija në një dho-
më përdhese, jo përdhese, po pjesërisht nën dhe,
nja tridhjet centimetra më poshtë se toka jashtë.
Dhe dysHEMEJA ishte prej dheu të ngjeshur. Kish-
te një dritore të vogël me xham të thyer, dhe
në atë dimrin e Bukureshtit, me njëzet gradë
nën zero, flija i mbuluar jo siç flenë në Korçë me
dy jorganë dhe me një levenxë të trashë, po me
një batanie të ndyrë ushtari. Dhe mbi këtë ba-
tanie të ndyrë, shumë herë, kur zgjohesha, gjeja
dëborën që kishte hyrë nga xhami i thyer.

Atëherë shisja gazeta.

Ngrihesha në orën dy e gjysmë, natën, dhe
vija merrja 300 gazeta që mezi i shisja nëpër
rrugët gjer në orën dhjetë. Isha student. Gjys-
mën e parave që fitoja nga shitja e gazetave e

1 — Babai i kam ngjarë nga shtati

Dhe të jetuarit me krenari,

Nënës i kam ngjarë nga natyra gazmore

Dhe qejfi (kënaqësia) për të trilluar (thurur) përralla.

harxhoja për qiranë e asaj dhome ku flija. Shisja gazeta dhe më vinte inat kur më thërrisnin: «Pëst! Pëst! ata që deshin gazetën, sa më cenonin dinjitetin tim. Atëherë barkun e kisha bosh, po rrija i veshur elegant. Jepja dhe mësim privat në frëngjisht. I jepja çupës së një pasaniku grek. Një ditë, pas një muaji, ai më dërgoi një letër. Qirie Lasgush — më thosh — mos ejani më, se kam gjetur një mësues tjetër.

Pastaj i dhashë mësim çupës së një pasaniku shqiptar. Për këtë më ndihmoi Asdreni. Kur biseduam me atë pasanikun, më tha: zoti Lasgush juve do të hani bukë këtu, bashkë me ne. Mua më vinte rëndë, s'desha të ha bukë bashkë me ata dhe i thashë: Preferoj më mirë të më paguani.

Mirë, më tha, si të doni. Milioner, ai!

Jepja mësim dy herë në ditë. Kur vija në mëngjes, ajo çupa ishte e veshur me fustan mëndafshi rozë. Kur vija pas dite, e gjeja të veshur me fustan mëndafshi bojë qielli me trëndafila. Kamarieri i shtëpisë më sillte një thelë bakllava të madhe. Unë isha barkbosh; po bakllavanë nuk e haja Kam ngrënë i thosha. S'desha të ul dinjitetin tim, të dukeshja si sahanlëpirës.

Pastaj punova për të siguruar abonentë për gazetën e pronarëve urbanë. Kjo ishte e vështirë, se do të vije në dhjetë shtëpi që të siguroje një abonent. Punova dhe me një karrocë, i hipur përmbi pirgun me fuçi me birrë që i shpërndanim nëpër pijetoret.

Sa fuçi do sot, xha Sotir? Tre, Lasgush! I lija tre fuçi. Shkonim më tutje në tjetri; tjetri...

Kështu për ditë. Me këto punë ushqehesha dhe vazhdoja universitetin.

Vazhdoja fakultetin e gjuhësisë dhe letërsisë; Fakultetin e teologjisë se desha të mësoj hebraishten, vazhdova tre vjet fakultetin e drejtësisë, fakultetin e mjekësisë për gjashtë muaj. Këtë fakultet e ndoqa dhe në Gratz.

Vazhdova shkollën e lartë të muzikës dhe të teatrit. Akademinë e pikturës dhe Shkollën e lirë të pikturës.

Akademia ishte shkollë shtetërore, kurse në shkollën e lirë të pikturës jepnin mësim vetë artistët e njohur.

Ç'farë nuk mësoja!

Isha i uritur për të ngrënë, po isha shumë i uritur për kulturë.

***Në Rumani në fillim shisja gazeta. E kam rojtur edhe faturën e Bashkisë që thotë se iu muar taksa shitësit ambulant, filanit. Ndonjëri që do të kërkojë ndonjëherë në arkivën time, do ta gjejë. Atëherë nga gjendja ekonomike isha keq. Kisha nja gjashtë muaj që s'haja në restorant. Atëherë takova dhe Asdrenin.

Ku ha — më tha.

Po ja, kështu, buk' e djathë...

Eja me mua! Dhe më shpuri në një restorant. që e kishte një korçar. Nikolla Tabaku. Ishte si të tërë korçarët që shkuan në Rumani, pa gjuhë, pa shkollë, pa zanat dhe u bënë tregtarë dhe disa milionerë. Kështu janë korçarët! Korçari

është një tip i veçantë. Do të punojë shumë, të fitojë shumë, të vishet mirë, të rrojë mirë.

Sapo hymë në restorant doli i zoti na priti.

Urdhëroni zoti Asdren, urdhëroni!

Në çdo restorant shqiptar që vinte Asdreni, s'bënin kabull t'i merrnin para*.

Sot ju kam sjellë dhe Zotin Lasgush — tha Asdreni.

Mirse na urdhëruat! Ne ju kemi dëgjuar, zoti Lasgush; po s'ju njihnim. Të na vini gjithnjë.

Pastaj bashkë me Asdrenin, shkuam në dhomën ku banoja unë.

Përdhese. E ftohtë. E pashtuar.

Po pse s'ke shtruar ndonjë rrogoz-o Lasgush, — tha Asdreni.

S'kam para, — i thashë.

Eja me mua. Dhe më shpuri në një dyqan të një korçari tjetër që shiste edhe rrogoza. Jo si këta që bënin këtu, po të trashë, të thurur bukur.

— Kush të pëlqen — më tha i zoti i dyqanit.

— Ja, ky; i thashë. Ç'të zgjidhja! Rrogoza ishin.

* — Në Korçë kam takuar njëherë një kushëririn tonë. Ishte rrobaqepës dhe kishte punuar ca kohë në Rumani.

Duke biseduar me të, ia shpura fjalën te Asdreni.

— A e ke njohur Asdrenin?

— Si jo Ishte plak i urtë. S'kishte njeri. Vetëm ecte gjithmonë. Qe njeri shumë i mirë, E deshin të tërë shqiptarët

Tetoja ime në Rumani, kur e shikonte nga dritarja e thërriste: Hajde Asdren, se kam bërë lakror! (Shënimi është imi (P. K.)

Mirë.

Unë desha ta merrja, po s'më la. Thirri një djalë. Shpjerja në shtëpi zotit Lasgush — i tha.

*** Kur isha sekretar i kolonisë shqiptare të Bukureshtit, kolonia e kishte selinë e saj në një ndërtesë të bukur në qendër të qytetit. Atje kishte salla ku jepeshin pritje me rastin e njëzet e tetë Nëntorit, ftonim personalitete të shquara të vendit e të huaj, bënim mbledhje të kolonisë.

Ishte koha kur Shqipëria qe formuar si shtet më vete, po shumë njerëz pyesnin:

Ç'është kjo Shqipëri?!

Për t'ua bërë të njohur Shqipërinë të tjerëve, na duhej të kishim një libër ku të flitej për historinë e Shqipërisë, për të kaluarën e saj, heronjtë e saj. Një libër të tillë nuk e kishim, prandaj iu lutëm Nikolla Jorgës të na i shkruante. Nikolla Jorga ishte historian rumun shumë i zoti, me një kujtesë të jashtëzakonshme.

Unë — na tha — nuk kam nge të shkruaj historinë e Shqipërisë, por do të vij të mbaj një leksion në selinë tuaj mbi këtë temë. Ju ftoni njerëzit që doni, merrni dhe dy stenografë që të mbajnë shënime. Këto shënime, pastaj, shtypini. Dhe ne kështu bëmë.

Ai na tha të merrni dy stenografë, ne morëm katër. Erdhi Nikolla Jorga. Në ato nja dy orë që foli e përshkroi të tërë historinë e Shqipërisë,

që nga origjina e saj deri në ngritjen e flamurit, me një zotësi të rrallë.

Ato që mbajtën shënim stenografët u sistemuan, u daktilografuan, ia treguam edhe njëherë Jorgës dhe e shtypëm si libër. Këtë libër pastaj ua jepnim të ftuarve, personaliteteve të shquara apo atyre që interesoheshin të dinin se ç'ishte kjo Shqipëri.

*** Më 1909 jam regjistruar në klasën e parë të Liceut në Manastir. Atëherë më kujtohet se kam bërë poezinë e parë. Vargje pata bërë edhe më parë, po s'më kujtohen. Kur isha, pra, në Manastir, babai më dërgonte ndonjë qeskë me ushqime me qiraxhinjtë që vinin.

Letrat që dërgoja në shtëpi i shkruaja në vargje, ja, si kjo që më kujtohet:

*Qesen që më solli Miti,
Kur e pashë, më çuditi,
Thashë se mos kishte rrushka,
Po qe mbushur me kajkushka.*

Atëherë kam shkruar edhe një poezi për dëshmorët e Orman Çifligut:

*Galiçica mal'i thatë
Me dëborë mbushur plot.
Qajnë burrat, qajnë gratë,
Qajnë vajzat derdhn lot...*

Më tutje s'e mbaj mend...

Po cila është poezia e parë që kam bërë?

Ku ta dish?...

*** Kur isha në Rumani desha të mësoj hebraishten e vjetër për t'i lexuar në origjinal Profetët. Ndoqa kursin të cilin e drejtonte një Patrik, por për të mos humbur mësimet që ndiqja në universitet, isha i detyruar të vija në këtë kurs gjithmonë me një orë vonesë.

Rrija gjithnjë në bangon e parë që t'i dëgjoja e t'i përpija të gjitha, por vonesat e mia të përhershme e mërzitën Patrikun, i cili më tërhoqi vëmendjen.

I shpjegova:

Jam poet — i thashë — dhe s'kam ndërmend të bëhem prift.

Vij këtu për të mësuar gjuhën hebraishte, që të lexoj në origjinal Profetët dhe të plotësoj kulturën time.

Që sot e tutje — tha Patriku — të mos vish më në mësimin tim.

Dhe s'vajta!

Pastaj, kur isha në Austri, desha të mësoj Sanskritishten, sepse më pëlqente bota Indike dhe kultura e saj.

Ndoqa rregullisht kursin për gjashtë muaj në katedrën që drejtohej nga një sanskritolog i madh. por ai u largua dhe unë më s'vazhdova. Edhe sot e kësaj dite s'ngopem me Vedat Indike:

***Kur isha në Greqi, gjashtëmbëdhjetë vjeç
djalë qeshë, lexoja «Les vie paraleles» (Jetët pa-
ralele) dhe zbulimet e Shlimanit (Schlimman).

*** Italishten e kam mësuar kur isha gjashtëmbë-
dhjetë vjeç.

E mësova me një libër «L'Italiano» që kishte
200 faqe. Mësoja nga 20 faqe në ditë. Jo, jo,
nuk i mësoja! I përpija!

Ditën e fundit mësova gramatikën. Ditën e
dymbëdhjetë unë dija italisht. Zotëroja mekaniz-
min e gjuhës.

Pastaj lexova «Il Cuore», të Edmondo de
Amicis-it.

Atë e lexova për tre muaj. Nuk lashë asnjë
fjalë pa mësuar.

Nëpër tërë faqet kam bërë shënime. Mijra
shënime. Fjalor italisht-shqip s'kisha. Kisha ve-
tëm italisht-italisht. Me atë mësoja. Pastaj, po
kështu, për gjashtë javë lexova «La vita milita-
re». Këto libra dhe të tjera, i kisha marrë në
Manastir kur isha në gjimnazin e atjeshëm, nga
shoqëria «Dante» e Manastirit, që shpërndante li-
bra italisht falas.

Pastaj lexova, pa përdorur fare fjalorin, lib-
rin e A. Manzoni «I promessi sposi». Edhe sot
e kësaj dite, që jam tetëdhjetë vjet, e mbaj mend
se si fillon:

«Quel ramo del lago di Como, che volge e mezzogiorno, tra due catene non interrotte di monti...»(1)

Vëllimin e dytë s'e lexova. Italishten e kisha mësuar, Ecco! Si mësohet një gjuhë. Duhet punë.

**** I thashë një ditë, Mars 1978 ishte, duke përfutur nga një pushim në monologun e tij të gjatë:*

— Më ka bërë përshtypje se në një revistë letrare të Kalabrisë kam lexuar disa poezi shumë të mira.

Pse, si e di ti Kalabrinë — më tha. Ajo ka tradita.

Vetë Virgjili thotë:
(dhe më recitoi latinisht vargjet e mëposhtme):

*Mantova më lindi,
Kalabria më rriti,
Antigonea e dashur më mban.
Këndova bagëtinë, bujqësinë
Dhe Heronjtë.*

1 — «Kjo degë e liqenit të Komos, që kalon në mesditë, ndërmjet dy vargje malesh të pandërprerë...»

A. Manxoni

***Kur erdhi „Fan Noli në fuqi mua më akordoi bursë për studime. Telegrami që më lajmëronte për këtë gjë kishte ardhur në Selinë e Shoqërisë Shqiptare të Bukureshtit. Asdreni, që ishte njeri shumë i mirë, dërgoi më thirrje në seli dhe kur vajta, doli më priti në shkallët.

Po, ku je mor Lasgush — më tha — se të kanë emëruar bursist në Gjermani. Kështu thosh telegrami. Më dërgonin për të studiuar albanologji në Gjermani, në Berlin. Aq dinin. Nejse.

Vajta të marr pasaportën në Konsullatën Austriake në Rumani. Ishte ora nja dhjetë, në mëngjes.

Kommen Sie bitte um Zwölf Uhr (1) — më tha ai nëpunësi.

Edhe unë vajta në ora dymbëdhjetë. Kur vajta, porta e zyrës të atij nëpunësit ishte e hapur dhe po dilte.

Erdha — i thashë — të marr pasaportën.

Junger Herr — më tha. — Die Uhr ist eine minute vorüber Zwelf, Kommen Sie morgen um Zwelf Uhr. (2)

U inatosa, po s'kisha ç'të bëj. Vajta në Asdreni.

Po këta austriakët qënkan të liq — i them. të poshtër, këta qenkan maskarenj, këta qenkan...

Ç'ke, Lasgush?

Ia tregova ç'më ndodhi dhe prapë thosha: Këta qenkan të liq... Jo Lasgush, janë të mirë —

1 — Ejani ju lutem në orë dysmbëdhjetë.

2 — Djalosh — më tha — Ora ka kaluar një minutë nga dymbëdhjeta, ejani nesër në ora dymbëdhjetë.

tha Asdreni. Edhe mua kështu ma bënë njëherë kur do të merrja pasaportën, po janë të mirë.

S'janë të liq, po duan rregull, saktësi. Dhe rregulli e saktësia do kulturë dhe edukatë të lartë. Ata i kanë, ne s'i kemi.

*** Në Austri, në Graç, shkova kur isha njëzet e katër vjeç, për të vazhduar atje studimet.

Që të mësoja mirë gjuhën, nuk desha të rri në pension, por kërkoja dhomë në ndonjë familje. Kërkoja dhe ndërrova dhjetë shtëpi. Më në fund gjeta një që më pëlqeu.

Mbasi ramë dakord për çmimin, asaj zonjës së shtëpisë — Pihler e kishte mbiemrin, i thashë:

Zonjë, të më falni, se juve ndoshta s'ju pëlqen, por unë, veç të tjerave që folëm, kam edhe këtë kusht: Kur s'jam në shtëpi, jam në Universitet dhe kur s'jam në Universitet, jam në shtëpi. Përkundër, tha ajo, një njeri i tillë na pëlqen më shumë. Unë u nisa të iki, të vete të marr valixhet që atje ku i kisha lënë. Te porta zonja Pihler më pyeti: Më falni, por nga ç'vend jeni?

Nga Shqipëria!

Më falni, zotëri — tha — po me shqiptarë s'dua të kem të bëj. Kam pasur disa dhe përveç të tjerave, më kanë ikur pa paguar. Më falni, po më mirë kërkonin ndonjë dhomë, gjatë. Zonjë e nderuar, — i thashë — ju e dini fort mirë se edhe pallati më i bukur e më i madh e më luksoz që të jetë, edhe ai e ka një klozet.

Kështu edhe çdo popull, sado i mirë të jetë, ka edhe njerëz të ndyrë. Ne ndoshta kemi ca më shumë, se jemi popull ende i paqytetëruar. Juve e dini që mund të gjej lehtë një dhomë tjetër, ndoshta edhe më të lirë edhe më të mirë, po tani dua të rri këtu me çdo kusht, se dua të ndërroni përshtypjen që keni formuar për shqiptarët.

Dhe në këtë shtëpi ndenja pastaj dhjetë vjet!

Atëherë studioja gjithë ditën dhe deri vonë pas mesnate. Sa herë hapte ajo zonja portën, më gjente shtrirë dhe me libër në dorë.

Herr Lasgush — më thosh — mjaftë studiuar, se kam frikë, ndonjë ditë, kur të hap portën, s'do të gjej më Lasgush, por një libër të madh të hapur në vendin tuaj!

*** Kur shkova për studime në Austri, zura një dhomë me qira te një familje. Pagova një muaj për të fjetur e për të ngrënë. Pazarin e pata bërë me të zonjën e shtëpisë.

Fjeta natën e parë. Pastërti. Qetësi. Shumë mirë. Austri!

U zgjova në mëngjes, u lava dhe u bëra gati për të ikur.

— Tani do t'ju sjellim mëngjesin — tha e zonja e shtëpisë.

Dhe unë u ula pranë tavolinës që kisha në dhomë.

U hap dera. Hyri një vajzë me tabaka në dorë, ku kishte vënë mëngjesin.

Vajzë, thashë? Ç'vajzë? Ajo qe nimfë! Bjonde, e re, e gjatë, e bukur.

— Mirëmëngjesni, zotëri — më tha.

— Mirëmëngjes — thashë dhe unë.

— La tabakanë mbi tavolinë, përshëndeti me kokë duke buzëqeshur, dhe iku.

Ajo iku, po unë rrija dot? Haja dot? Pija dot?

Bëra sikur hëngra! Zura kokën me të dyja duart dhe u mendova.

Lasgush! — i thashë vetes. Ti s'duhet të rrish këtu! Ti duhet të ikësh. Të ikësh që tani! Ti, po të rrish këtu, do të biesh në dashuri me atë cunë. Dhe po të biesh në dashuri me këtë, s'ka shkollë për ty. Ti ke ardhur për në shkollë, jo për të bërë dashuri.

Tkë, Lasgush! Ikë! Ikë!

Dhe ika!

Mblodha shpejt e shpejt plackat në valixhen time dhe dola.

Zonjë — i thashë në porta — unë nuk do të kthehem më...

*** Për të bërë studimet në fillim shkova në Vienë. pastai në Grac. Në të dy këta qytete atëherë kishte plot-studentë shoqëtarë. Ata që ishin në Vienë, kishin organizuar shoqërinë «Dialëria». Në Grac nuk kishte shoqëri. Kur vaita unë, u mblodhëm dhe vendosëm të nxirrjmë edhe një revistë. Ishte viti 1925. Do të festonim nëzetënesë.

vjetorin e vdekjes së Naimit. Kryeredaktor të revistës më zgjodhën mua.

Unë, Eqrem Çabej dhe disa të tjerë propozuam që numëri i parë i revistës të ishte vetëm me material mbi Naimin. Shumë të tjerë deshën të bëhej vetëm një artikull për Naimin dhe pastaj të kishte materiale të tjera. U bënë diskutime, po si shqiptarë që jemi, nga diskutimi u kalua në të thirrura, pastaj në fyerje dhe në fund në sherr.

Mbledhjen e bënim në katin e dytë të një kafeneje.

U shanë njëri me tjetrin edhe si toskë e gegë dhe një i quajtur Frid Frashëri, rrëmbeu një shishe dhe qëlloi Vangjel Karajanin. Ky uli kokën dhe shishja theu xhamin dhe doli jashtë.

Dhe të gjitha këto, ku? Në Grac! Në Austri!

Në Austrinë që shkencëtari i madh francez Ogyst Pikar, (Auguste Piccard) ai që zbuloi stratosferën, kur na mbajti një konferencë në shoqërinë gjeografike «Uranus», e quajti:

La nation, la plus polie du monde! (1)

Edhe Çabej u zu me Kolë Mirditën.

Më në fund gjakrat u qetësuan, po inatet mbetën. Do ta vras Kolë Mirditën — thosh Çabeu — se më ka sharë rëndë!

Më vonë unë u sëmura dhe u shtrova në spital.

Çabeu shkoi nëpër të gjithë studentët që të mblidhte ndihma në të holla për mua. Shkoi

1) — Kombi më i sjellshëm në botë.

edhe në Kolë Mirdita. I tha kështu-kështu është puna e Lasgushit, sa të kesh mundësi, po deshe, ta ndihmosh.

Kolë Mirdita nxorri portofolin dhe ia vuri përpara Çabeut. Merr sa duhen! — i tha.

Mua me ndihmoi, po vetë vdiq nga tuberkulozi.

Mbaroi për drejtesi. Mori edhe doktoratën. Në Shqipëri nxori revistën «Jurisprudenca».

Kur isha në Austri, student, u sëmura nga zemra. Kisha rrahje të lorta e të shpeshta të zemrës. Me zuri krize shumë e lortë një natë pasi kisha bërë banje me uje të nxente.

Erani mjeku. Ishte një mjek plak, me mjekër. Më vizitoi. Unë kisha rrahje shumë të lorta sa me dukej se hidhesha mbi dyshek. Me dha një ilaç me pika. «Marientropie» shkruhej në ajo shishka. Domethënë «Pika të Shen Marisë». Mezi u qetësova. Pastaj, për shumë kone mezi ecja, sa me zinin rrahjet e zemrës. Merre me mend, kur kaloja tërthor rrugës, mezi e ngjytja atë kurbëzim që ka rruga për kullimin e ujrave të shiut, kaq keq isha.

Ai mjeku plak-shumë plak ishte, po dhe shumë i urtë e i ditur — ai tha se më kish ardhur sëmundja nga një lodhje e gjatë mendore. Kish të drejtë. Atëhere lexoja shumë ditën dhe natën deri vonë, shumë vonë.

*** Kur u ktheva nga Athina më 1920, në Pogradec ishte një mësues, Sheref Zaimi i thoshin. I pëlqente poezia. Atij ja tregova poezinë.

«Në çetele të kujtimit...»

atëherë fjalën çetele e kisha vënë rabozh, po pastaj e ndërrova, se le që ishte fjalë sllave, po s'ishte as poetike.

E, këtij mësuesit, i pëlqeu shumë poezia dhe pa se sa shumë kisha punuar unë për ta bërë. Ai shkroi në një gazetë pastaj (unë e lexova në Rumani, se kisha ikur atëhere) — atë gazetë e kisha, po s'e kam më, se kjo poezi i pëlqente dhe se unë, thesh, kam parë me syt' e mij shtatëdhjetë e pesë variante të kësaj poezie që i kishte bërë Lazar Gushua. Për këtë ca të tjerë e shanin: ç'farë poeti qënka ky që na e lëvdokë ti kur s'bën dot fët e fët një poezi, po bëka shtatëdhjetë e pesë variante.

Atëherë në Pogradec studioja shumë. Rrija mbyllur në një dhomë timen dhe studioja. Se po nuk studiove shumë, nuk bëhesh dot poet. Dhe poet të bëhesh o i madh, o hiç, se po s'qe i madh, je hiç në art. Arti, siç kemi thënë, ka vetëm një gradë, gradë të parë.

Një natë, ishte natë shumë e bukur, Maj ishte. Në kopshtin tonë këndonte bilbili. Tërë Pogradeci flinte. Flinin të tërë dhe në shtëpinë time. Unë studioja. Kur, dëgjoj këmbët e rojeve të natës që qëndruan poshtë dritares sime.

Ata kishin kohë që vinin re se në tërë Pogradecin vetëm unë kisha dritë aq vonë. Njëri

nga rojet qe si poradecar, tjetri jo. Qëndrojnë dhe bisedojnë. Ç'është kjo llambë për natë?

— Është një i çmendur.

— Jaaa!

— I çmendur është po dhe i çmendur s'është. Thonë se di shumë. Vetëm se tërë ditën rri mbyllur. Del në mëngjez herët nga liqeni dhe pastaj shkon e mbyllet brenda. Merret me libra. Kur të tjerët i shuajnë llambat, ky i ndez.

— E po, i marrë qenka!

Unë dëgjoja dhe atëherë mora vesh se ç'thuheshe për mua në Pogradec. Ishte ora nja dy e gjysmë pas mesit të natës. Zbrita poshtë ku flinte im vëlla. Ngrehu, Pandel! — i them. Ai, nëpër gjumë: Ç'ke? — Ngrehu të gjejmë një kalë se do iki. Do të iki në Rumani.

Ika dhe nga inati atëherë ndërrova dhe emrin që të mos merrnin vesh kush isha, e bëra Lasgush, po prapë malli për vendin s'më la. E shtova dhe atë, Poradeci, prapa!

*** Kur u ktheva nga Austria, në Tiranë u emërova profesor në gjimnaz, po rroga do të më fillonte pas gjashtë muajsh.

Para nuk kisha. As të njohur nuk kisha. Njihja vetëm Eqrem Çabeun. Ai më rekomandoi në një i njohuri i vet, Fuat. Fuat, i thoshin, nga Gjirokastra. Kishte Hotelin «London» dhe një si restorant.

Në ky hotel flija.

Pas një muaji, ky i zotë i hotelit, më tha:

zoti Lasgush, tani na paguani gjëkafshë se u bë një muaj.

Do t'ju paguaj; — i them — posa të marr rrogën, tani nuk kam.

Atëherë — tha — s'mund t'ju mbaj më.

Ika. Ika, po ku të vija?

Ateherë në Tiranë shitej libri me poezitë e mia. «Vallja e yjve». E shiste Dhimitër Canco që kishte librarine «Argus».

Libri «Vallja e yjve» u shtyp në Kostancë, në shtypshkronjën «Albania».

Librin, Dhimitër Cancos, ia dërgoi për ta shitur Dhimitër Paskoja, me rekomandimin që të mos më mbante përqindje fitimi. Libri atëherë po shitej dhe unë, meqenëse isha nevojtar, i thashë Dhimitër Cancos të më jepte disa lekë paradhënie nga librat që do të shiste. Kështu u bë.

Pastaj, kur u botua «Ylli i zemrës», Dhimitër Paskoja ma dërgoi mua dhe unë ua shpërndava për ta shitur disa librarive në Tiranë, Shkodër, Korçë.

Poezitë e «Yllit të zemrës» i mblodhi Pandeli Martiniani, dashuronjës i poezisë, dhe ai ia dërgoi Mitrushit për botim.

Dhe tashi do të të jap një informatë që s'e di njeri:

Meqenëse «Ylli i zemrës» po shitej shpejt nga të gjitha libraritë, unë u mora vesh me shtypshkronjën e Kristo Luarasin, me djalën e tij, Thoma Luarasin, dhe shtypa dy mijë kopje, duke bërë botimin gati ekzakt si ai i bërë në Bukuresht. Edhe vendin e botimit nuk e vura Tiranë.

por Bukuresht. Vetëm letra nuk ishte aqë e mirë, po nuk kuptohej.

*** Kur u ktheva në Shqipëri, fama ime ishte e madhe.

Atëherë kryepeshkopi i kishës Ortodokse më thirri t'i bëja një vizitë. Më priti me gjithë të mirat.

Ne tha — e kemi për nder që sot poeti më i madh i Shqipërisë është i krishterë. Pastaj, në prezencën time, mori në telefon në restorant të një shkodrani dhe i tha se aty do të vijë të hajë këtej e tutje zoti Lasgush. Paguej kisha!

Dhe unë vija haja. Vinin me mua dhe disa sahanlëpirës, se kur je i madh, ke rrotull shumë sahanlëpirës.

Atëherë doli në qarkullim «Ylli i zemrës». Meqenëse u shit shpejt, unë desha ta ribotoj. Në bisedë e sipër një ditë këtë mendim ja thashë peshkopit. Posi jo — tha — këtë e merr përsipër kisha. Mori telefonin dhe thirri djalin e Luarasit që kishin shtypshkronjën. Biseduam, zgjodhëm edhe letrën në mënyrë që ribotimi të bëhej një-lloj si ai i botimit të Bukureshtit.

Ne — tha Kryepeshkopi — marrim përsipër shpenzimet, por duam që në faqen e parë ose të fundit të vini që kjo u botua nën kujdesin e Kryehirësisë së tij...

Unë nuk isha dakord, atëhere ai, përsëri në prezencën time, mori në telefon atë restorantin

dhe i tha se Lasgushit (këtë radhë jo zoti Lasgush!) nuk do hajë më atje.

Kisha nuk paguan më!

Librin pastaj e ribotova, siç ta kam treguar, me shpenzimet e mia.

*** Në kohën e Zogut dhe në kohën e Italisë vija shpesh në librarinë «Argus» të Dhimitër Cancos. E njihja prej kohësh, që në Rumani. Aty vinin dhe intelektualë të tjerë:

Mbaroi lufta.

Një ditë, si gjithë të tjerat, po vija përsëri në «Argusi». Aty kishte plot oficerë partizanë që shikonin dhe blinin libra dhe s'kish vend ku të hyja. Çancoja më pa që brenda, më bëri shenjë me dorë.

— Prit! — dhe dolli të më takojë. Në trotuar më vuri të dy duart në supet dhe më tha: Kur qënke shitur në Zogu ti, Lasgush?

— Ç'flet — i them unë — mor Dhimitër?

Jo ç'them unë, po shiko ç'thotë ky i poshtri, — dhe më dha librin me vjersha të Sejfulla Malëshovës. E lexova. Sikur më ra qielli mbi kokë. Ika në shtëpi. S'gjeja qetësi. S'fjeta fare.

E mendova, e mendova dhe thashë: Do t'i vete!

Të nesërmen i vajta. Sejfullai ishte atëherë Ministër i Arsimit. Vajta. Te porta ishte një partizan, roje.

Është shoku Ministër? — i them.

Ç'e doni?

S'kam ardhur të të them se ç'e dua, po të të pyes është apo jo? Ai u tremb nga toni i fjalëve të mia dhe tha: Është i zënë. Thuaj, Lasgush Poradeci kërkon një takim prej një minute. Meqë nuk më njihte, ai partizani tha se kushedi kush isha.

I tha dhe unë hyra.

Sejfullai ishte ulur në kolltuk. Kur hyra, nuk u ngrit. Dhe unë s'prita shumë, u ula dhe unë në një kolltuk përkundrejt, larg: Sejfulla — i them — as shoku, as hiç nuk i thashë. Sejfulla, nga e di ti që unë u shita në Zogu?

Jo, Lasgush, unë them se si do të bëheshe.

Ti s'thua si do të bëhesha, po si u bëra, se ti, në atë shënimin, flet në aorist:

«Lasgushi hyri në pellgun oportunist të intelektualëve të asaj kohe dhe u bë poet dallkauk»,

Dëgjo Sejfulla! Çdo gjë tjetër ti mund të ma marrësh po nderin tim si poet shqiptar ti s'mund të ma marrësh.

Në këtë çast hyri roja dhe tha: Po vjen Koçi Xoxja.

Sejfullai më tha: Eja njëherë tjetër të bisedojmë.

Hyri Koçi Xoxja dhe unë dola.

Më nuk shkova, se s'kisha ç'ti thosha.

Më nuk më thirri, se s'kishte ç'të më thesh.

*** Duhet të ketë qenë viti 1960... ndoshta edhe më parë... S'e mbaj mend se kush më prezantoi aty në kolltukët e klubit të shkrimtarëve dhe artistëve, me të ndjerin plak, shkrimtar e patriot Milto Sotir Gura.

Fjalë pas fjale biseda erdhi shpejt aty ku më tërhiqte mua më tepër, te poezia. Vetvetiu, përderisa flitej për poezi, doli dhe emri i Lasgushit.

— Ç'më flet për Lasgushin, — tha i ndjeri Milto; — Lasgushi ka tridhjet vjet që ka vdekur!

— Pse? — pyeta unë.

— Përderisa s'krijon, domethënë se ka vdekur!

Atëherë Milto Sotir Gurra, nga mosha, ishte për mua gjysh. Desha ta kundërshtoja, po s'munda. S'guxova.

Më nguli një gozhdë që më dhëmbte, por që s'e nxirrja dot.. Dhe kjo gozhdë më ka dhëmbur nja pesëmbëdhjetë vjet me radhë, deri atëherë kur Lasgushi më dha të lexoj «Kamadevën», për të cilën më kish folur shpesh herë më parë.

Ishte pasdite. Shëtisnim nëpër rrugët e Tiranës dhe bisedonim. I thashë: «Kamadeva» më pëlqeu shumë dhe ca më shumë më pëlqeu që e bëtë në këtë moshë kur të tjerëve s'ua pret mendja se mund të krijoni dhe se provuat që është akoma shpejt për mjellmën e Pogradecit që të këndojë këngën e fundit. — Ç'pret — më tha — nga injorantët? Ç'pret nga ata që s'kanë kulturë? Po e dinë ata Sofokliun e Greqisë së vjetër?

Sofokliu, i madhi tragjedian grek, ishte afro nëntëdhjetë vjet. Kishte kohë që s'krijonte më, por ishte i pasur. Djemtë, për t'ia marrë pasurinë sa më parë, e hodhën në gjyq, të bindur se do ta fitonin, duke thënë se babai është shumë plak dhe është bërë në gjendje minore dhe s'e administron dot pasurinë.

Doli Sofokliu i madh përpara aeropagut.

Përse më kini thirrur — pyeti?

I thanë: Kështu e kështu...

Fëmijë mosmirënjohës! — tha Sofokliu. Kaq tha. Pastaj iu drejtua aeropagut.

Që të provoj se s'jam kështu si thonë bijt e mij, ju lutem — tha — jepmëni një temë dhe unë do të shkruaj një kryevepër.

Aeropagu, që kishte respekt për të, i tha: Zgjidhe vetë temën. Dhe Sofokliu e zgjodhi vetë dhe në moshën afro nëntëdhjetë vjeçare shkroi prapë një kryevepër: Edipi në Kolonos.

Po Gëte-ja, kur e shkroi njërën nga lirikat e tij më të bukura, të famshmen *Marienbader Elegi*?

Kur ishte pranë të tetëdhjetave!

Po «Faustin» kur e mbaroi? Gjashtë muaj përpara se të vdiste!

Më vjen shumë keq, të dashur lexues, që s'mund të shikoni e të shijoni buzëqeshjen e tij prej Volteri, kur më thoshte këto fjalë!

*** Kam dashur të bëj një studim përmbi *rimën*,

si një nevojë shpirtërore të njeriut. Dhe kam dashur ta filloj që në fjalët e para që thotë njeriu, pa ditur se ç'thotë, por i thotë me rimë;

ma-ma

ba-ba

në-në

Po kështu, në poezinë tonë popullore dhe në poezinë popullore të të gjithë popujve ekzistojnë vargje pa kuptim, por që rimojnë, siç kemi ne:

Ono mina

Dono mina...

Pra, rima shfaqet si një nevojë shpirtërore, një tingull që njeriu ka qejf ta dëgjojë.

Kam dashur ta bëj këtë studim, por e lashë, se mendoj që është më mirë të bëj një varg se sa të bëj një studim. Studimet le t'i bëjnë ata që s'bëjnë dot poezi, ata, «Profesorët».

Ne poetët më mirë të bëjmë poezi, se ajo, poezia, formon shpirtin e kombit.

****6 Mars 1981. Ditë me diell, shumë e bukur, e ngrohtë, pas disa ditësh me shi të vazhdueshëm. Në mesditë vajta i shpura «Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe» që më kishte porosi-*

tur t'ia blija që porsa të dilte në shitje dhe priste i shqetësuar. E gjeta duke parë një copë gazetë të prerë nga «Drita» e datës 1 shkurt 1981 ku ishte një vizatim mbi luftën e Kaçanikut.

Po e shikoj, tha, se mos gjej ndonjë gjë për poemën që po vazhdoj për Kosovën, po ky piktor paska bërë këtu edhe një ushtar turk që ka hyrë gjer në pozicionet e shqiptarëve. Po të linin Ded Gjo Lulët ty, o turk, të vije kaq pranë? Të thuash për kosovarët se janë trima është tepër pak. Ata janë kreshnikë!

I thashë se i kisha sjellë fjalorin. U gëzua me një gëzim të çiltër prej fëmie. S'dinte ç'të bënte që të më kënaqte. U ngrit dhe mbushi dy gota me raki rrushi nga Pogradeci.

Gëzuar, i thashë, ta punosh gëzuar e me shëndet!

Gas paç — më tha — po tashi m'u hap një punë e madhe me këtë. Duhet të studioj sistematikisht, se mos gjej ndonjë fjalë të përshtatshme për poemën e Kosovës. Duhet punë. Se kultura bëhet me punë, dhe ne e bëjmë këtë se përfaqësojmë kombin. Ne, njerëzit e kulturës, e bëjmë dhe e përfaqësojmë kombin.

Unë mund ta përfaqësoja kombin shqiptar, për shembull, në Greqi, po të isha mirë me shëndet dhe të mundja të vija. Them kështu, jo se dua të vete, po se duhet të vete për ta përfaqësuar Shqipërinë me dinjitet në ato kongrese a mbledhje me njerëz të kulturës. Po të flisja atje, do të thosha: «Zotërinj! Grekë!

Të dy popujt tanë kanë patur fatkeqësinë të

kenë mësuar të parën gjë, se si të urrehen. Këtë ua mësonin qeveritë e tyre.

Po, ku është mbreti Kostandinos? Ku është Zogu?

Tani, ne që patëm mësuar të urrehemi, ka ardhur koha të mësojmë të duhemi. Dhe farën e dashurisë e mbjellim ne, njerëzit e kulturës. Ju kini bërë një luftë legjendare kundër Turqisë që e kujtojmë edhe sot me poezitë si kjo:

*U mplaka, djema, si komit,
Për dyzet vjet si kapedan
Si kapedan i kleftëve
Do shkoj të shlodhem
Si murg në manastir,
Po poshtë rasës së zezë
Do t'i mbaj robot e komitit
Dhe s'do të ve të djeg thimiam
Po barot do hedh të digjet.**

Dhe poezitë dhe këngët si kjo i bënë ata djemtë tuaj të vishen ushtarë dhe të shkojnë në front përpara se të jepte urdhër qeveria për mobilizim dhe i zunë italianët të gjallë.

Po edhe unë s'do të isha sot t'ju flas këtu po të mos kisha patur një stërgjysh me emrin

* — Këtë poezi ma recitoi greqisht të tërë dhe pastaj më bëri përkthimin varg për varg, duke thënë greqisht pastaj shqip. Ishte poezi që i pëlqente shumë, ma kishte përmendur dhe herë tjetër.

Kastriot, që i qëndroi për njëzetepesë vjet me radhë të njëzet e shtatë ekspeditave të sulltanëve më të tmerrshëm të Turqisë dhe jo vetëm që s'i la të merrnin kryeqytetin e trimërisë — Krujën, por mbrojti dhe qytetin e muzikës — Vjenën, edhe qytetin e dritës, Ville de la lumière, — Parisin dhe s'i la t'i jepnin tagji kalit të tyre në altarin e Shën Pjetrit, në Citta eterna, në Romë.

Edhe djemtë tanë, si djemtë tuaj, në luftën kundër Italisë shkuan jo si rekrutë, po vullnetarë që ju bindeshin vetëm urdhrave të atdheut. Ne, pra, që duam të jetojmë vetë të lirë, e çmojmë dhe e nderojmë lirinë e tjetrit.

Kam erdhur në Greqi përmes zjarrit të luftës së parë botërore. Babai im ishte nacionalist. Më dha gjashtëdhjetë napolona dhe më tha: Shkruaju në çdo shkollë, vetëm jo në ato ku bëhet mësimi greqisht!

Dhe unë u shkrojta në liceun francez të Selanikut.

Ishte koha kur na mësonin të urreheshim, por mua, djemtë grekë më deshën kur u thesha se jam shqiptar dhe dilnim së bashku bënim serenada.

Ja disa nga ato gjëra që do të thesha.

Po pastaj, kush më mirë nga unë do të fliste për Homerin, për poezinë popullore greke që unë e di përmendësh, për poetët grekë? Unë, kur isha në gjimnaz, shkruaja vetë poezi greqisht.

Në kohën e Zogut, kush më mirë se unë

mund ta përfaqësonte Shqipërinë për të marrë
eshtrat e Naimit? Po atëherë dërguan një kolo-
nel...

*** 21 Mars 1981. E shtunë pasdite, Sapo
vajta nga Lasgushi, e shoqja, e gëzuar, zgjati e
më dha një gazetë të palosur. Ishte gazeta
«Fjala». Pak përpara meje kishte qenë Andrea
Varfi. Ai e kishte sjellë Këtë gazetë Lasgushi
e dinte prej kohësh që kishte dalë me shkrime
të posaçme me rastin e tetëdhjetë vjetorit të
lindjes së tij. Për këtë dikush i pat thënë këtu,
po dhe i patën shkruar nga Kosova. I patën
shkruar se edhe ja kishin dërguar atë numur
të gazetës, por deri atë ditë s'i pat rënë në dorë.

Merre lexoje — më tha.

Po dale — tha e shoqja — ti s'e ke lexuar
vetë.

Po kur themi: Dale, s'ta jap, se s'e se kam
lexuar vetë, tregon egoizëm. Sa keq! Sa keq që
kjo botë ka kaq shumë egoizëm!

Gazetën ia ktheva të nesërmen. Pas disa di-
tësh biseduam përsëri. Ai më fliste duke pasur
gazetën përpara.

Më vjen mirë — tha — se këta e kanë bërë
gjithçka nga gjithë zemra. Po s'kanë bërë mirë
që paskan vënë kritikën.

Në jubile s'vihen kritika. Vihen vetëm lëv-
data.

Ja kështu u bë kur u festua gjashtëdhjetë

vjetori i lindjes së Asdrenit, në Rumani, me iniciativën e Mitrush Kutelit. U shkrua në gazetën «Shqipëria e re», po vetëm lëvdata u shkrua. Edhe unë, i dërgova një mesazh nga Vjena, se atëherë isha në Vjenë, s'bëra kritika, po lëvdo-va librin e tij «Ëndrra e lotë». Po kështu u bë kur u festua jubileu i Emineskut në Rumani, Hazhdeu, linguisti i madh rumun, që me gjallje të Emineskut pati shkruar: Nga Eninesku rumunët s'patën ndonjë dobi të madhe. Pastaj ia njohu meritat dhe shkroi fjalë lavdëruese për të.

* * * Dokumentat e *Nikola Naços* i kishte një nip i tij, Vani Burda, patriot i madh, ishte fotograf në Korçë dhe në Bukuresht. Banonte në një kasolle përdhese në periferi të qytetit, më shumë se dy orë rrugë larg nga qendra.

Ato dokumenta me siguri kanë humbur.

Edhe *Asdreni*, në fund të jetës së tij, paska banuar në një kasolle të tillë në periferi të Bukureshtit. Këtë ma tha Fullani, të cilin e dërgoi Qeveria të mblidhte dokumentat për Asdrenin. Edhe unë, për një kohë, kam banuar në një nga këto kasollet e periferisë, që i kanë të gjithë qytetet e mëdhenj. Banoja bashkë me një rumun, që ishte poet dhe piktor. Jonel (Jon) Doboshariu i thoshin. Kish talent, po s'kishte atë egoizëm që kisha unë për të bërë veprën e vet të përsosur në art.

*** *Vani Cico Kosturit* iu vra djali në Orman Çiflik të Korçës, dhe ai vajti e mori djalën vetë. Gjylja i kishte hapur kokën djalit dhe i qenë derdhur trutë. Me duart e veta Vani Cico Kosturi ja mblodhi trutë djalit. Nuk qau, po i tha: Ta kam zili, o bir, për këtë vdekje të bukur që bëre, se ti vdiqe për atdhe.

*Ky qe Vani Cico Kosturi.
Ka patur burra Korça!*

* * * Në Manastir, kur bëhej Kongresi i Manastirit, shkoi dhe Çerçizi me Mihalin. Që të dy të armatosur.

Për në vendin ku do të mbahej Kongresi shkuan hipur në një llandon luksoz të tërhequr nga katër kuaj. Rrugës përmbi ta fluturon-te një korb. Kjo gjë Çerçizit iu duk si një shenjë e keqe. Shau me një sharje të rëndë, siç shajnë burrat, dhe ngriti pushkën e qëlloi.

Karroca ecte, korbi fluturonte, por Çerçizit korbi nuk i shpëtoi.

Të lumtë Çerçiz — i tha Mihali — Kongresi do të na vejë mbarë!

* * * Mbaj mend, isha i vogël, në kohën e Turqisë, kur zbrisnin fshatarët ditën e pazarit, ishin të gjithë me pushkë, të armatosur dhe pazari dukej si një pyll me pushkë.

* * * Risto Siliqin s'e pata njohur sa ishte gjallë. Ka qenë patriot dhe luftëtar. Luftoi përkrah Dedë Gjo Lulit në luftën që bëri Kosova kundër Turqisë. Për ngjarjet e kësaj lufte shkroi librin: «Pasqyra e ditëve të përgjakshme».

Ishte dhe poet. Poet patriot si të gjithë rilindasit...

Vdiq në kohën e Zogut.

Pasi kish vdekur, unë shkova në Shkodër të kërkoja mos kishte lënë ndonjë shkrim. Me të pyetur andej e këtej e gjeta shtëpinë. Adresën e mbaj mend dhe sot: Rruga e Gurazesve Nr. 18. Trokita, më doli një grua.

Zonjë — i thashë — unë jam profesor (profesor i thashë, se me këtë emër, me këtë titull, përmbledheshin të tërë njerëzit me shkollë atëhere) dhe dua të di në ka lënë ndonjë shkrim i ndjeri, burri juaj, se dua të shkruaj për të.

Unë, zoti profesor — më tha — s'di se ç'bente burri. Ja, atje është një arkë që ka ca libra. Shiko atje.

Pashë dhe gjeta dorëshkrime. U gëzova.

— A mund t'i marr unë këto? — i thashë.

— Merri.

Po të mos i kisha marrë unë, mund të kishin humbur.

Jo mund, po do të kishin humbur!

Unë i mora, i studiova dhe i ndava në dy pjesë poezitë që kishte shkruar: Ato me vlera linguistike (se kishin fjalë të rralla, të pa për-

dorura nga të tjerë) dhe poezi me vlera si poezi. Doemos si poezi minore.

Fjalët e rralla, që s'i kuptoja, me të pyetur nëpër Shkodër, i shpjegova. Bëra dhe një studim biografik.

* * * Kur erdhi Asdreni në Shqipëri, në fshatin e tij, në Boboshticë, duke e dëgjuar nga goja e tij, kam shkruar autobiografinë e Asdrenit dhe e kam këtu, në dokumentat e mia.

* * * Kur u ngrit monumenti i Luftëtarit Kombëtar në Korçë, u hap një si anketë ku ftoheshin të tërë të jepnin mendime se çfarë të shkruhej në piedestalin e tij si kushtim.

Unë atëherë isha jashtë dhe dëgova letër ku shfaqja mendimin që të vihej ky varg i Asdrenit:

«Si trashëgim ju lemë shpirtrat tanë...

Këtë nuk e pranuan dhe vunë atë kushtim të thatë që ti e di.

* * * Në Liceun francez të Selanikut ne nxënësit kishim formuar orkestrën tonë me pesëdhjetë veta. Unë kisha atje klarinetin e vogël si bemol.

* * * Tërë jetën time, të gjitha ngjarjet që kanë pasur të bëjnë me mua ose jo, i kam parë me *Ataraksi*.

Ataraksi është parimi filozofik i filozofit të Romës së vjetër *Sekstus Empirikus*. Këtë e kënim në shkollë që kur isha njëzet vjeç.

Ky parim të mëson të shohësh me gjak të ftohtë, me qetësi, çdo gjë që ngjet rreth teje, për mirë ose për keq. Të mos gëzohesh shumë, të mos hidhërohesh tepër. Ataraksia s'është indiferecentizëm, Jo! Ajo të mëson ta njohësh dhe ta gjykosësh çdo gjë pa pasione.

* * * Vlerën e një kombi e bën tradita e tij. Sa më e fortë të jetë kjo traditë, aq më i fortë është kombi. Kjo traditë nisët që nga kohët më të lashta dhe vjen gjer në ditët tona si hallka të një zinxhiri të madh. Dhe këto hallka janë të trasha dhe të rënda, hallka kovaçi.

Cila është *hallka e parë* e zinxhirit të traditës sonë?

Pellazgët! Ata janë të parët tanë.

Tani pellazgët s'i përmendin. Edhe Çabeu s'i pranon pellazgët si paraardhësit tanë. S'i pranonte as Jokli.

Jokli kishte të drejtë, se, si shkencëtar gjuhëtar, nuk kishte prova bindëse që t'i pranonte pellazgët. Por gjuha s'është i vetmi argument. Hallka e dytë janë Ilirët. *Magnum Ilirikum* i tha romaku, se kjo Iliri shtrihej që nga burimet e Danubit dhe gjer në Greqi. Perandoria e tme-

rrshme e Romës të tërë popujt që nënshtroi i romanizoi.

Francezët, spanjollët, u romanizuan.

Dakët, u romanizuan.

Ilirët — jo! As u nënshtroan, as u romanizuan.

Prandaj ne sot flasim shqip!

Hallka e tretë është Skënderbeu ose më mirë Gjergj Kastrioti, lufta e tij madhështore më se njëzet e pesë vjeçare.

Gjergj Kastrioti, më i madhi ndër gjeneralët e botës, vdiq në kulmin e lavdisë; kurse tërë gjeneralët e mëdhenj të botës kanë vdekur të mundur, që nga Hanibali dhe gjer në Napoleon Bonaparti. Gjergj Kastrioti, që futi në dhe dy sulltanë dhe s'i la t'i jepnin tagji kalit në altarin e Shën Pjetrit, përbën këtë hallkë tjetër të rëndë dhe të fortë të traditës sonë.

Pas kësaj vjen ajo hallka tjetër — e fortë dhe e shkëlqyer — Rilindja! Rilindja, ajo e bëri Shqipërinë!

Po Rilindjen kush e bëri?

Për Rilindjen punuan të tërë, por një rol të madh ka luajtur Korça.

Ku filloi Rilindja? Jashtë Shqipërisë. Në kolonitë shqiptare të Misirit, të Bukureshtit, pastaj në Amerikë.

Nga ishin shqiptarët e këtyre kolonive?

Përgjithërisht, nga Korça ishin.

Nga Korça ishin punëtorët e thjeshtë të mërguar, të varfër dhe pa shkollë, por patriotë, nga Korça ishin dhe milionerët si Tashko, Lakçe, Jani Vreto e të tjerë.

Po, pse, rastësisht u çel shkolla e parë shqipe në Korçë?

Patriotët korçarë ishin ata që jepnin paratë në Bukuresht për të shtypur librat. Korçar ishte Mandi (Dhiamandi) Tërpo që fali shtëpinë për të bërë shkollë.

Dhe ishin patriotët korçarë që dërguan fëmijët në këtë shkollë, prandaj dhe apostulli i Rilindjes, Naim Frashëri, ja vuri Korçës atë kurorën e lavdisë:

*Lumja ti moj Korçë, o lule,
Ç'i le pas shoqet e tua,
Si trimi në ball' u sule,
Ta paçim përjetë hua!*

Kjo kurorë lavdie, që i vuri Naimi Korçës, nuk do të vyshket kurrë!

Çfarë nuk nxori Korça në kohën e Rilindjes! Luftëtarë? — po! Shkrimtarë? — po! Poetë? — po!

Ata poetë i bënë këngët që i këndonin të gjithë, që i këndojmë edhe sot.

Përmendi tërë emrat e rilindësve. Më të shumtit të më të zjarhtëve janë korçarë.

* * *Kur marrim dhe analizojmë figura të shquara të historisë sonë, duhet t'iu vemë në dukje të mirat, por duhet të shohim edhe të

metat, që të formojmë kështu figurën e pastër të patriotit.

Kështu formohet shpirti i kombit.

Emri patriot është i madh, por duhen kualitete që ta meritosh!

Ja, për shembull, Fishta!

Kur erdhi Italia e bëri anëtar të Akademisë së Italisë. Mirë. Po ti Fishtë, poet shqiptar, çdo që vete në Akademinë e Italisë dhe mban fjalën e prezantimit; «E drejta romake në Shqipëri»? Pse të mos flisje për poezinë popullore shqiptare që ti e njeh aq mirë?

Kjo është njollë.

Ja dhe Asdreni. S'ka patriot më të kulluar!

Po ç'vete më bën atë poezinë: «Besim, Bindje, Luftim»?

Të lejohet ty Asdren kjo?

Politikani le të bëjë ç'të dojë. Patriotit të vërtetë s'i lejohet. Ca më pak, poetit!

Në, kur vemë në duke këto të meta, nuk kem- qejf të shajné njërin e tjetrin, por duam të formohet e pastër ndërgjegjja e kombit që asnjëri të mos ketë iluzion se mund të quhet ose të vetëquhet patriot, duke pasur njolla të tilla.

Figura e patriotit duhet të mbahet e pastër. Këtu s'duhet të falim! As bota nuk falin asgjë. Le të jetë makar. Perandor!

Napoleoni i III-të perandor ishte, por Enciklopedia Larousse shkruan për të: ishte kopil.

Pse e shkruan? Që ta shajë? Jo, por të jesh Perandor duhet të kesh kualitete të tjera nga një njeri i zakonshëm,

* * * Atëherë, kur shkua në Shkodër me Asdrenin, vajta në Kuvend të Gjergj Fishta, por nuk e gjeta. Kur atij i thanë se e kisha kërkuar, mori makinë, veturë dhe doli më kërkonte nëpër Shkodër. U takuam dhe shkua në Kuvend. Atje Fishta më tregoi një poezi satirike për Viktor Emanuelin, por që nuk e mbaj mend tashti. Kjo — më tha — ka me u botue pas dekës sime.

Fishta ka qënë shumë i fortë si satirik. Unë desha atëherë të botoja një studimin tim mbi Fishtën si satirik, por Ernest Koliqi më tha: Ti, Lasgush, më mirë shkruaj për Fishtën si lirik. Dhe unë shkrova dhe e botova në revistën «Shkëndia» që e drejtonte Ernest Koliqi, artikullin «Fishta Lirik».

* * * *Jani Vreto* ishte apostull i Rilindjes. Ai themeloi shoqëritë shqiptare në Bukuresht, në Sofje dhe në Egjipt.

* * * *Alo bej Dishnica*, bej ishte, po i ka ndihmuar ata që punonin për Shqipërinë. Në kohën e Turqisë, pogradecarët ndërtuan një kishë. Kishën e ndërtuan, po kambanë s'kishin. Dërguan dy veta të vinin ta blinin në Selanik. Rrugës, myslimanët fanatikë i vranë. Mori vesh

Alo Beu. Erdhi në Pogradec në ditën e pazarit dhe thërriste:

Do t'ju a shuaj shtëpinë dhe fshatin atyre që ngasin kaurët, se Shqipërinë, kur ta bëjmë, kaurkë do ta bëjmë!

Dhe nëna ime, kur ishim të vegjël; na thoshte;
Ja si bie kambana Dam... Dam... Dam...
dhe thotë Aloobé, Alobé, Aloobé! Se sa na ka mbrojtur.

Alo beu e ka mbrojtur edhe Vasil Avramin, se deshini ta vrisnin grekomanët.

Ai, Alo beu, nxori tellallin të thërriste në pazar:

«Kush vret Vasil Avramin do t'ja shuaj shtëpinë, pasurinë, fshatin do t'ja shuaj!

Kështu ka thënë Alo Beu!»

* * * Pas formimit dhe konsolidimit të shtetit shqiptar u çelën konsullata në disa vende, ndër këto edhe në Rumani; në Bukuresht. Konsulli i parë ka qenë një korçar që banonte prej kohësh në Rumani, një i qojtur Bazile (Vasil) Dogani.

Ishte burrë i mirë e i urtë, i pamartuar. Punonte në një institucion financiar. Nuk pranonte të merrte rrogë nga shteti shqiptar për funksionin që kryente. Deshte vetëm të ishte konsull, se e kishte për nder të që i pari konsull shqiptar në Bukuresht. Idealist!

* * * Kishim njëherë një mbledhje në Ndërmarrjen e Botimeve, ne përkthyesat. Këtë rradhë na kishin thirrur të diskutonim planin e përkthimeve dhe të botimeve.

Ishim dhe ne, Paskoja dhe unë.

E, në atë mbledhje, se kush tha:

«Të bëjmë një histori të vulgarizuar të Ali Pashë Tepelenës; se e pëlqen populli». Dakord — thanë disa të tjerë.

Dhe ai i pyeste me radhë: Ç'thua ti, Ç'thua ti? Erdhi rradha në Paskoja.

Shoku Pasko, shoku Pasko, ç'medoni, ju, shoku Pasko?

«Unë jam kundra! — tha Mitrushi —

— *«Jam kundra; se Ali Pashë Tepelena qe shqiptar me gjak, po s'qe shqiptar me shpirt. Shpirtin e kish turk. Ali Pasha Tepelenasi nuk luftoi për Shqipërinë, po për Alinë. Nuk vrau turq, si Skënderbeu, po vrau shqiptarë».*

Këto tha Paskoja i madh dhe historinë e Ali Pashës u la. Ata se kundërshtuan dot.

Prandaj, ti mirë na i ke bërë, po na i bëj edhe më mirë atë poezinë e Suliotëve (1), se Suliotëve duhet t'u këndojmë që qenë shqiptarë me gjak e me shpirt dhe jo Ali Tepelenasit, Pashajt të Turqisë të cilit himariotët trima i kënduan kështu:

«Të mbahi djema, të mbahi,

1) — Në atë kohë kisha shkruar një poemë për Suliotët.

Se u thye Ali Pashai
Pa dëgjo o Ali Pasha:
Ne s'jemi çupa nga Narta
Që të loç me ta nga nata.
Ne jemi kapëdanata!

Lasgushi
për artin
dhe poezinë

dhe drita ndriti nd' errësirët edhe
errësira nuk e kupëtoj

Ungjilli pas Johanit krye 1, 5



*** Përse na duhet arti?

Pse torturohemi, me tërë këto rima, ritme, vargje gjashtë, shtatë, tetërrokësh, njëmbëdhjetë rrokësh gjashtëmbëdhjetërrokësh?

Ç'rri ky Mikelanxhelo e pikturon tërë atë tavan? Përse gdhënd mermerin?

Ç'do Bethoveni që shkon rrugës si i çmendur, duke kompozuar e duke lëvizur duart?

Ç'është ky mister? Ç'i duhet njeriut arti?

Jeta është e shkurtër, po sa e shkurtër është aq është dhe e rëndë. Lindim me të qarë, rritemi duke qarë, humbin nënën, babanë, të afërmin, shokun, shoqërinë, humbin të dashurën, dashurinë humbim rininë, jetën, shpresën...

Për të gjitha këto dhimbje njeriu kërkon një ngushëllim, një kënaqësi. Dhe këto i gjen te arti.

Prandaj misioni i artit është të na japë një kënaqësi estetike që qëndron përmbi të gjitha këto mizerje të jetës.

Këndojmë një poezi, shikojmë një pikturë, dëgjojmë një simfoni dhe kënaqemi! Jeta na ëmbëlsohet, na bëhet e dashur, e bukur...

— Por këtë nuk e ndiejnë të tërë njerzit, prandaj dhe arti nuk është për të gjithë njerzit. Është për ata shpirtrat e lartë, që e ndiejnë. Të tjerët gjejnë të tjera kënaqësi. Hanë, pinë, vishen, dëfresjnë dhe kënaqen. Arti nuk është për ata. Ata ne nuk i shajmë, as nuk i përçmojmë sepse nuk e ndiejnë apo nuk na e duan artin. Nuk është faji i tyre se arti është për shpirtra të tjerë, të lartë, me të tjera kualitete.

Arti është për një pakicë njerzish, për një elitë të zgjedhur shpirtrash të lartë. Ja, të marrim poezinë, atë më të mirën: Pjesa më e madhe e njerzve as që e dinë se ekziston. Një pjesë e ka dëgjuar, por nuk e ka lexuar.

Një pjesë e di, e lexon, po nuk e ndjen, nuk e kupton dhe e harron. Një pjesë fare e vogël e di, e lexon, e mëson, e përsërit dhe kënaqet

me të. Ndjen atë kënaqësi estetike të veçantë që na i jep vetëm artisti.

Po artisti përse krijon? Që të na kënaqë neve?

Përse këndon bilbili?

Përse këndon bufi?

Përse këndon qyqja, grifsha? Po, për vete këndojnë! S'këndojnë që të na kënaqin neve! Ku e di bilbili se jemi ne kur e mbush pyllin me këngët e tij! Ku e di bufi! Ai këndon. Buuu!... Buuu!...

Për ne këndon? Jo! Këndon për vete!

Po artisti për ne krijon? Jo! Krijon për vete?

Tjetër punë, pastaj, në se krijimi i tij na kënaq dhe neve, por artisti i madh krijon për vete.

Pse, Mikelanxhelo e pikturoi kapelën Sikstina që të kënaqte Papën? Apo Kardinalët? Apo popullin, injorant të asaj kohe! Jo more! Ai e pikturoi që të ngopej vetë me artin e tij! Tjetër punë se ngopemi dhe ne.

Prandaj thamë se misioni i artit është të na japë një kënaqësi estetike, por në radhë të parë artistit, pastaj të gjithë të tjerëve që mund ta ndjejnë, ta shijojnë,

E njëjta gjë është edhe për poezinë.

Pse, mos e bëri Danteja poezinë e Beatrices që të kënaqte Beatricen? Beatricja, dhe në ka ekzistuar, as e ka lexuar, se do të mos ketë ditur shkrim...

Përkundër, Danteja e bëri atë poezi që të shkarkonte potencialin e zemrës së vet, që të

derdhte atje shpirtin e vet, që të kënaqej vetë.
Për vetë e bëri, jo për ne dhe as për Beatriçen.

Po ne e lexojmë dhe kënaqemi.

Ndjejme shumë nga gjërat që ka ndjerë dhe
ai vetë.,

Na dha, pra, një kënaqësi estetike.

Ecco! Ky është arti!

* * * Një ish-profesori im i letërsisë, i cili e
respektonte Lasgushin dhe pati me të një mi-
qësi të shkurtër, më thosh një ditë, duke e për-
cjellë për në shtëpi:

«Edhe ky Lasgushi seç ka ca koncepte të çu-
dishme mbi artin dhe poezinë! Ato e kanë pen-
guar që ai të futet në trajtimin në poezi të te-
mave shoqërore.

Unë këndoј — thotë — siç këndon bilbili, bu-
fi, grifsha! Fjalë janë këto! Më vjen keq. Kjo
e ka dëmtuar poezinë e tij të shtrihej më gjerë
dhe të trajtonte probleme të kohës. Më vjen
keq!»

Mirë, i dashur profesor. Sado ta bisedojmë
e sa do t'i themi Lasgushit, s'e bindim dot. Mirë
atë, po Gëtes ç't'i themi që shkruan të tilla var-
gje:

«Inch singe, wie der Vogel singt,
der in den Zweigen wohnt;
das Lied, das aus der Kehle dringt,
ist Lohn, der reichlich lohnet.»

J. V. Goethe «Der Sanger» (këngëtari)

Vetë Lasgushi i ka përkthyer kështu këto vargje të Gëtes:

*Unë këndoj posi një zog,
Që rri këndon nër fletë;
Dhe kënga që shpërthen vetiu,
Shpërblim është ajo vetë;*

***Një poezi, që të jetë e mirë, duhet të jetë e singertë. Po që të jetë poezia e singertë duhet të jesh më parë i singertë, gjer në fundt të shpirtit tënd, ti, që e shkruan. Në poezi s'gënjën dot!

* * * Një ditë, besoj të ketë qenë qershor 1985, vajza e Lasgushit më tha; «Më pëlqyen disa poezi që lexova të përkthyer nga të Fransua Vjonit.»

— Nga kush? — pyeti Lasgushi, që rrinte shtrirë e dukej se s'e kishte mendjen aty.

— Nga Fransua Vjoni — tha ajo.

— S'lexohet Vjoni, po Viloni. Bën përjash-tim nga rregulli, se është emër familjar. Vilon — lexohet. E mbaj mend, na i thoshte profesori në klasën e dytë të Liceut: Francua Vilon! Jo, Vjon!

Kjo ishte, pra, kujtesa absolute e Lasgushit të-tëdhjetë e pesëvjeçar!

* * * Më kot mundohen nëpër shkollat të mësojnë se si bëhet poezia. Atje mësojnë vetëm ca rregulla të thata, po se si duhet bërë poezia e gjen vetë poeti, po të jetë poet. Se s'e ka thënë më kot latini:

«Poeta nascitur. Orator fit.» (Poeti lind. Oratori bëhet.)

* * * Leonardo e mësoi artin në studion e Verrokios. Unë e mësova në atelierin e Lasgushit. Punishtja ime është zemra ime.

* * * Ata, «Kritikët», «Profesorët», gjermanë ose jo gjermanë, kur flasin për poezinë gjermane, pas çdo fjale thonë: Gëte! Gëte! dhe pasi ta kenë përsëritur këtë emër nja njëqind herë, thonë edhe Hajne. Po ja ku të them unë që e njoh poezinë gjermane se Gëte as që mund të krahasohet me Hajnen për nga ëmbësia e vargut dhe sinqeriteti i shprehjes poetike.

* * * Që të ndjesh gëzimin estetik të poezisë, duhet ta kuptosh atë menjëherë, pa asnjë koment, pa shpjegime. Nevoja për ta komentuar e për të kërkuar paprerë shpjegime nëpër të gjitha qoshet e librit, e shpërndan mendimin dhe e copëzon ndjenjën që lind nga leximi i poezisë.

* * * Qëllimi i artit është të na japë gëzim estetik, po këtë gëzim e ndjen ai që është përgatitur për ta ndjerë.

Prandaj duhet kulturë e madhe.

Ata «Profesorët» që e studiojnë poezinë, po që s'e kuptojnë dhe s'e ndjejnë poezinë, misteret e saj, thonë:

«Nganjëherë edhe Homeri fle.»

që domethënë se nganjëherë, në ndonjë pjesë, edhe Homeri s'është aq i qartë, apo aq i thellë, apo aq i përsosur.

Kjo s'është e vërtetë.

Homeri s'fle. Atij ashtu i duhet në atë pjesë, të jetë i errët, i cekët, që të vërë më mirë në dukje pjesën tjetër. Ku e gjen të drejtën ti kritik të thuash: s'është mirë. Njeriu me kulturë thotë: Mua më duket sikur s'është kështu. Po ti nuk vendos. Vendos artisti. Ai do të jetë i errët se ashtu i duhet. Ti, po të kesh kulturë, kuptoje!

Gëteja, volumin e dytë të Faustit e ka të errët, s'kuptohet. Po ka guxuar ndonjëri gjer më sot të thotë se s'bën. Të gjithë e studiojnë dhe mundohen ta kuptojnë. Edhe Gëten e pyesnin; mos ke dashur të thuash këtë gjë? Mos ke dashur të thuash këtë?

Dhe ai përgjigjej. Edhe atë, po jo vetëm atë...

Edhe këtë, po jo vetëm këtë..

Muzika ka ligjet e saja. S'mund të vesh një

notë që s'u përshtatet notave pranë, se çirret, nuk shkon në harmoni me të tjerat.

Bethoveni, në një nga simfonitë (nuk e di në cilën, s'e mbaj mend, se e kam të lexuar, s'e kam gjetur unë) pra, Bethoveni në një nga simfonitë, në një vend ka një notë që nuk u nënshtrohet ligjeve të harmonisë, del çjerrëse.

Po mund të themi se Bethovenit i ka shpëtuar? I shpëtonte dot ajo notë gjeniut të muzikës? Po guxon dot, gjer më sot, ndonjë kritik të thotë se ajo notë s'është mirë?

Ashtu i duhet artistit dhe ashtu e bën.

Tërë muzika e Stravinskij është e ndërtuar me diskordanca, po ka guxuar ndonjë kritik gjer më sot të thotë se s'është e bukur?

Dhelpra, ujku, ariu janë kafshë, qenie të urryera, po të vjen artisti dhe të bën një dhelpër, një ujë, një ari të paraqitur artistikisht dhe na ngop.

Arti ka misteret e veta, që as artisti vetë s'di t'i shpjegojë. Si do të mundësh t'i shpjegosh ti kritik dhe ca më keq akoma, ti kritik pa kulturë?

Arti ka misteret, po ka dhe ligjet e veta. Edhe poezia ka misteret dhe ligjet e saj, dhe vetëm njërit prej këtyre ligjeve sikur të mos iu përshtatet, poezia del e çalë.

Një nga këta ligje është shkurtësia.

Poezia duhet të jetë jo shumë e gjatë.

Një poezi duhet të jetë jo vetëm e bukur, por edhe aq e gjatë sa të mos e mërzhitë lexuesin.

«Iliada» është vepra më e mirë poetike, po

kush e merr ta lexojë? Po cili poet e lexon?

E lexojnë tepër pak. Pse? Se është e gjatë.

«Mahabharata»¹⁾ që do të thotë «bëma të mëdha» (vepra heroike) apo «Ramajana», poema të mëdha të kulturës së madhe Indike, kush i lexon?

Kush e lexon «Shahnamenë», e Firdusiut?

S'i lexojnë jo se janë të vjetra, po se janë të gjata.

Prandaj poeti duhet të jetë kursimtar i madh në fjalë, të thotë maksimumin e ndjendjave në minimumin e fjalëve.

* * * Në revistën «Albania» të Faik Konicës kam dërguar vetëm një poezi. Isha shumë i ri atëhere. Kur dërgova poezinë, i shkrojta Faikut:

Me të gjithë respektin dhe përunjësinë e madhe që kam për ju dhe revistën tuaj, kam këtë kërkesë: Poezisë sime, kur të shtypet, të mos i ndryshohet asnjë pikë përmbi i.

Poezinë e dërgova të shkrojtur bukur me atë shkrimin tim, siç e di,

Por kur u shtyp vargu:

1) Mahabharata — kjo fjalë nga sanskritishtja e vjetër — më thoshte Lasgushi — mund të shpjegohet vetëm me shqipen:

Maha — d.m.th. mëdha, të mëdha

Bharata — d.m.th. bëratë, të bëratë

pra, të bëra të mëdha, bëma të mëdha.

Shpirti im i nxirë krejt»
ishte bërë

Shpirti im i mirë krejt»

Gabim shtypi? S'e di! Di se vetëm ndryshimi i fjalës *i nxirë* në *i mirë* e shkatërroi të tërë poezinë.

Po mund të thuash se në numrin tjetër të revistës bëhej një shënim për ndreqjen e gabimit. Ç'e do? S'vlen!

Ai që e lexoi, poezinë me këtë gabim dhe nuk i pëlqeu, mund të mos e lexojë numrin tjetër të revistës ku është bërë ky shënim, ose e lexon atë numur, po shënimin që vihet në fund të faqes së fundit nuk ia ze syri. Pra, poezia mbeti e sakatuar, e deformuar, e shëmtuar vetëm nga ndryshimi i një fjale.

Që atëherë në revistën «Albania» nuk dërgova poezi tjetër.

* * * Vetëm sakrifica, kushtimi total, devotamenti total, veç sakrifikimi i jetës materiale. i interesit material, e mposht kohën, e fiton kohën, duke na drejtuar, duke na shpënë prej mizerjes pragmatike, prej makulaturës dhe elukubracionit të jetës materiale, të interesit material, duke na drejtuar dhe shpënë prej afirmacionit të ashpër e të turbullt utilitarist, në purifikimin spiritual, në ëndjen e vetme, në të vetmen ëndje, në uniken ëndje-spirituale.

* * * Gjeniu i beson përhumbësisht asaj që krijon, nëpërkëmb interesat, të gjitha, e sidomos interesat materiale.

* * * Arti është më i fortë se natyra, më i përsosur. Natyra s'është e përsosur. Ka në natyrë ndonjë pejsazh të përsosur? Jo! Piktori, artisti i madh, e bën nga natyra pejsazhin të përsosur. Moisiu mund që ka qenë një njeri me pamje dosido, me mjekër të ashpër a me qime të rralla, ndoshta ishte dhe i shkurtër, po ja ku të vjen Mikelanxhelo dhe ta bën atë Moisi me atë mjekër aq të bukur, me atë ballë të lartë, taman profet. Ja arti!

E bëri më të përsosur se natyra.

* * * Në art njeriun duhet ta paraqitim me të mirat dhe të këqiat d.m.th. me drit' e hije, njeri të gallë. Ato që ne i quajmë të mirat dhe të këqiat s'janë as të mira as të këqia; ato janë cilësi inhereente të natyrës, natyra vetë. Pa ato s'mund të jetë njeriu njeri. Mund të jetë engjell, shumë i mirë, po njeri — jo! Pse është Shekspiri i madh? Sepse na i përshkruan njeriun njeri. Otelloja, Hamleti, Makbethi s'mund të mbarojnë veç se ashtu si mbarojnë, sepse ky fund është pasojë e vetë karakterit të tyre. Po të mbaronin ndryshe, do të dilnin falsë.

* * * Një ditë i thashë:

Kam lexuar në Enciklopedinë Larousse pjesën ku flet për letërsinë shqipe. Juve ju quan poet filozof. Lasgushi u inatos, hyri e doli disa herë nga dhoma dhe më në fund, duke përpjekur portën tha:

«Filozofinë e bëjnë filozofët. Unë bëj poezinë! Dhe pas pak:

«Paska qënë idiot!»

* * * Lesingu e shpjegon dhe e komenton mirë skulpturën e Laokoontit. Për cilindro që kërkon të thellohet në kuptimin e artit të vërtetë, leximi i Laokoontit të Lesingut është i domosdoshëm. Por duhet shkuar më tej. Lesingu, duke qënë gjerman, vazhdon atë traditë, të bukur, të futur në kulturën gjermane nga Vinkelmani (Winckelman), të admirimit pa kushte të artit klasik grek. Duke e marrë si shëmbull Laokoontin, Lesingu harron se kjo skulpturë ka të meta të mëdha nga ana artistike.

Shprehjet e fytyrave, lëvizjet, kontraktimi i figurave përpara atij tmerri të gjarpërinjve, janë të zbehta dhe jo të natyrshme. Qëndrimi i figurave është tepër statik dhe jo shprehës.

*** Komedia duhet të ketë brenda tragjicitet përndryshe s'është potente.

Kristo Floqi kushedi sa komedi ka shkruar! Plot! Po s'janë të fuqishme, se s'kanë tragjicitetin brenda.

Kështu kthehen në pjesë vetëm për t'u argëtuar. Estradë. Komeditë e Molierit, Kopraci, Tartufi kanë tragjicitet. Don Kishoti gjithashtu ka atë tragjicitet që na bën ta duam. Sejcili nga ne nuk është në një farë mënyre pjesërisht edhe Don Kishot?

Cili nga ne s'ka pasur apo s'ka një Dulcine të adhurueshme? Edhe vetë «Mbreti Lirë» s'është gjë tjetër veçse komedi, por pjesën tragjike, tragjicitetin e ka të fuqishëm.

* * * Poezinë o bëje, o mos e bëj!

Po ç'duhet që të bëhet një poezi e mirë? Para së gjithash duhet një përmbajtje e fortë. Jo *Inhalt*, fabula. Kjo mund të jetë e fortë si p.sh. Unë të dua, unë për ty vras veten, hidhem nga kati i shtatë.

Kjo s'përbën bazën për poezi.

Kushedi sa qindra janë vrrarë gjer më sot për dashuri, po janë harruar.

Pra, duhet jo fabula, *Gehalt*, *Fond*, një fond, përmbajtje sa e lartë aq dhe e thellë dhe e fortë.

Kjo përbën bazën për fillimin e një poezie, d.m.th. një dashuri e ndjerë thellë, një dashuri për atdhe, për liri etj. Kusht i dytë është ky:

Kësaj përmbajtjeje të dish t'i japësh një formë të përsosur. Pa këtë formë të përsosur artistike sado e lartë dhe e thellë dhe e fortë të jetë ndjenja, rezultati është zero. Sepse:

Kunst heist Form (Art do të thotë formë)

Po të mos ketë një formë të përsosur që në kompozimin e përgjithshëm deri në çdo varg e në çdo fjalë, poezia s'del mirë. Kushti i tretë është ky:

Kjo përmbajtje dhe formë që ke gjetur duhet të jepen nëpërmjet një stili të ri, origjinal, të panjohur më përpara. Dhe ky stil jep individualitetin e artistit.

Ato poezi që s'i kanë këto kualitete, shkruhen kot. Se s'rrojnë, vdesin, s'kalojnë dot shekujt.

Poezia duhet t'i ngjallë të njëjtat emocione, si lexuesit të sotëm, ashtu dhe atij që do të vijë pas njëmijë vjet.

Një poezi që s'është e këtij kalibri, jo vdes, po zhduket! Poezitë e Fan Nolit «Rent, o Marathonmak» ose «Moisiu në mal», i kanë cilësitë që përmenda,

* * * Përpara të gjithave është poezia. Ajo formon shpirtin e kombit. Një libër me një roman është *Unterhaltungsbuch* ⁽¹⁾ ndërsa një libër me poezi është një *Bildungsbuch* ⁽²⁾

Me vargjet e Marsejezës në gojë dhe me vargjet

*Për Mëmëdhenë, për Mëmëdhenë
Bashkoi burra se s'ka me prit...*

(1) — Libër bashkëbisedimi

(2) — Libër formimi

janë vrarë njerëz dhe janë fituar beteja, po më
thua j me ç'roman ka ngjarë kjo? Me asnjë!

Prandaj duhet të shkruajmë poezi jo të mirë,
po shumë të mirë. Jo të lartë, po shumë të lar-
të, shumë të thellë, shumë të gjerë, që t'i vemë
shpirtit të kombit themele të shëndoshë.

*** Poezinë e bën Toni.

Der Ton macht die Musik (1)

Ky e bën edhe poezinë.

P.sh. në poezinë time

*Fryn veriu në mal të thatë,
Thotë vasha lele ngriva...*

Vargu i parë i jep menjëherë tonin tërë poezisë,
po ai që e ka përkthyer frëngjisht ia ka pri-
shur taman këtë ton kësaj poezie. Ja si thotë:

Le vent souffle sur la montagne sèche...

* * * Duke biseduar një ditë mbi poezinë,
rdhi fjala te Gëtja. Përmendnim — herë ai dhe herë
unë — pasazhe nga vepra e Gëtes, dhe ndër të

(1) — Toni e bën muzikën.

tjera unë recitova këto vargje nga monologu i fundit i «Faustit»:

*Ja! diesem Sinne bin ich ganz ergeben.
Das ist der Wahrheit letzter schluss.
Nur der verdient sich Freiheit und das Leben,
Wer täglich sie erobern muss! (1)*

Sa madhështore! — tha. Këtu përmblihet tërë kolosaliteti i kësaj bote!

E si të mos lëvdohen gjermanët me Gëten? Si të mos jenë gjermanët ata që janë, kur kanë pasur një mësues gjerman kaq të madh?

* * * Poezia është divine (yjnore). Prandaj, kur shkruan poezi, duhet ta kesh shpirtin të shenjtëruar. Çdo poezi duhet të jetë një xhevahir dhe xhevahir duhet të jetë çdo varg i saj dhe çdo fjalë e saj duhet të jetë xhevahir.

Prandaj poezi mund të shkruash vetëm pak, se ku t'i gjesh gjithata xhevahirë?

Poezia duhet të jetë cilësi jo shumësi. Mos ki frikë se ke shkrojtur gjatë jetës tënde vetëm dhjetë poezi. Frikë të kesh po të kesh shkrojtur njëqind poezi.

(1) — Po! Kësaj gjëje krejt i jam kushtuar.

Kjo është e vërteta më në fund.

E meriton dhe jetën dhe lirinë

Vetëm ai, që përditë i pushton ato.

Poezi s'do të thotë shumë vëllime. Poezi do të thotë: një vëllim!

Një vëllim me poezi shumë të mira. Kaq.

* * * Poezinë nuk e bën as klasiçizmi, as romantizmi, as realizmi, as syrrrealizmi, as natyralizmi, as kubizmi as izma të tjera. Poezinë e bën humanizmi. Poezia shpreh shpirtin e njeriut dhe s'mund të jetë vetëm se realiste. Dhe Leonardo da Vinçin e pyetën: Ç'është arti? Art është — tha — se s'është natyrë. Themi dot se Leonardo da Vinçi s'ishte realist?

Ai studioi kufomat, disekoi damarë e muskuj, po kur na bëri Xhokondën nuk pikturoi natyrën, po një natyrë të idealizuar, më të bukur se natyra.

Ne shikojmë natyrën, pyllin, dhe na kënaq. Po ja që s'na ngop! Na pëlqen, po e duam edhe më të bukur, se ne, nga bukuria e kësaj natyre ndjejmë në shpirt bukurira dhe harmonira më të mëdha. Prandaj natyra s'na ngop, pylli s'na ngop dhe ne bëjmë një poezi për pyllin.

Ja si them unë në «Kamadeva»

*Fërmonte një fërmim
Nër deg' e fletë.
Vëngonte një vëngim,
Një kumb' i fshehtë.*

Vargu i parë është horizontal, i thjeshtë, bile mund të thuash se s'është as poetik, por ai përgatit vargun tjetër që ka gjithato drithërima. Pastaj vjen një varg i thellë dhe një tjetër edhe më i thellë, plot me mistere të pyllit.

Unë pyllin përshkruaj, realitetin, natyrën por ajo deri sa është derdhur në këto katër vargje, ka kaluar nëpër njëqindmijë transformime të brendshme metafizike.

Vetëm poezia që ka si temë të përbrëndshmen e njeriut, vetëm ajo rron. Të tjerat ngordhin, harrohen. Ja, të marrim «Parajsën e humbur» të Miltonit. Stilist i madh, Miltoni, po ç'e do? Kush beson sot në parajsën, në djajtë, në engjëjt? Atëherë besonin dhe poema ndjehet me të vërtetë. Sot e lexon Lasgushi dhe Petraqi se, si njerëz të kulturës që janë, u duhet në bisedat e tyre, po tjetër kush e lexon?

Homeri është i madh, poet i madh, se na përshkruan njeriun, të përbrëndshmen e tij, e cila është eternele. Ai na përshkruan natyrën me saktësi e vërtetësi, po me vërtetësi poetike.

A mos duhet ta quajmë Homerin sentimentalist, dekadent, se na thotë që ky Odise, ky hero legjendar na qau për qenin që i vdiq mbasi nuk e përkëdheli?

A ka nge ky Odise, pas kaq luftërash e gjakderdhjesh, pas kaq vite aventurash në dallgët e detit, ky Odise që ka parë shokët më të dashur të ngrënë nga Polifemi, ky Odise që po përgatitet të derdhë përsëri gjak, duke vra-

rë armiqhtë e tij, a ka nge, pra, ky Odise të qajë për një copë qen?

Po Homeri, se ishte Homer, poet i madh, na e bën Odisenë njeri, duke e bërë të derdhë lot për qenin besnik. Kështu poeti na dha në art një realitet të idealizuar.

Po ç'ishte Homeri? Romantik? Realist? Surrealist? Homeri ishte poet dhe bënte poezi!

* * * Poezia duhet të ketë universalitet nëpërmjet të kontemporaneitetit, se kur vdes kontemporaneiteti ngordh edhe vlera e asaj poezie. Nga kjo gjë, nga kontemporaneiteti, vuan edhe «Komedia Hyjnore» e Dantes.

Ne, sot, atë nuk e kuptojmë po të mos lexojmë shpjegimet për çdo varg.

Megjithëse Danteja ishte poet i madh, poema e tij nuk ka universalitet. Kontemporaneiteti i saj ka ikur dhe poema mbetet pa vlerë, kurse universalitet ka soneta për Beatricën dhe ajo s'vdes kurrë!

* * * Asnjë poezi popullore, e çdo populli goftë, nuk është e përsosur. Gjenden kur e kur vargje ose strofa të përsosura, por asnjëherë s'gjen një poezi të tërën të përsosur.

Poezia popullore kështu është, po asnjë poet

s'mund të krijojë pa studiuar poezinë popullore, të paktën të vendit të vet. Bërnsi ka marrë nga poezia popullore jo fjalë, jo vargje, po stanse të tëra dhe i ka shkrirë në poezinë e vet. Nga poezia jonë popullore më të mira janë «Kënga e Gjergj Elez Alisë» dhe njeri variant i këngës së «Dhosi Zados Korçarit» botuar nga Thimi Mitko.

** * * Poezia ka mundësira shprehëse më të mëdha nga ç'ka muzika.*

** * * Artisti i madh nuk ka cmirë. Ai gëzohet atje ku gjen artin e vërtetë.*

* * * Kur përktheja «Eugjen Onieginin», pasi e pata mbaruar, përkthimi u shtrua për shqyrtim në Institutin e atëhershëm të Shkencave. Raportoi njëri, që unë nuk e njihja. Nder të tjera ai tha se kishte raste në përkthim që fjalët ishin deformuar për hatër të rimës dhe solli si shembull vargun:

«Ngjiti shkallët e mermerit»

Kurse ne — tha — themi:

Ngjiti shkallët prej mermeri

ose

Ngjiti shkallët e mermerta.

U inatosa pa masë.

Si mund të guxonte ai të mendonte, pa le ta shprehte që unë bënja varg për rimë!

U ngrita dhe i thashë: A flet ndonjëri nga ne më pastër se populli? Jo! Dëgjoje, pra, si flet populli: Mësoje poezinë popullore:

*«Ngjita shkallët e mermerit,
Pashë harkun e ylberit...»*

* * * Benedeto Kroçe (Benedetto Croce) duhet lexuar se atje mëson njeriu italishten e kultivuar. Unë e kam jo lexuar, po studiuar. Se një libër që vlen nuk lexohet, studiohet.

Edhe Kroçe thotë për Leopardin: jo këtu, s'bën, po aty s'është mirë... Po ja ku të them unë: Leopardi është vetëm shpirt! Në poezinë e tij nuk ka asnjë fjalë jo aq të butë sa duhet, apo jo aq të fortë, apo jo aq të ëmbël, apo jo aq të hidhur sa duhet. Leopardi e ka çdo fjalë të dalë nga shpirti dhe të vënë atje ku duhet dhe si duhet në mes të fjalëve të tjera. Leopardi nuk

ka asnjë fjalë *False*, ashtu siç nuk ka asnjë fjalë false poezia popullore.

*Gjithë Evropa po thojnë
Ç'janë këto që dëgjojmë,
Shqiptarët po luftojnë
Me një mbret dyzetmilionë.*

Ka këtu ndonjë fjalë false?

Njëckë fjalë false e prish tërë poezinë.

Ti ndjenjën mund ta kesh të thellë sa të duash, të pastër sa të duash, të singertë sa të duash, po duhet ta shprehësh me fjalë dhe kur kjo fjalë tingëllon false, domethënë nuk është aq e butë sa duhet, aq e ëmbël, aq e thellë, aq e fortë sa duhet, poezia del e dobët.

Ajo, ndjenja jote e singertë, e thellë, e pastër e ndjerë, *doli false!*

Këtu, në zgjedhjen e fjalës, ndahet artisti nga poeti, domethënë poeti artist nga poeti vetëm poet. Po dhe kjo ndarje s'vlen, se poeti po të mos jetë artist s'është poet i vërtetë se poezia ka vetëm klasë të parë.

Emineskut, mbreti Karol i Rumanisë, i dha për poezinë e tij një dekoratë të klasit të dytë.

Eminesku e refuzoi, nuk e mori.

Se s'pranonte kategori për artin e vet. Deshte doemos klasë të parë.

* * * Ndjenjën njeriu mund ta ketë shumë të pastër, shumë të lartë, shumë të singertë, por kjo s'mjafton për të bërë një poezi të mirë.

Kjo ndjenjë duhet të mvishet me robën materiale të fjalës. Prandaj fjalët duhen zgjedhur për të shprehur sa më mirë ndjenjën që duam të shprehin. Në qoftë se na duhet një fjalë e fortë, e fuqishme, duhet të kemi kujdes që të mos na dalë banale, apo retorike, ose emfatike.

Duhet të gjejmë e të vemë tamam atë fjalë që duhet. Po për këtë duhet punë!

Geni? — pyet Gëte — dhe përgjigjet;
Geni ist Arbeit! (1)

* * * Rimën ne nuk e vëmë për formë, por e vëmë, sepse potencializon vargun; dhe që të bëhet e tillë, duhet të jetë në harmoni me zhvillimin e brendshëm spiritual të vargut.

*** Unë jam Bucherwum — krimb librash — që rri ditë e natë mbi libra.

*** Liçencë poetike?

Ku pranon poezia liçenca! Ku ja lejon vetes poeti i madh liçencat!

(1) — Gjeniu është punë.

*** Të tërë do të ikim nga kjo botë, po ne, intelektualët e lartë, kemi për detyrë të lemë veprën që do të na përfaqësojë.

Ein Lebenswerk!¹ kjo duhet.

Mund të bësh shumë gjëra, mund të shkruash shumë, po s'ka rëndësi. Rëndësi ka të arrish të bësh veprën që do të përfaqësojë. Kur sjellim ndërmend artistin, duhet të sjellim menjëherë ndërmend veprën që e përfaqëson. Poeti s'duhet të shkruajë shumë. Një vëllim me poezi të mira, domethënë me poezi shumë të mira, mjaft e ka, Të tërë poetët e mëdhenj kaq kanë. Një vëllim! Edhe kur shkruajnë më shumë, ato që mbeten, mezi bëjnë një vëllim. Ja Hajne! Ka shkrojtur jo Ata Troll, jo të tjera, ç'i do? Hajne mbetet poet i madh se ka një vëllim me poezi shumë të mira — «Buch der Lieder». (2)

Kaq i mjafton.

Eminesku mbetet poeti më i madh i Rumani-së me nja shtatëmbëdhjetë poezi shumë të mira. Në poezi ka rëndësi të madhe të thuash, të shprehësh, sa më bukur, sa më shumë ndjenja, me sa më pak fjalë. Poezia është ekonomi e madhe fjalësh.

Poeti i madh s'ka pse të shkruaj prozë dhe ca më pak prozë të gjatë.

Lamartini, ti e di, ishte ambasador i Francës në Turqi. Turqit i thanë: Na shkruaj historinë e perandorisë Osmane. I dhanë dokumenta, i dha-

1) — Vepër jete

2) — «Libri i këngëve»

në para. Po unë jam poet, tha Lamartini, s'di të shkruaj prozë.

Di, di ti — i thanë turqit — shkruanaji. Dhe Lamartini e shkroi. Mori ato para, po a mos përmendet Lamartini se shkroi Historinë e Perandorisë Osmane? Jo! Lamartinit i mjafton ajo poezia «Lë Lak». E kam lexuar Lamartinin kur isha në Lice, në Greqi. Është proliks, po atë poezinë «Lë Lak» e ka të mirë. Siç thashë, poezia duhet të jetë konçize. Ja për shembull poezia që kam bërë unë për Asdrenin.

Tepër e shkurtër është, po unë i kam thënë të tëra ç'duhet thënë për të.

Burr i urt' e i veçuar

Kështu ishte Asdreni. Shumë njeri i mirë, i urtë dhe gjithmonë i vetmuar.

Shqiptar me shpirt të qruar.

Patriot i madh ishte. Erdhi edhe vullnetar në kohën e princ Vidit për të luftuar me armë. Dhe pastaj i përmend atributet e tjera.

*Pate shkruar e punuar
Shqipen për ta shqipëzuar
Kombin për ta kombësuar.*

Po ai Maloki thotë: Pse, ky është Asdreni?
Po. ky është! Kaq mund të them unë për të.

Për Naimin kam thënë më tepër, se për Naimin ke ç'të thuash më tepër.

* * * Eminesku ka disa poezi të tilla të mira që s'i ka as Gëteja, po Eminesku përdor shumë asonanca. Një si kritik rumun, profesor Mihail Dragomiresku, ka bërë një broshurë të vogël mbi metrikën dhe aty ku flet për asonancat thotë se Eminesku i ka asonancat më të mira, më të bukurat.

Dragomiresku si erudit, si të gjithë eruditët, flet kot edhe ai për poezinë, se s'e kupton. Se s'është poet. Asonanca s'mund të jetë kurrë e bukur. Ajo s'mund të jetë veçse e shëmtuar. Pse bën asonancë? Se s'bën dot rimë! Po pranon artisti i madh të mos bëjë dot rimë? Pranonte Mikelandxhelo të bënte asonancë në gdhendjen e «Moisiut»?

Pranonte Leonardo da Vinçi të bënte asonanca te Monaliza Xhokonda?

* * * *Ishim në Pogradec, në shtëpinë e tij, atje në odiçkën e katit të tretë ku i pëlqente të rrinte.*

Se si mbahej në këmbë ajo shtëpi, e veçanërisht ajo Odiçkë, me ato mure gjysmë çatma, gjysëm me tulla këllëç, unë, si inxhinier s'i kam dhënë dot shpjegim dhe gjithnjë kam shkelur me frikë mbi dërrasat e dyshemesë së arnuar dhe duke parë muret e plasaritur.

Aty, pra, në Odickë, ai duke ndenjur mbi një shtrat hekuri dhe unë mbi një arkë dërrase me libra e duke fluturuar së bashku në qiejt e poezisë, e këputi bisedën dhe më tha se e kishin lajmëruar që do t'ia ripararin shtëpinë me shpenzimet e shtetit.

Me atë rast unë i thashë të kërkonte që riparimi të bëhej pa ndëruar strukturën, formën e banesës, ambientet, në mënyrë që t'i mbetej sa më shumë besnike shtëpisë ku ai kishte banuar një jetë të tërë.

Se, të më falni — i thashë — që po bëj një bisedë të tillë, por është e sigurtë që një ditë kjo shtëpi do të bëhet Muze.

Muze — tha — unë kam «Vallen e yjeve» dhe «Yllin e zemrës», jo këtë karakatinë.

Ato do të mbeten. Kjo do të zhduket.

Kur e kujtoj tani, pas shumë vitesh, këtë bisedë me Lasgushin më buçasin në vesh vargjet e poezisë të JOHANNES BOBROWSKI-t;

«...einst, wenn du uns stirbst,
fällt zusammen alles,
Wende und Dach und Herd
fallen,» (1)

1) — «...njëherë, kur të na vdesësh,
do të shëmben të gjitha sëbashku,
mure e vatër e çati
do të shëmben...»

Vargje nga poezia «Holzhaus» (shtëpia prej druri)

Dhe më ther, se më bëhet sikur dëgjoj së largu jehonën e shëmbjes.

*** *Hëlderlini tha: Was bleibet aber, stiften die Dichter.* (1)

Lasgushi thotë: E vetmja gjë që mbetet është poezia. Dhe nga kjo mbetet poezia e shkurtër. Vetëm kjo kalon shekujt. Nga proza s'mbetet gjë. Edhe kur mbeten, mbeten ato të shkurtrat.

Tetëdhjetë romane ndoshta shkroi Balzaku. Të gjithë të mirë, po lexohen vetëm «Evgjeni Grande», «Pere Gorio», «Le lis de la valle», që siç na thosh dhe Jokli — është më e mira e Balzakut, ose «Fajdexhiu Gobsek» apo «Le peau de Chagrin».

Shkroi Gëte romanin «Jeta e Vilhelm Majsterit», po kush pyet? Nga Gëte mbeten vetëm ato poezitë e bukura dhe të shkurtra.

Poetët s'kanë nevojë të shkruajnë shumë vëllime. Prej të gjithë poetëve na kanë mbetur nga dhjetë, pesëmbëdhjetë poezi. Le të shkruajnë sa të duan, prapë kaq mbeten. Sa poezi ka Fan Noli? S'ka as dhjetë! Kjo s'e ka penguar të jetë një nga poetët tanë më të fuqishëm.

*** Atje, në ndërmarrjen e Botimeve, ishte një Eqrem Eqrem... ai na jepte punë neve. Po

1) — Por ajo që mbetet, na e falën poetët (ose e krijuan poetët)

Vargje nga poezia «Kujtim»

nëm, o Eqrem — i thashë një ditë — nëm ndonjë poezi kineze e vietnameze për ta përkthyer, që të shlodhem ca, jo gjithnjë poezi klasike, se u shemba! Do të të jap — më tha — do të të jap, po s'më dha asnjëherë!

Këto ditë, një nga ata të ndërmarrjes më tha se unë, gjer më sot, paskam përkthyer nëntëdhjetë mijë vargje!

(bisedë e vitit 1973)

*** Poeti mund të shkruajë shumë, po kur boton një libër me poezitë e tij, atje duhet të verë ato më të mirat. Edhe unë kam shkruar poezi si ato të rilindasve. Nga forma janë doemos më të mira, po s'janë aq të mira sa unë t'i vija në «Ylli i Zemrës», prandaj s'i vura.

Kam bërë një poezi, titullin s'ia mbaj mend, për Shoqërinë e Bukureshtit.

*Mu në mes të Rumanisë
Në qytet të Bukureshtit,
Leu kjo lule e Shqipërisë
Si zëmbak në mes të sheshit.*

*Leu këtu ku politika
S'di se ç'është pik' e gjakut,
Ku shkëlqeu Elena Gjika
Dhe kuvend' i Naço Plakut.*

Ku punoi Terpo Vasili
.....♦.....

Dhe Naimi si bilbili

.....

S'më kujtohet më tutje... Është botuar në gazetën «Shqipëria e Re». Këtë poezi unë nuk e futa në «Ylli i Zemrës». Këtë dhe të tjera si kjo. Kështu kanë bërë të tërë poetët. Edhe Leopardi kështu bëri, La vetëm ato që vlenin të mbeten.

Për «Yllin e zemrës» unë i dhashë Mitrushit dorëshkrimin tim, të shkruar siç shkruaj unë, si ruaza, ti e di. Pasi e botoi, Mitrushi më tha se dorëshkrimin e la në Akademinë Rumune me të drejtën që ta merrte kur t'i duhej.

Mitrushi i madh na vdiq dhe dorëshkrimi mbeti atje...

*** GJER MË SOT SHUMË VETA KANË SHKRUAR KUNDËR MEJE, POR ASNJË-HERË S'JAM PËRGJIGJUR. SE POETI S'PËRGJIGJET. POETI BËN VEPRËN, VEPRA LE TË PËRGJIGJET. PO TË MOS FLASË AJO, POETI S'KA Ç'TË THOTË!

*** Në baladën që dua të bëj për Themistokli Gërmenjin dua të fut një ndodhi nga jeta e Dantonit.

Kur ushtima e topave gjermane dëgjohej në Paris, shokët për ta shpëtuar, i thanë Dantonit: shko në Angli. Dhe ai u përgjigj: Po a e marr dot Francën, La douce France, me shuajt e këpucëve të mia? Dhe nuk iku. Dhe u vra, duke e ditur që

do të vritej. Edhe Themistokliut i tha e shoqja: Mos shko, se do të të prishin. Po ai u përgjegj: Po të shkoj unë, do të ketë Shqipëri. Po të mos shkoj, s'ka Shqipëri. Dhe shkoi i bindur që do ta prishnin. Po unë dua të ve ato fjalë që tha Dantoni-a e marr dot Shqipërinë me shuajt e këpuçeve të mia?

Do ta marr se s'kam frikë se mos më thonë plagjiat. Poeti s'pyet se ç'merr dhe se nga e merr. Shikon ç'bën. Bën vepër arti. Atëhere mirë! Ajo që mori u bë e tija. Ashtu si ti, arkitekt, pyet nga i merr tullat dhe llaçin dhe betonin? Jo. Ti shikon se ç'do të bësh me ato tulla e llaç e beton. Shikon të bësh një pallat të bukur. Tullat dhe llaçi dhe betoni vdesin brënda. Ashtu vdesin dhe temat, fjalët, shprehjet, idetë e marra nga poeti kur ai arrin të bëjë një vepër arti. Ato bëhen të tijat, mbajnë damkën e tij. Mos janë englezë personazhet e Shekspirit? Jo. Janë Danezë. italianë, arapë. Po mos e ka penguar gjë kjo që të jetë dramaturgu më i madh anglez?

Poeti s'pyet se ne s'bëjmë histori, bëjmë art!

Baladën për Themistokli Gërmenjin e kam të konceptuar. E di si do ta bëj. Gjer tani kam bërë një nga strofat e fundit. Këtu tregohet përgjigja që jep Themistokliu kur i thonë se ti ke tradhtuar Francën për t'i shërbyer Gjermanisë. *Dhe më recitoi këto vargje:*

*U tund Themistokliu vigan,
Një duf në gjoks iu ndez:
— S'jam kurrë, kurrsesi gjerman,
S'jam kurrsesi francez.*

*** Asdreni ishte njeri i mirë, i urtë, i dashur, i singertë. Mua më ka dashur shumë. Më ka kushtuar dhe një poezi me titull «Exelsior» që është botuar. Edhe unë e kam dashur, po kur flasim për artin, s'ka miqësi! Asdreni s'qe artist, poet i vërtetë. Vargun s'e punonte. Po t'ë shikosh dorëshkrimet e tij, aty këtu do të giesh ndonjë fjalë të prishur e të zëvendësuar. Nuk gjen atë punë titanike që kërkon poezia për t'u bërë poezi. Më vjen keq që flas kështu, se siç të thashë, më ka dashur shumë, por Asdreni kur shkruante kur bënte poezitë, ritmin e vargut e mbante, duke përpjekur lehtas gishtrinjtë e duke numëruar rrokjet.

Poezia s'bëhet kështu.

Krijimi i poezisë është një metafizikë e tërë e pashpiegueshme dhe vargu del në mënvër të natyrshme si pasoi e harmonisë që duhet të ketë me vrullet e brendshme shpirtërore.

Ndër poezitë e mira që ka Asdreni, më të mirë ka atë:

*Sa të dua o Shqipëri
Sa mall ndiei e sa dëshirë.
Për tu pas e dashuri
Mu ndë zemrë më ka mbirë*
.....

Kjo është e tëra e përsosur.

*** Asniëherë nuk duhet vënë asnië fjalë «nër rimë». Bualoi, në venrën e vet «L'art poe-

tique» thotë: «La rime est une esclave et me doit que obeier» — Rima është një skllave dhe s'duhet veç se të bindet.

*** Në Rumani kam ndenjur tre vjet dhe në kaq kohë u mundova të përpij kulturën rumune. Më vinte inat atëhere kur lexoja kritikën e bëra për Emineskun nga kritiku i njohur Eugen Lovinesku. i cili thoshte se *figurën e blirit* Eminesku e ka marrë nga letërsia gjermane.

Unë kam gjetur në poezitë popullore rumune të mbledhura nga Eminesku dhe botuar pas vdekjes së tij, vargun:

«Përse i tund degët, o bli»

të cilin e gjen edhe në një poezi të Emineskut.

Dhe është e natyrshme që një poet i madh s'mund ta merrte këtë veçse nga populli i vet.

Këtë unë e kam përmendur e faktuar në Tezën time të Doktoratës mbi Emineskun.

Idenë e poemës «Luçiaferul» («Ylli i mëngjesit») Eminesku e ka marrë nga një përrallë rumune, botuar gjermanisht prej një folkloristi shëtitës gjerman.

Eminesku ka një poezi shumë të bukur kundër rusëve që kishin pushtuar atëhere Rumaninë. Atje thotë:

Që nga lumi (që është në lindje të Rumanisë, në kufi me Rusinë) dhe deri në lumin (që është në kufi me vendet e Evropës) ankohet populli rumun.

Atje përmend edhe një strateg shumë të njohur që është varrosur në një manastir dhe atij i thotë të ngrihet të shpëtojë popullin. Është poezi shumë e bukur, si e tërë poezia e Emineskut. Rumania ka shumë poetë. Shumë prej tyre kanë bërë shumë vëllime me poezi, po asnjëri s'është aq i madh sa Eminesku që mezi bëri një vëllim me poezi. Po me poezi ama!

Kushedi se kur do të vijë një Eminesk tjetër!

Pas dyqind, treqind, katërqind vjetësh ndoshta, por do të vijë. Do të vijë. Populli do ta nxjerrë një të tillë.

*** Poezinë që fillon me vargun:

«Që sot një vend i huaj po më thërret nga pas...» e kam shkrojtur në Rumani, në kohën kur më doli bursa për studime në Austri, Dashuroja atëherë, një vajzë greke të quajtur Zamfirula që unë e thërrisja me përkëdhelje; Lula! Kishte flokë të verdha dhe të gjata. Ishte koha kur flokët vajzat filluan t'i mbanin të shkurtra, sipas modës a la bebe... Iu luta shumë të mos i priste flokët, por s'dëgjoi: I preu. I preu dhe pastaj qavi. Si gjithë vajzat...

*** *Shkurt. Mesditë. U vodha nga puna dhe shkova në Lasgushi. Si gjithmonë e gjeta shtrirë dhe si gjithmonë s'përtoi të ngrihet e të më japë dorën. Kur u ngrit, vështroi nga dritarja dhe tha:*

Rënka djellë!

Si thashë? Rënka djellë!

Sa interesante! Këtë mënyrë të foluri, ose foljen, verbin, në këtë mënyrë nuk e ka asnjë gjuhë tjetër.

Rënka djellë!

Ardhka nusja!

Qaka djali!

Ngordhka qeni!

Fryka erë!

Plot të tjera mund të themi si këto. Shqipja ka plot, po asnjë gjuhë tjetër s'i ka. I ka vetëm Sanskritishtja e vjetër. Folja në këtë mënyrë ka kuptim më të gjerë.

Ardhka nusja!

nuk tregon vetëm që ka ardhur nusja, po që ka ardhur dhe unë s'e dija dhe çuditëm si paska ardhur, ose si është e mundur që ka ardhur, ose sa mirë që paska ardhur. Kuptimi mvaret shumë nga tonaliteti i zërit me të cilin flas unë.

Ardhka nusja!

është shprehje e kondensuar që jep shumë kuptime.

*** Bota i do poetët i përkëdhel dhe u fal mëkatet. Më thuaj, cili poet s'ka bërë marrëzira? Po bota i fal, i justifikon, e ngandonjëherë edhe i lëvdon për ato marrëzira.

*** Pjesa e dytë e «Faustit» është e pakuptueshme vërtet por megjithatë është një thesar për shprehjet, metaforat, maksimat, sentencat që përmban.

Tamam për këto gjëra gjermanët s'e lëshojnë nga dora, por dhe sepse Gëte s'bëri gjë tjetër veçse derdhi shpirtin gjerman aty brënda Faustit.

*** Gjuha shpreh shpirtin dhe kulturën e një populli, prandaj edhe fjalë të njëllojta kanë kuptime jo të barabarta, ekuivalente nga njëra gjuhë te tjetra, sepse shprehin shpirtin dhe kultura të ndryshme. Kështu fjala *Bukë* ka një kuptim më të gjërë, më të thellë, më jetësor në shqipet se sa p.sh. në rusisht fjala *hleb*!

Ne themi: haj të hamë bukë, ose ke ngrënë bukë? ose më hahet bukë!

Rusi thotë: haj të hamë, ose më hahet, kam uri.

Për rusin buka, nuk është gjithë ushqimi, është një pjesë e ushqimit. Për shqiptarin, gjithmonë të varfër, buka shpreh tërë ekzistencën e vet.

Po kështu fjala *Madamme* në frëngjisht shpreh një kulturë e një respekt tjetër nga ç'shpresh fjala *Zonjë* në shqipet. Dhe kështu mund të vazhdojmë për shumë fjalë. Kjo specifikë e veçantë e gjuhëve e bën të vështirë përkthimin dhe prandaj përkthyesi duhet të ketë kulturë shumë të gjerë që ta zotërojë nga të gjitha anët këtë specifikë të gjuhëve që përkthen, dhe kur përkthen, të gjejë fjalën, shprehjen e përshtatshme, që i përket vendit ku përdoret e përse përdoret ajo fjalë apo ajo shprehje. Ne themi që Fan Noli e ka përkthyer mirë *Korbin* e *Poe-s* dhe mirë e ka përkthyer, por fjalën *Nevërmor* që shpreh tërë atë greminë, humbje, shkatërrim, me atë

tingul aq të rëndë — *Nevërmoor* — nuk shpreh dot fjala *kurrë më* me atë tingull të shkurtër, megjithëse kuptimi është ekzakt. Prandaj përkthimi do kulturë të gjerë. Këshfu i thanë njëherë murgut Pasko, në një mbledhje në Ndërmarrjen e Botimeve. — Ti — i thanë — përkthen shumë shpejt.

*Dhe ai, ashtu siç fliste butë e ëmbël, tha:
Po, s'përkthej unë, përkthen kultura ime*

*** Kur flasim apo shkruajmë përmbi diçka duhet ta zotërojmë temën deri në fund. Kështu na ka mësuar ne profesori Shyr (Schürr). Ai ishte Dantolog. Kur e pyesnim për diçka dhe ai nuk ishte në gjendje të përgjigjej tërësisht, merrte shënim, përgatitej dhe pastaj vinte na fliste. Kështu bëhet kultura. Jo si i shkreti Krist Maloki (them — i shkreti — se ka vdekur) ky, pra, Maloki, shkroi për poezinë time *Korriku* se është e mirë. vetëm — thesh — në vargun

«Dhe çlodhen... dergjen... flenë .., *Kanë vdekur*» nuk duhet thënë *kanë vdekur*, por *kanë ngordhur*. Maloki pa e njohur problemin me themel guxon të shkruajë. (1)

1) — Krist Maloki pati botuar në revistën «Përpjekja Shqiptare» artikullin me titull: «A është poet poeti Lasgush Poradeci», Dy numrat e kësaj reviste. ku ishte botuar artikulli, Lasgushi i kishte në bibliotekën e vet. Atje, pranë artikullit, në anë të faqes, kam lexuar këto fjalë të shkruara me laps nga Lasgushi:

«Ku e kupton dot ti, Malok, poezinë time!». Kaq dhe asgjë tjetër...

Homeri tregon për Odiseun se kur u kthye qeni e njohu dhe lojti bishtin. Odiseu nuk bëri siç e kish zakon, nuk e përkëdheli, nga frika se mos zbulohet.

Mbasi i vrau armiqtë, u kthye të përkëdhelte qenin, por qeni — thotë Homeri — nga dëshpërimi *kishte vdekur*. Nuk thotë *kishte ngordhur*, siç do Maloku.

Alfred de Vinji ka poezinë «La mort du loup» (Vdekja e ujkut), pra *vdekja*, jo *ngordhja* e ujkut.

Gëte thotë: Der tote Fuchs. (Dhelpra e vdekur)

Tagora thotë: Qëngji vdiq.

Një piktor francez ka bërë tablonë «L'Oiseau mort» (1). Fan Noli i madh, në Historinë e Skënderbeut, thotë se kali i Skënderbeut; që kur u shtri Skënderbeu në shtrat, ishte egërsuar, nuk qaste njeri tjetër që t'i hipte, nuk deshte as të hante, as të rronte më, edhe u shtri edhe ai; edhe *vdiq* pakë ditë pas të zotit.

Të gjithë këta kanë thënë *vdiq* jo *ngordhi* dhe as unë s'thashë ngordhi, se po të thesha ngordhi do të ngordhte poezia.

Edhe Stefan Shundi, që ishte me kulturë dhe më desh, dhe shkroi nja dhjetë artikuj ku më lëvdonte mua, nga mosnjohja e thellë e problemit ra në gabim dhe tregoi se s'kish kulturë të thellë.

Për poezinë «Eja motër» ai thotë: Lasgushi këtu bën Concubinaje (2) me motrën. Po, ti, injo-

1) — Zogu i vdekur.

2) Jetesë bashkëshortore jashtë martese.

rant, pse s'lexon më përpara se të flasësh, Biblën? Kushedi prej sa mijë vjet përpara është Bibla! Aty është kënga e këngëve e Solomonit, apo Hashiri Hashirim, siç i thonë judenjtë. Aty i thotë Solomoni: O motër, e dashura ime. *Ja! dhe më dha Biblën gjermanisht ku lexova «Das Hohe Lied Solomos» (1) aty ishin të nënvizuara prej tij disa herë fjalët:*

o motër, e dashura ime.

*** Poezi domethënë koncentracion i madh. Të thuash sa më shumë me sa më pak fjalë.

Jo si Lamartini. Poezitë i ka të bukura, me gjuhë të pasur, me vargje të punuara, por është proliks. Hygoi — ca më keq. Poet është Bodleri. Ai ka koncentracion të madh. Asnjë fjalë më shumë nga ç'duhet. Prandaj ka edhe pak poezi. Por ka poezi ama! Prandaj kritikë francez Lanson, që ka bërë dhe Historinë e Letërsisë Franceze, për veprën e Bodlerit, që është e pakët në volum thotë:

«Kjo është vepër e një gjeniu ose e një dembeli».

Unë — thotë — jam për të parën.
Dhe ka të drejtë!

*** Kur lexon Naimin çuditësh nga ato që ka shkruar se sa të përsosura janë për nga mendimi, për nga ndjenja dhe për nga forma. Si është

1) — Kënga e lartë e Solomonit.

e mundur! — thua. Është e mundur se ai besonte në ato që shkruante, besonte me të tërë zemrën e tij.

— Selbstlob schtinkt — thotë gjermani.

Domethënë «vetëlëvdata bije erë të ndyrë». Por kur unë them se atë që kam bërë unë s'e ka bërë njeri tjetër, nuk lëvdohem. E them se kam besim në atë që bëj, kam besim në artin tim.

**** Kur themi poezi kemi thënë cilësi. Jo sasi. Po deshe sasi shkruaj prozë. Po unë për prozë nuk flas. *Fur mich die Prosa hat keine Bedeutung. Fur mich nur die Dichtung ist Wert. Die Prosa ist Wertlos, ist Wörterung, vielwörterung!*(1)

Poezi mund të shkruash vetëm pak. Po ta shkruash ama! Shiko tërë letërsinë botërore. Sa shumë poetë ka! Të vegjël e të mëdhenj. Po ne flasim për të mëdhenjtë. Për kulmet. Ç'është poezi e tyre? Cilësi është! Prandaj janë të mëdhenj.

Mos u tremb nga aksecili që paska shkrojtur shumë dhe thonë se qënka i madh. Sot këtu dhe në tërë botën shkrimtarët shkruajnë shumë, se me ato shkrime fitojnë para, sigurojnë jetesë të mirë, blejnë nga nja katër palë pantallona. Naimi

1) — Për mua proza s'ka asnjë rëndësi. Për mua vetëm poezia ka vlerë. Proza është pa vlerë. Është llafollogji, llafologjishumë.

nuk fitonte para me ato që shkruante, po harxhonte për ato që shkruante. Nuk ngopte barkun, po ngopte shpirtin!

Edhe Fishta ndiqte shembullin e shkrimtarëve evropianë që quhen të mëdhenj! Se kanë shkrojtur shumë. Edhe ai shkruante shumë, llojlloj poezi. Po dëgjo tashi të të them ç'më tha Fishta kur u takuam në Shkodër. Ai kishte shumë respekt për mua. Unë isha më i ri në moshë dhe më i ri si poet se sa Fishta, por ai kishte respekt: «Zotni Lasgush — më tha — *edhe un mundem me shkruë si ju, por kam frikë shnedën.*»

Ç'desh të thesh me këtë? Dësh të thesh se poezia që bën ti bëhet, po kërkon shumë punë, punë që mund të të dëmtojë edhe shëndetin. Po arti kështu bëhet. Poezia kështu bëhet. Shëndeti shkatërrohet dhe xhepi shpohet.

*** *Një ditë Lasgushi më tha:*

Atë Baladën për Luftëtarin Kombëtar e ke të mirë, por të ka shpëtuar një gabim. Fjala — *Vatan*. Hiqe fjalën *Vatan*. Fjalë turke s'duhet të ketë më në poezinë tonë. Pastaj, kjo fjalë s'kuptohet, s'tingëllon, për këto çupa e këta djem që janë sot dhe ca më pak për ato çupa e ata djem që do të vinë nesër. Ashtu si për ne nuk tingëllojnë më fjalët: *sabahair-ollsun* dhe *akshamhair-ollsun*.

Edhe Fishta ka thënë: «Nga një fjalë turke ban lazëm». Por e kishte gabim. Gabim e kishte dhe Sejfulla Malëshova. Na mblodhën njëherë, ne poetëve, dhe na thanë

të bënim Himnin e ri të Shqipërisë. Bënë të gjithë. Bëri dhe Sejfullau një Himn ku thoshte:

... Shqipëria *karakoll* n'Adriatik,,

Unë thashë: Duhet hequr fjala *karakoll*.

Jo — tha — se e përdor populli.

Populli, thotë, edhe unë them, kur flas, fjalë turqisht dhe arabisht po të duash, po kur shkruajmë duhet të shkruajmë shqip, se ne kemi si shembull konceptin gjenial të Naimit për purifikimin e gjuhës.

Naimi gjenial para pothuaj njëqind vjetësh, kur kudo flitej shqipe e përzjerë me turqizma, e shkroi poezinë të pastër, shqip. Naimi ishte i pari që shkroi shqipe të kulluar, që e spastroi nga fjalët turqisht, në një kohë kur vetë, ndoshta gjithë ditën, fliste vetëm turqisht. Nuk ka përdorur as fjalën *nur* që e kam përdorur unë. Ai ka thënë *hir* në vend të *nur*, megjithëse *nur* është fjalë shumë e bukur.

Hiqe, pra, fjalën *vatan*!

*** Kritikët, ata «Profesorët», «Akademikët», përgjithësisht nuk e kuptojnë poezinë, se s'i njohin sekretet e saj që i di vetëm poeti. Në kohën kur shkruar, te Eminesku, jetonte linguisti me i madh i Rumanisë, Hazhdeu, anëtar i shumë akademive të botës, ai që ka bërë fjalorin e madh etimologjik të rumanishtes: «Magnum etimologicum linguae rumuna» dhe veprën «Shtrat dhe nënshtrat» ku hedh tezën e nënshtratit Traško-Illir për gjuhën rumune. Shkurt, një kolos i shkencës, por ky s'e kuptoi Emineskun dhe e kritikoi se kishte shkruar në poezi, në ndonjë

vend, jo tamam sipas rregullave të gramatikës. Megjithatë, Hazhdeu i bëri homazhe Emineskut kur vdiq.

Edhe grecisti më i madh gjerman Vilamovic, nga studimet që bëri tha se Iliada nuk është shkruar nga një njeri, po nga shumë veta dhe njëri pastaj i ka bashkuar.

Po u ngrit Niçe-ja dhe i tha: Idiot!

Po mund të shkruhej një vepër aq harmonike sa Iliada nga duar të ndryshme? Dhe kish të drejtë.

Prandaj them se «Profesorët» s'e kuptojnë dot poetin. Edhe Oskar Valceli (Walzel-i); në atë veprën e tij kapitale që ti e di, se e ke lexuar, që është erudit i madh, prapë mbetet larg poezisë; se siç na thesh ne profesori Shyr, Valcel-i mundohet të shpjegojë artin me shkencë, gjë që është e pamundur.

Po si përfundim, duhen apo nuk duhen kritikët? Kritikët duhen. Po ç'duhet të ketë një kritik që të jetë i mirë? E para: Të ketë shije të nagabueshme artistike, të dallojë menjëherë ç'është e mirë dhe ç'është e keqe. Të ketë nuhatje. E dyta, që ndihmon të parën, duhet të ketë kulturë shumë të gjerë dhe të gjithanshme. Te ne kritik i vërtetë ka qenë Paskoja i madh! Ai i kishte të dy këto cilësi.

*** Ky Rexhep Qosja i Kosovës, në një shkrim që ka bërë, thotë për mua:

Asnjë poet tjetër s'ia ka parë sherrin mungesës së frymëzimit sa Lasgushi». dhe për këtë

përmend ato variantet e poezisë sime «Më zu një mall dhe sot».

Eminesku ka një poezi me titull «Më ka mbetur dhe një mall» ku thotë:

*Më ka mbetur dhe një mall:
Të më varrosni buzëdetit -
Nuk dua qivur të bukur
Dhe as fjalime dhe flamur.
Bëmëni një shtrat me degë,
Hëna të ma ndritë varrin
Dhe në koka të kem një bli.
Ashtu do të ndjehem i lumtur
Në vetminë time.*

Kjo është përmbajtja, ideja e poezisë. Bliri në Rumani nuk është pemë e njohur kombëtare, siç është për gjermanët Lindenbaum ose për rusët Bjerioska, po Eminesku e deshte dhe rumunët ia kanë mbjellë, kam vajtur e kam parë vetë.

E pra, që me gjallje të vet Eminesku ka botuar shtatë variante të kësaj poezie. Po ka guxuar gjer më sot ndonjë kritik rumun, a gjerman, të thotë se Emineskut i ka munguar frymëzimi kur ka bërë këtë poezi?

*** Këngën: «Që më një të Kollozhegut

U formua shoqëria...»

E ka bërë Spiro Garo, që ishte kamarier në Sofje. Mund të përmendim Spiridhon Ilon e të tjerë. Këta poetë minorë bënë poezi dhe këngë që këndohen edhe sot, sepse populli, që të mobilizohet,

do poezi të thjeshtë, direkte, komunikative. Ato, nga ana poetike, janë pa vlera të veçanta, po punën e mbarojnë. Edhe Himnet Kombëtare të çdo vendi kështu janë. Tekstet s'kanë vlera poetike. Kanë retorikë, deklamacion, oratori, janë larg poezisë, por popullit kështu i duhen, që të mobilizohet, të shkojë në luftë dhe të vritet, duke kënduar «Marsejezen», që të mëdhenjtë të rrinë rehat në kolltukë nëpër vilat e tyre. Teksti i «Marsejezës» është i dobët si poezi, po ka dy vargje shumë të bukur:

*Liberte, liberte sherri,
Combat avec tes defenseurs! (1)*

*** Kritikët e artit, estetët, filozofët, shkençetarët, kanë nevojë të kenë shumë libra në bibliotekat personale. Se ata, që të bëjnë një zbulim, a të krijojnë një shkollë filozofike, a të vërtetojnë ndonjë ligj, duhet të kenë shumë libra nëpër duar ku të referohen. Dhe këto duhet t'i kenë sa më pranë. Benedeto Kroçe p.sh. që ishte neokantian, kishte në bibliotekën e vet një 600.000 volume. Se i duheshin. Ne, poetëve, s'na duhen. Ne na duhet kultura. Ne duhet t'i lexojmë të gjitha që duhen lexuar. Edhe libra filozofike, edhe romane. Po s'është e domosdoshme t'i kemi në shtëpi. Unë, që kur isha njëzet vjeç djalë, le-

(1) — Liri, liri e dashur,
Lufto bashkë me mbrojtësit e tu!

xova në rumanisht librin e Ajnshtajnit mbi Teorinë e relativitetit. Për kulturën time, po s'më duhet ta kem në bibliotekë. Më kujtohet si tani Ishte një libër i lidhur bukur, me pëlhurë ngjyrë blu. Ne, poetët, duhet të asimilojmë, të marrim të gjithë kulturën, po pastaj librat s'na duhen kur krijojmë, se ne ato që themi i nxjerrim nga zemra. Ne s'kemi nevojë as për studio, as për tavolinë pune. Unë shkruaj shtrirë. Gjithmonë kështu kam shkruar. Poeti mund të punojë shtrirë, po mund të punojë kudo që të jetë. Edhe në rrugë. Poezinë «Eja motër» e kam shkrojtur në Rumani, kur isha sekretar i shoqërisë shqiptare të Bukureshtit, por isha pa rrogë dhe punoja si nëpunës me mëditje në shoqërinë e hekurudhave. Isha nëpunës me mëditje, se s'desha të marr pashaportë rumune dhe s'më pranonin si nëpunës me rrogë. Punoja në një stacion treni.

Pra, poezinë «Eja motër» e kam bërë duke shkruar në këmbë, një orë e gjysmë larg, se s'kish para për të marrë tramvaj, që atje ku banoja deri në stacionin verior. Këtë rrugë e bëja katër herë në ditë, duke i rënë shkurt edhe përmes parqeve. Në këto ec e jake e kam bërë këtë poezi.

*** Kur isha në Greqi, më 1916, gjashtëmbëdhjetë vjeç djalë, kërkoja nëpër libraritë e antikuarëve dhe atje gjeta Fjalorin e Kristoforidhit, botuar më 1906, të palidhur. Pastaj gjeta edhe një të lidhur. Atë të lidhurin ia fala Paskos. Të palidhurin, e lidha vetë dhe e kam edhe sot. Gjeta atëhere edhe *Abavetar Shqiptar*

të Anastas Kulluriotit. Ishte i vjetër dhe i palidhur. Të dy këto libra më kanë vlejtur shumë, se kam gjetur fjalë që i kam përdorur në poezitë e mia. Nga Kristoforidhi kam marrë fjalën *gjeratore*. Nga Kristoforidhi e kisha gjetur edhe fjalën *Rabozh* që më vonë e ndërova dhe e bëra *çetele*.

Në çetele të kujtimit...

Nga Kullurioti kam marrë fjalën *Fërmon* si zë onomatopeik që bën era nëpër fletë.

Themi edhe fëshfërit, po është më poetike fjala *Fërmon*, prandaj unë kam marrë këtë. Kullurioti ka në atë libër *Vetëvetirat* e kafshëve, d.m.th. zërat onomatopeikë të tyre.

Gomari pëllet

Lopa muallet (që e ka përdorur Fan Noli në përkthimin e «Kasolles», se ka shumë që thonë gabim Lopa-pëllet) Kërbi-kërron: Era-Fërrmon.

Prandaj poeti duhet të mbledhë fjalë nga të katër anët, duke studiuar dhe duke zgjedhur e përdorur pastaj, ato që duhen sipas rastit.

*** Isuf Myzyrin nga Elbasani, e kam takuar kur shkova njëherë në Llixhë. I dërgova të vinte të më takonte dhe më erdhi. Ishte veshur me brekushe të bardha, shumë të pastra. Ndenjmë e biseduam. Unë desha të di poezitë që bënte ai. Isuf Myzyri vetë i bënte fjalët e këngëve, vetë i këndonte dhe vetë i shoqëronte me

violinë. Për atë kam shkrojtur edhe një artikull atëhere.

Më vonë desha ta takoj përsëri. Shkova te kafeneja ku rrinte zakonisht. Pyeta-ishin ca pleqbektashinj.

Ka kalue — më thanë. Shiko sa bukur! Nuk më thanë vdiq, apo ka vdekur, po ka kalue d.m.th. ka kaluar në jetën tjetër. Isuf Myzyri ka kalue, po poezinë e tij e mbaj mend:

*Sevdaja në pleqëni
S'asht me mqyn me u durue,
S'më besojn as miqt' e mij.
Mjeri un si kam pësue.*

*** Nga muzika jonë popullore më e mirë është ajo e sazexhinjve të Korçës. Ajo ka orkestacion. Muzika popullore shkodrane dhe e Shqipërisë së mesme është me influencë nga muzika turke. Origjinale është edhe kënga labçe, por është e egër, Këngët e sazexhinjve të Korçës kanë të gjitha intonacionet e një muzike të kultivuar.

Këtë muzikë s'e ka asnjë krahinë tjetër e Shqipërisë dhe as ndonjë popull tjetër i Evropës.

*** Qënka bërë një mbledhje ku nuk e di se kush paska thënë se Homeri nuk përkthehet dot shqip në gjatësinë e vargut që ka në origjinal: Në atë mbledhje unë nuk isha, se mua s'më thë-

rrasin, po dhe kur më thërrasin s'vete, po dhe kur vete s'flas, por po të flisnja do të thesha: Shumë i dashuri shoku filan tha se Homeri s'përkthehet dot shqip me gjatësinë e vargut që ka në origjinal. Kjo do të thotë që ia përkthejmë në një gjatësi vargu tjetër. Kjo është njëlloj sikur të përkthenim Evgjen Onieginin në tetërrokësh. Kjo do të thotë t'i ndërrosh tonin poezisë, t'i japësh tjetër ton. Po, ç'e bën muzikën? Notat? Jo! Po i ndërrova këtë ton e ndërrova poezinë.

*** S'ka gjuhë që s'mund të përkthejë, po ka poetë që s'dinë të përkthejnë, ashtu siç ka poetë që s'dinë të bëjnë poezi. Po, a ka gjuhë më pak poetike se frëngjishtja, që i ka të gjitha fjalët oksitone? Po mos ka qënë pengesë kjo gjuhë që të nxjerrë poetë aq të mëdhenj? Po, a ka gjuhë më pak poetike se anglishtja me gjithë ato fjalë monosilabike? Po mos ka qënë pengesë kjo gjuhë për ata poetë të mëdhenj të Anglisë?

Ku pyet poeti! Dhe ca më pak s'pyet poeti shqiptar! Se shqipja ka mundësira të pakufishme për të krijuar dhe për të përkthyer. Ajo ka fjalë të shkurtra, të gjata, oksitone, paroksite, proparoksite, ç'të duash ka! Nga mundësitë që krijon gjuha shqipe ua kalon shumë gjuhëve të botës dhe mund të krahasohet me gjermanishten. Prandaj, s'ka faj gjuha, po ku është poeti?

Përkthimi bën kulturën. Përkthimet me durim që bënë murgjët nëpër manastiret nga greqishtja e vjetër dhe nga latinishtja sollën kulturën e lashtësisë dhe ishin këto përkthime që përgatitën rilindjen italianë që i thonë më kot Rinascimento,

frëngjisht, se Franca s'bëri gjë, Italia e solli Rilindjen.

Shtatëqind vjet me radhë Greqia e vjetër nxori filozofë. Ka nxjerrë ndonjë vend tjetër në ndonjë kohë tjetër? Jo! E, ja, tërë këtë kulturë, ata murgjët e përvojtur, të mbyllur nëpër manastiret na i dhanë gati ne të përkthyer. Ata na e dhanë këtë kulturë.

*** Gëteja i madh kishte respekt për përkthyesin. I faleminderit — thesh — atij përkthyesi që na jep një poezi të përkthyer në prozë sipas një përkthimi në prozë nga një gjuhë tjetër. I faleminderit edhe atij që na i jep një poezi të përkthyer në prozë, por nga origjinali. Më shumë i faleminderit atij që na i jep një poezi të përkthyer në poezi, por jo nga gjuha e origjinalit. Ca më shumë i faleminderit atij që na i përkthen një poezi në poezi nga origjinali edhe kur s'është përkthimi artistik.

Pastaj i faleminderit shumë e më shumë atij që na i përkthen një poezi në poezi nga gjuha e origjinalit dhe na i përkthen artistikisht. Kjo është një kënaqësi e veçantë. Kështu thesh Gëtja. Vetë ai nuk ishte përkthyes i mirë. Përktheu dhe «Il cinque Maggio» nga Alessandro Manzoni, por s'e përktheu mirë. Erdhi pastaj përkthyesi Paul Hajze (Heise) që i bëri kësaj poezie një përkthim të shkëlqyer.

*** Konceptimi im i dashurisë në Kamadeva është më i mirë se ai i Dantes në «Divina Komedia». Ja si e kam:

Në pjesën e parë shihemi, dashurohemi, e shijojmë këtë dashuri, por demoni i së keqes na ndan. Në pjesën e dytë unë e kërkoj të dashurën në qiell. Kaptoj hapësira pafundësisht të mëdha, duke kaluar me shpejtësira kozmike dhe e gjej. Dashurohemi përsëri, me një dashuri të madhe shpirtërore dhe unë dua ta afrojmë të dashurën, ta prek, ta puth, ta përqafojmë. Dhe e prek, e puth, e përqafojmë, po kjo prekje, kjo puthje, ky përqaftim s'më ngop, se s'është tokësor. Këtu është ndryshimi i konceptimit të dashurisë sime nga ajo e Dantes për Beatricën.

Danteja e shikon Beatricën njëherë kur është një nëntë vjeç dhe i pëlqen. E shikon pas një nëntë vjet të tjerë dhe i pëlqen edhe më shumë. Pastaj e takon në qiell, e admiron, e adhuron me një dashuri qiellore ose platonike dhe i këndon.

Kjo është dashuria? Kjo është dashuria njerëzore? Jo! Unë së dashurës i këndoj bukurinë shpirtërore, po dhe bukurinë trupore, dua ta prek, ta puth, ta përqafojmë, se jam njeri, jo engjëll! Kjo është jeta. Kjo është natyra.

Natyra s'është as amorale, as morale, as imorale.

Është natyrë, pra e shenjtë.

Prandaj mua s'më ngop ajo dashuri qiellore, jashtëtokësore, dhe prapë duke kaluar hapësirat e pafundme me shpejtësira të llahtarshme, zbres përsëri në tokë. Dhe kjo dashuri në tokë që s'më ngop, dhe e kërkon në qiell dhe s'më ngop dhe zbres ta gjej në tokë përsëri është vetë natyra e njeriut që kërkon e kërkon e s'ngopet kurrë. Ja, ky është konceptimi i pjesës së dytë të Ka-

madevës. Ta thashë kështu, shkurt, po brenda
do të ketë bukurira, harmonira edhe më të bu-
kura se pjesa e parë. E kam në kokë, e kam në
shpirt po kur do ta shkruaj?

Dhe që s'po e shkruaj më dhëmb mu këtu thellë.

*In der tiefste der tiefe von meiner Seele
tut mir sehr weh...(1)*

*** Kush është më i madh, Bethoveni apo Shu-
berti? A mund të përgjigjemi se kush është më
e bukur, lulebora apo zëmbaku? S'përgjigjemi dot.
Sejcila lule ka bukurinë e saj.

*** Unë besoj në dashurinë. Më shumë më
ka tronditur në jetë dashuria, më shumë më ka
gëzuar dashuria. Dhe një poet pa femër pranë
nuk rron dot, e sidomos, nuk krijon dot.

*** Kur isha i ri, në gjimnazin e Manastirit.
bëja poezi të shkurtra si kjo:

*Mu mërzit edhe kjo jetë...
E po si mos më mërzitet?
Sapo shkon një helm i shkretë.
Një helm tjetër më vërvitet.*

(1) — Mu në thellësi të thellësisë së shpirtit tim
më dhëmb fort...

Poezi pesimiste. Pesimizmi i rinisë që ishte si një lluks për jetën që e shijonim. Shkruaja unë, shkruanin edhe të tjerët. Nuk ishin poezi të vërteta, po edhe këto duhen, se pranvera s'vjen vetëm me zëmbakë të mëdhenj. Ka edhe lule të vogla që s'janë më pak të bukura. Megjithatë, ne duhet të bëjmë poezitë e vërteta, që të nderojmë me emrat tona, emrin shqiptar.

*** Ç'duhet të ketë një poezi që të mbetet? Duhet të ketë një ide të madhe. Këto ide të mëdha janë p.sh.:

Atdheu, dashuria, miqësia, besnikëria etj. etj. Kjo ide duhet, po s'mjafton. Një ide e madhe vetëm s'bën dot një poezi të madhe. Kjo ide e madhe duhet të shprehet nëpërmjet një forme madhështore, origjinale.

Për ndonjërin që mund t'i lexojë me dyshim këto fjalë të Lasgushit, apo që nuk ka bindje në vërtetësinë e tyre, po thërres në ndihmë Romen Rolanin i cili thotë:

«Rrethi i ideve që ushqejnë artin është tepër i kufizuar. Forca e artit s'është tek ato, por në këtë, si i shpreh ato artisti.»

R. Rolan
«Jeta e Tolstoit»

*** Gëte thoshte: Geni ist arbeit. (Gjeniu është punë). Sipas llogarive që kanë bërë, Gëtes i bie të ketë lexuar tetëdhjetë faqe në ditë.

Gëte nuk fillonte të lexonte kurrë pa patur fjalorin e gjuhës gjermane përpara.

*** S' ka estetikë të poezisë të bërë nga ndonjë tjetër. Atë e bëjnë vetë poetët. Edhe Aristoteli, që shkroi Poetikën, përfundimet i nxori nga veprat e poetëve.

*** S'duhet harruar thënia e romakëve:
«Asnjë ditë pa shkruar një varg.»

*** Në poezinë që i kam kushtuar Naimit, që në strofën e parë kam dhënë të tërë veprën e Naimit.

*Ku psherëtin dëshir' e djegur.
Në shesh të kuq të Qerbelasë,
Mes trimërish stërggjyshërishte
Të shoh ndaj po m'i bje xhurasë.*

vargu i parë — poezia e dashurisë e Naimit
vargu i dytë — Qerbelaja
vargu i tretë — Historia e Skënderbeut
vargu i katërt — Bagëti e Bujqësia.

*** «Kamadevan» e kanë lexuar shumë veta.
Njëri, që s'e njihja, më tha;

Mirë e kini bërë zoti Lasgush, mirë, po në një vend më duket se s'është mirë. Ja kjo:

*Fërmonte një fërmim
Nër deg' e fletë.
Vëngonte një vëngim,
Një kumb i fshehtë.*

S'themi kështu në shqipet: Vëngonte një vëngim...
Po unë ç't'i thesha?
Unë e di se si i ka kënduar populli Ali Pashës:

«O gjëmimi që gjëmon...»

E di edhe se si është shkruar në atë shqipen e kulluar të ungjillit. *Edhe u ngazëllua me ngazëllim...*

Edhe të tjera mund të them, Plot, Sa ka shqipja!

*** Parnasianët kishin poezi të përsosur nga forma, por vetëm kaq. Formë, vetëm formë. Një nga këta ishte Syli Prydom (Sully Prudhomme). Më kujtohet, kur isha në liceun rumun të Manastirit, kishim krestomacinë frëngjisht të letërsisë frënge dhe atje theshte se Syli Prydom (Sully Prudhomme) është poeti më i madh në botë. Kaq famë pati atëhere. Ai ishte i pari që mori çmimin Nobël. Po sot ku është?

Kush pyet për poezinë e tij që është vetëm formë, formë.

Po poezia ime vetëm formë është?
Ajo ka formën që i ka imponuar përmbajtja. Kjo

formë do të jetë doemos e përsosur që poezia të mos ngordhë. S'ka romantizëm, s'ka realizëm, s'ka futurizëm, s'ka hermetizëm. Ka art! Dhe i djall artist, në je artist, na bëj artin njëherë, pa në daç ta quash dhe me një emër tjetër, quajë si të duash.

Ja, sekush paska thënë sikur unë jam simbolist. Unë, jo që s'e dua simbolizmin po e urrej. Pse? Sepse është jashtë parimeve të mia në poezi. Unë them se cilësi e parë e poezisë është qartësia, të kuptuarit lehtë të saj. Simbolizmi, përkundër, ka poezi të errët, të pakuptueshme. Cila nga poezitë e mia s'është e qartë? Cila nga poezitë e mia është e errët? Cila nga poezitë e mia është e pakuptueshme? Asnjë!

Po ti që afirmon: Lasgushi është simbolist, e konfirmon dot këtë? Krahason dot një poezi timen me ndonjë poezi të ndonjë poeti simbolist? Po le një poezi. që io se jo, po një varg a mundesh? Po një fjalë?

*** Çdo poet duhet të ketë stilin e vet. Fjalët në fjalor janë banale: Bukë, ujë, dru... etj. S'thonë asgjë më shumë nga ajo që thonë. Poeti, përkundër, fjalët duhet t'i zgjedhë dhe t'i verë në atë formë që shprehin më shumë.

Ja, ti, p.sh. në atë poezinë që më kushton mua ke thënë:

*Po të blatoj, Ravvi.
Gjith ç'ndjej që thellë...*

Ke bërë mirë se e ngjallë fjalën *blatoj* të përdorur nga Fan Noli, po gjithashtu përdore në mënyrë vetiake shprehjen *që thellë*. Po ta shprehje të njëjtin mendim me fjalën *thellësisht* nuk bëje poezi, po oratori.

Fjalët duhet të jenë elegante, po s'do të thotë kjo që të mos jenë të fuqishme.

Po që të realizohen të gjitha këto duhet punë. Punë titanike.

Në atë poemën për Kosovën, unë kam një varg:

...Ku Drin' i Bardhë nën Istok...

Për të gjetur vendburimin e Drinit të Bardhë ku s'kam kërkuar! Në libra gjeografie, në enciklopedi dhe në harta të kohës së Austrisë. Dhe e gjeta Istokun!

*** Naimi i kanë dalë disa poezi shumë të mira. E tillë është poezia:

«Do të shkrihem, të venitem...»

Kjo është tërësisht e përsosur.
Çajupi ka të mirë poezinë:

«Bariu shokë, bariu...» E bukur! E përsosur!

Përsa i përket formës, më e mira nga tërë poezitë e rilindasve është ajo e Loni Llogorit që i ka bërë Papa Kristo Negovanit. E bukur është dhe poezia e Vaso Pashës.

Ndre Mjeda është poet i rrokjeve të matura.

Fishta ka shumë apostrofa.

Poeti e bën poezinë të kënaqet më përpara vetë,
pastaj ne marrim pjesë në gëzimin e tij. Dhe
marrin pjesë shekujt e gëzohen!

*** Në poetët nuk e dimë kurrë se ç'do të
shkruajmë. Prozatorët, po, e dinë.

*** * Në librin «Kapllan Aga i Shaban Shpatës»
që Mitrush Kuteli ia kish dhuruar Lasgushit, në
faqen 25, pranë vargjeve*

*Obobo! sa uj'i gjërë,
Shkojn' e mbytenë të tërë,
Hej! Hej!
Shkojn' e mbytenë të tërë,*

kam lexuar këto fjalë të shkruara nga Lasgushi:

«Këto radhë i kam bërë unë Lasgushi, nuk
kanë qenë kurrë në popull. I kam bërë më 1912,
duke ecur nëpër rrugë në Poradec, me një shokun
tim të atëhershëm i cili ishte vëllaj i burrit të
motrës sime Aspasië.

*** Fjalën *Mëmëdheu* e a bërë Naimi.
Fjalën *Atdheu* e ka bërë Asdreni.

*** Kur kujtojmë një njeri, duhet të na dalë
përpara vepra e tij. Herderi për shembull bëri
nga të tëra, se ishte me kulturë të gjërë dhe nga

kultura e tij përfitoi dhe Gëtja dhe Shileri dhe të tjerët.

Po vepër prej tij s'mbeti.

Vdekje ka pasur dhe do të ketë. Dhe ne do të vdesim. Kur kujtojmë sot Herderin, s'na del përpara ndonjë vepër e tij. Duhet vepra që të përfaqëson!

Po të kujtojnë ndonjëherë Lasgushin, do t'u dalë përpara «Vallja e yjve» dhe «Ylli i zemrës».

***Kur isha i vogël, ditën e Pashkëve, në sheshin që kishim pranë shtëpisë — që i theshin shesh i Milos — mbledheshin plot vajza trembëdhjetë — katërmbëdhjetë vjeçare, të veshura bukur dhe losnin valle, duke kënduar;

*O Risto, Ristostanesti,
Zoti Krisht bëke një kishë,
Atje brenda n'atë kishë
Hyri vasha edhe trimi.
Vasha plasi mbrëmanet,
Trimi plasi në mëngjes...*

Kjo ishte kënga popullore.

Nga kjo këngë unë mora motivin për poezinë që ti e di.

*Atje lart në mal të thatë
Zoti Krisht bëke një kishë*
.....

Doemos, këngën popullore unë e ngrita në art dhe i ndryshova këto dy vargje:

*Vasha plasi mbrëmanet,
Trimi plasi në mëngjes...*

Mentaliteti i popullit s'e pranonte dot që në një kishë të hynin dhe të bënë dashuri atje dy të rinj, prandaj, meqë përdhunuan atë vend të shenjtë, s'mund të ndodhte ndryshe veç se të vdisnin. Dhe vajza — më delikate se sa djali — plasi mbrëmanet. Trim — djali i shëndoshë, i fortë, — i qëndroi vdekjes deri në mëngjes.

Populli vetëm kështu mund ta konceptonte. Figura është shumë e bukur. E bukur për mentalitetin e popullit fanatik. Po mua më duhet ta ngre lart, ta himnizoj dashurinë. Prandaj nuk them:

*Vajza plasi mbrëmanet
Trimi plasi në mëngjes*

Po përkundërthem;

*Trimi ç'paska dhëndëruar,
Vasha ç'paska nusëruar,
.....
Jetën ç'paskan trashëguar...*

Unë s'mund ta quaja faj dashurinë e dy të rinjve, dhe s'mund të pranoja që përdhunohej vendi i shenjtë nga dashuria e tyre.

*«E hollë, e hollë si gergi,
Kryet lidhur me shamë.»*

Këtë gjëagjëzë për kallirin e grurit ma theshte murga nënë kur isha i vogël.

Fjalën «gargi» e kam përdorur në poezinë;

*Të kërкова me qiri,
Meskëputura — gargi.*

E përdora pastaj në «Kamadeva» ndoshta pas nja shtatëdhjetë vjetësh që nga koha kur ma thoshte murga nënë.

Ç'është kështu ky mister i poezisë?

Gargi quheshe — që në kohën e Turqisë — ajo shufra e hollë dhe e gjatë prej hekuri me të cilën pastronin tytat dhe ngjishnin barotën në ato pushkët e vjetra që mbusheshin nga gryka.

*** *Sa herë vija nga Lasgushi për vizitë, pas atyre pyetjeve dhe përgjigjeve të shkurtra të përshëndetjes, bëhej një pauzë e vogël heshtjeje të cilën përgjithësisht e prishte Lasgushi me pyetjen. Ç'na ke bërë ndonjë poezi?*

Po kështu e filloi bisedën kur vajta edhe atë mbrëmjen e një të shtune, në fund të Janarit të 1985-ës.

— Ç'na ke bërë ndonjë poezi?

— Kam bërë një përkthim po e kam dhënë për daktilografim. Do t'ua sjell.

— Mirë. Shkruaj, se kur e ke talentin dhe s'e përdor është krim. Poezi duhet të shkruajmë. Ajo mbetet, jo proza.

Ç'i do katër romane kur, atë që ke për të thënë, e thua me katër vargje? Këta katër vargje

mbetën. Ata katër romane treten. Ja si thotë anonimi;

*«Kur të pashë në gur' i portës,
Më lojti, moj, mëndj' e kokës.»*

Sa e fortë!

Keto vargje janë nga një këngë popullore që e këndoja kur isha nja pes a gjashtë vjeç, po ja, dhe sot e kësaj dite, pra, sa u bënë? — nja tetëdhjet vjet — ende s'i kam harruar. Dhe s'do harrohen!.,, Pse? Se ai poeti anonim, analfabet, po artist i madh, i ka thënë të tëra ç'ka dashur të thotë për dashurinë vetëm me këto dy vargje.

Prandaj duhet poezia. Ajo kalon shekujt, jo proza. Tërë bibliotekat janë të mbushura me prozë. Romane... romane... ç'i do? Ku je, poezi! Ato që thotë poezia s'i thotë dot proza kurrë! Dhe poezia s'duhet bërë siç bëjnë ca poetë, që i quajnë të mëdhenj, se paskan bërë nja katër vëllime me nga katërqind faqe plot me poezira! Poezia s'është mendim i vënë në vargje, po ndjenjë e derdhur në varg. Dhe s'duhet shumë e për lumë, po pak e për merak. Ja, të bëjmë dhe një krahasim tjetër:

Cila është monedha më e çmuar? Ajo prej floriri! Po sa e vogël është monedha e floririt? Megjithatë e mbajnë të gjithë në dorë, e shohin, e gëzojnë, se gjithkush gjen diçka interesante në të; fytyrën që është stampuar, datën kur është prerë; formën rumbullake të përsosur e të tjera. Po të ishte kjo monedhë sa një patkua kali, kush do t'a mbante në xhep? Kush do të gëzohej me

të? Asnjë! Ajo prapë prej floriri është, po s'e do njeri. Do t'a mbyllin shpejt në kasafortat e bankës!

Kështu ngjet dhe me ato poezitë e gjata dhe shumë të gjata, qofshin edhe të mira apo shumë të mira. S'i këndon njeri, po mbyllen nëpër dollapet dhe qilaret e bibliotekave.

Si ato paratë në kasafortë. Ç'i do?

Prandaj them që poezia duhet të jetë shumë e mirë, e vlefshme si floriri, po dhe aq e gjatë sa të mos e lodhë apo ta mërzitë njeriun si ajo monedha që thamë, prej floriri, po e madhe sa një patkua kali!

*** Poezia s'është shaka! s'është vetëm varg me rimë e me ritëm. Poezia kërkon fuqi të madhe shpirtërore. Poezia duhet të jetë personalissime. E tillë, që, si ti, të mos ketë mundur ta bëjë njeri gjer më sot dhe që, si ti, të mos mundë ta bëjë tjetër njeri sot e njëmijë vit.

Kur të arrish të kesh bërë një vëllim me poezi po ama me poezi, ke bërë gjë të madhe. Ke vënë tërë shoirtin tënd.

Mos ua ki zili atyre që bëjnë shumë vëllime me shumë poezi dhe që i botojnë pastaj kështu:

Poezi vol. pikë Një romake

Poezi vol. pikë Dy romake

Poezi vol. pikë Tre romake, katër romake, pesë romake...

Pse? Ç'u bë poezia?

*** Edhe në ditët e rënda të pleqërisë së thellë, i vetëm dhe i harruar, nuk e harronte poezinë. E vetmja temë për të cilën mund të fliste gjatë dhe me qejf ishte poezia. Shpeshherë thoshte: Poezia është quint esenca e prodhimit më të lartë intelektual të njeriut. Dhe ne që mundim ta bëjmë, duhet ta bëjmë. Doktorata mund të marrim të tërë, se ajo kërkon vetëm punë sistematike dhe ai që do, e bën. Por poezinë s'e bën dot kushdo.

Këtu zotëron mentaliteti se poezi dashurie mund të shkruajnë vetëm të rinjtë. Po të shkruaj unë poezi dashurie sot do të thonë: «Po dhe ky Lasgushi po vete njëqind vjeç dhe ala shkrojtka poezi dashurie! «Tjetri, më injorant se ky, do thotë; «S'qenka ndërmend, i shkreti!». Dhe unë them:

«Jo njëqind, po as njëmijë vjet nuk mjaftojnë të shkruash për dashurinë!» Ato poezi dashurie që mund të shkruhen në moshë të thyer, s'mund të shkruhen dot në të ri. Kur i shkroi Gëte lirikat më të bukura, me ndjenja e mendime aq të thella? Nga fundi i jetës!

Po këtu, poetët, shkruajnë poezi dashurie rri sa martohen. Pastaj shkruajnë romane. Se romanet qenkan, gjoja, të vështira dhe kërkokan moshë të pjekur!».

*** Ka ca që kanë thënë ose që thonë; Pse s'bëri, ose pse s'bën dhe ky Lasgushi poezi politike? poezi me temë shoqërore?

Mirë — ju them unë — po unë vetëm violinës di t'i bije!

Unë s'kam bërë poezi politike, të asnjë lloji. Jo se s'dua, po se s'di. Unë kam tjetër stil dhe të tjera kërkesa në poezi. Unë di ti bie vetëm violinës.

Dhe violinës mundohem t'i bie mirë e më mirë!

*** *Si të duket poezia pa rimë — i thashë një ditë — është e mirë? E mirë është edhe ajo — — tha e mirë. Mbret është, se poezia është mbret. po kur është pa rimë është mbret pa kurorë.*

*** Kur deshin ta botojnë atë poemën për Kosovën më thanë — duhet t'i ndreqim fjalët sipas rregullave të drejtshkrimit. Rregullat e drejtshkrimit — thashë — janë për prozatorët, io për poetët dhe ca më pak për mua. Se po të më korigjoni mua duhet të korigjoni dhe Naimin. Naimi shkruan:

Zemrën
Zëmrën
Zëmrënë
Zëmërënë

Dhe shkruan ashtu si ia do vargu dhe zhvillimi i brendshëm i poezisë. Juve dashki ta ndreqni Naimin. Juve dashkeni të më ndreqni mua. Po

gjuhën ne e bëjmë, ne, poetët. Gjuha është në popull, po ne i japim shkëlqimin, forcën, bukurinë, ëmbëlsinë. Po e ti s'pyet. Ai shkruan ashtu si ia do poezia e tij.

*** Më thirrën në mbledhje për të aprovuar ndryshimet në ortografinë e gjuhës shqipe. Foli një, s'e di kush foli. Folën dhe të tjerë që aprovuan ato që tha ai.

Më thanë dhe mua: Folë!

Edhe po të më theshit mos folë, unë sot do të flas — thashë.

Do të flas për të disaprovuar ato që u aprovuan.

Këtu u tha të shkruajmë ai jo ay.

Po kush e ka bërë shqipen shqipe? Naimi!

Si shkruan Naimi? Ay!

O moi fush' e Qerbelasë

Gë më del në sy,

Plot me aiak t'Ali Abasë

Vallë c'është Ay?

C'është' Ay që shkon kaluar...

Ay — ka shkruar Naimi dhe Samiu dhe përpara tyre Naum Veqilharxhi. Ay — ka shkruar Asdreni. Ay — ka shkruar Çajupi. Ay — ka shkruar Fan Noli. Ay — ka shkruar Lasgushi. Dhe janë këta që e kanë bërë gjuhën, kush je ti që e ndërrojnë? Dhe mbi c'bazë? Dhe me c'të drejtë?

Thatë të heqim vizën në fjalët e përbëra si *drejt-shkrim*. Mirë. Po unë ju them një fjalë tjetër:

Mes-hollë. Pa hiqeni vizën dhe lexoni *Meshollë!*
Po cila është ajo vajzë, e cila nga këto vajza që
janë këtu të pranon t'i thuash *Meshollë* në vend
të *mes-hollë*?

Na thatë të hiqet gërma «i» nga fjalët që mba-
rojnë me *gj* si p.sh. *ndërgjegje-ndërgjegjja* dhe të
shkruhet *ndërgjegja!* Përpara Kongresit të Ma-
nastirit përdorej alfabeti, i J. Vretos dhe për
gërmat dh, th, gj, zh, sh; përdoreshin gërma gre-
qisht ose me shenja të tjera, por meqenëse librat
shqipe botoheshin në vende të ndryshme të ev-
ropës që nuk i kishin këto gërma nëpër shtyp-
shkronjat, botimet, gjenin vështirësi.

Prandaj Kongresi i Manastirit vendosi t'i bëjë
këto gërma me alfabetin latin, duke bashkuar
dy gërma për një tingull. Kështu gërma *gj* përfa-
qëson, shpreh, një tingull, tingullin *gj*. Gërma *j*
këtu s'ekziston. Ajo, e bashkuar me gërmën *g*, ka
dhënë tjetër tingull dhe nuk e zëvendëson dot
gërmën *j*, që vjen pas saj në fjalën *ndërgjegjja*,
se pastaj na dalin fjalët pa tingull si *Ndërgjegja*,
Lagja, *Përgjegja*.

*** O shok i dashur — më tha një ditë — ti
ç'punë bën?

*Po unë inxhinier jam, inxhinier ndërtimi jam —
i thashë i habitur, se nuk ma merrte mendja
ta harronte profesionin tim.*

Nuk të pyes për zanatin tënd — tha — se e di,
po të pyes ç'po punon, ç'po shkruan?

— *Me përkthime nga poezia e huaj merrem..*

— Përkthime bëj, se të tërë poetët kanë bërë

përkthime. Edhe Gëte ka përkthyer, po më përpara duhet të bësh poezitë origjinale të tuat, se po të mos kesh poezi origjinale, s'ke gjë në torbë.

*** Në kohën e Ali Pashë Tepelenës, shqiptarët e ndjenin veten më të lirë dhe më superiore nga kombësitë e tjera fqinje që ishin nën sundimin otoman. Dhe ata i kishin zili shqiptarët!

Prandaj, kur u vra Ali Pashaj, grekët u këndonin shqiptarëve me tallje.

*Arvanites, hajdhemeni,
Pu ines Ali Pashas, Kajmeni?*

që do të thotë;

*O shqiptarë të përkëdhelur,
Ç'u bë, ose ku është, ku e kini Ali
Pashanë,
O të gjorë?*

**** S'jemi turq e as kaurë.
Mos e thoni këtë kurrë.
S'jemi grekë as bullgarë,
Jemi vetëm shqipëtarë,
S'jemi grekë as bullgarë,
Turq e sërbe nukë jemi,
Jemi vetëm shqipëtarë,
Këtë emër nder e kemi! (1)*

1) — Poezi e Naim Frashërit.

Shiko ç'është poezia! Shiko ç'ka bërë poeti!
Në këto vargje ndrit ideali i rilindasve, ai ideal
që solli bashkimin e popullit shqiptar.

Vargje si këto na bënë ne që të mos i themi më
kurrë fjalët turq e kaurë.

Prandaj themi që rilindja e bëri Shqipërinë
Shqipëri me shqiptarë.

*** Në çastet e dëshpërimit, kur hidhte popla
e rruklliste shkëmbinjtë edhe kundër miqve të
njëhershëm, në grumbullin e sharjeve të pakur-
syera, përdorte shpesh dhe një fjalë të ndyrë.
Këto ishin si kriza të vërteta nervore, të përsëritura
herë pas here, që merrnin shkas nga
diçka që dukej krejt e pa rëndësishme gjatë bi-
sedës dhe ai, nga qëndrimi shtrirë në shtrat,
ngrihej lëviste nëpër dhomë ose shkonte në
dhomën tjetër, rrëmbente ndonjë libër nga bi-
blioteka, më lexonte ndonjë rrjesht, fliste, shante
dhe shtrihej po përsëri ngrihej e qëndronte ulur
në shtrat dhe fliste, fliste dhe shante me atë
fjalë të ndyrë. E po mjaft me këtë fjalë, i tha
një ditë e shoqja, turp!

— Pusho, moj, ku di ti!

Edhe Balzaku kështu i shante kreditorët — mer-
de! Edhe i tmerrshëm Tigre de France. Cleman-
ceau / i kështu i tha Lloid Georgit — merde i
tha, se e kundërshtoi për marrjen e Alsas — Lo-
renës.

Merde — i tha — aty është derdhur gjak fran-
ces!

E shoqja vazhdon ta thumbojë me tallje;

Po ti i thua vetes poet i madh, si përdor të tilla fjalë?

Edhe unë prapë të them se ti aq di,
Se ç'janë poetët e shpjegoi Sokrati.

Atë e pyetën; pa na thuaj ç'janë këta poetët, ç'gjë të veçantë kanë, si janë kështu që shkruajnë kaq gjëra të bukura? Dhe Sokrati i tha:

Poetët janë si ne, si unë, si ti, si ai tjetri. Njerëz janë. Hanë, pinë, dehen; zihen; grinden. Po kur shkruajnë poezi një perëndi e veçantë ju qëndron pranë dhe ata ndryshojnë dhe shkruajnë siç i mëson ajo. Kur kjo perëndi largohet, ata bëhen prapë njerëz si ne, si unë, si ti; si ai tjetri. Hanë, pinë, dehen, dhe grinden, siç grindemi dhe ne të dy.

*** Kur isha në Austri botoheshin shumë poezi moderniste, futuriste e ku di unë çfarë. Këto i bënë ata poetët e vegjël, që kujtonin se do të bëheshin të mëdhenj po t'i çuditnin të tjerët me ato që shkruanin, me ekstravagancat e tyre. Ja të të them njëherë nga këto poezi, që e mbaj mend, se është shumë e ndyrë.

Qëndroi ndoshta një minutë me sy mbyllur e pastaj ma recitoi gjermanisht.

— Tani prit të ta përkthej shqip, — më tha dhe filloi;

*Në botë ç'është madhështore
Ta them tani; po mos u tut;
Të rrish më bisht në nevojtoje.
Me yjet lart e poshtë m...!*

Ja, kështu qenë poezitë moderniste! Nuk e mbaj mend autorin, po dhe ai ndonjë si kjo poezi do të ketë qenë.

Isha i ri, gjermanisht dija tepër, tepër pak dhe nga kjo strofë mbaj mend vetëm vargun e fundit të cilin Lasgushi e përmendte disa herë me inat:

Und druntër Mist!

Vonë, duke lexuar B. Brehtin, gjeta vargjet:

Orge sagte mir; der liebste Ort

Auf Erden war ihm immer der Abort.

Dies sei ein Ort, wo man' zufrieden ist.

Da druber Sterne sind und drunter Mist.(1)

A thua të ketë të bëjë me këto vargje?

*** Lasgushi e lexonte me interes të veçantë çdo poezi të re shqipe e veçanërisht liber me poezi që i binte në dorë. Faqet e fundit të këtyre librave janë të mbushura me shënime të tijat. Atje shënonte para së gjithash se ç'fjalë e shprehje të poezisë të tij ishin përdorur ne

1) — Orge më thoshte: vendi më i mirë

Mbi tokë për të ishte gjithmonë nevojtorja.

Ai është një vend, ku mund të jesh i kënaqur

Që sipër janë yjet dhe poshtë pleh.

B. Breht. Vargje nga poezia «Kënga e Orges»,

poezite e librit, që lexonte. Dhe mundimi nuk i shkonte kurrë kot! Jo rrallë e ka gjetur fjalën Mall dhe Mall i parë nëpër poezitë e më të rinjve.

Pastaj shënonte poezitë që i pëlqenin dhe kopjonte fjalë, shprehje, vargje dhe deri strofa të tëra që e tërhiqnin.

*** Nëse dikush, ndonjë ditë, do të merret me hulumtimin e shënimeve të Lasgushit, të cilat nuk janë të pakta, të lëna nëpër faqet e librave që ai lexonte, do të gjejë edhe fjalën *Situation*.

Per studiuesit e arahshëm, të cilët mund t'i japin një shpjegim të gabuar kësaj fjale, po shënojmë sa me inna Lasgushin kur e pyeta;

Ketë fjalë e shenoj prane atyre vargjeve që kanë ngjashmëri, për nga përmbajtja apo irymezimi, me vargjet e mia. Që një poet tjetër, i çdo kohe qortë, të ketë bere vargje të ngjashme me vargjet e mia, do të thotë se ai, kur ka shkruar këto vargje, ka pasur të njëjtin irymëzim d.m.th., ka pasur të njëjtën situatë shpirtërore si edhe unë, prandaj shënoj — *Situation*!

*** Atëhere kur shkuam në Shkodër, bashkë me Asdrenin, vajta në kuvend të takoja Gjergj Fishtën, por nuk e gjeta. Kur atij i thanë se e kisha kërkuar, mori makinë, veturë dhe doli më kërkonte nëpër Shkodër.

U takuam dhe shkuam në kuvend, ku rrinte ai.

Fishta ka qenë shumë i fortë si statirik. Unë desha atëhere të botoja një studim tim mbi Fishtën, si satirik, po Ernest Koliqi më tha: «Ti Lasgush, më mirë shkruaj për Fishtën si lirik». Dhe unë shkrova dhe e botova në revistën «Shkëndija» që e drejtonte Ernest Koliqi, artikullin «Gjergj Fishta lirik».

Ilia Murushi dhe *Egrem Çabej* janë ay shkencetare të vertetë.

Egrem Çabej është shkencëtar me të tërë kuptimin e fjalës, se e zotëron lëndën me të cilën punon dhe ato që afirmon, i konfirmon me argumente bindëse.

*** *Aleksandër Xhuvani* e pata njohur. Ishte njeri i mirë, i urtë, i ndershëm, patriot. Kishë mbaruar për linguistikë në Universitetin e Athinës. Ai herë pas here botonte studime etimologjike nën titullin SELECTAE. Për këtë, një ditë, Jokli na tha, se duhet shkruar SELECTA. Edhe për disa fjalë që i përmend Xhuvani se kanë hyrë në shqipet nga latinishtja, si fjalët *qen* (canis) dhe *shëndet* (sanitat), Jokli na thoshte se kanë hyrë nga latinishtja vulgare që përdor akuzativin *Canem* dhe *sanitatem*.

Gjatë kohës *em-i* ra dhe *a-ja* e patheksuar u bë e. Pra kemi: *cen* ose *qen* dhe *senitet* ose *shëndet*, që u shndërruan më vonë.

*** *Skënder Luarasi* është shumë patriot, shumë demokrat, shumë liridashës, shumë i sinqertë, shumë guximtar dhe si pasojë, shumë sherxhi.

*** Një ditë njëri më tha;

Zoti Lasgush, Zoti Lasgush! Atë poezinë e Pogradecit e keni të bukur, po në një vend nuk e kini mirë. Atje ku thoni:

*Duke nisur udhëtimin, mes-për-mes në
Shqipëri
Drini plak e i përrallshëm...*

Se unë — tha — jam profesor gjeografie dhe e di që Drini nuk shkon mes-për-mes Shqipërisë po në veri të saj.

Ç't'i thesha?

Mirë — i thashë — me që je profesor gjeografie, mësoje njëherë vetë, pastaj ua mëso dhe nxënësve të tu, që Shqipëri nuk është vetëm kjo që mbeti. Shqipëri është dhe atje ku ka shqiptarë dhe Drini plak e i përrallshëm shkon mes-për-mes kësaj Shqipërie.

*** Rexhep Qosja i Kosovës, në atë si kritikë që ka bërë për shkrimtarët, poetët shqiptarë, thotë se e ka lënë mënjanë poezinë e Budit sepse paska frymë fetare, të krishterë.

Po është argument ky?

Tërë kultura evropiane ka frymë të krishterë

dhe si pasojë, një pjesë e madhe e kulturës botërore ka këtë frymë.

Poezia e Dantes a ka frymë fetare të krishterë?

Po kjo e ka penguar Danten të jetë kolos?

Po Gëtja nga e ka marrë atë vargun e famshëm:

Am anfang war die Tat

Po nga ungjilli pas Johanit e ka marrë!

Im anfang war das Wort — thotë ungjilli

Po ka guxuar gjer më sot njeri t'i thotë Gëtes pse e ke marrë nga Ungjilli? Po ka thënë njeri se ka frymë fetare? Eminesku ka poezi ku e ka sharë perëndinë, po ka bërë edhe poezi për Shën Marinë. I ka thënë gjë ndonjë kritik?

Po Rexhep Qosja guxon t'i thotë gjë?

Po Fan Nolit guxon t'i thotë gjë për gjithë ato poezi që burojnë nga Bibla dhe nga Ungjilli i krishterë?

Unë i kam lexuar ato nja tetëdhjetë faqe me poezi nga Budi. Lexoji edhe ti, o Rexhep Qosja, dhe thuana në ke për të na thënë ndonjë fjalë. si kritik që je, në mos po lena rehat ne dhe Budin.

*** — Që të bësh një varg të mirë, duhet shumë, shumë kohë. Që të bësh disa poezi të bukura nuk mjafton një jetë.

*** — Nuk duhet patur kurrë frikë nga ata poetë që kanë përkohësisht privilegjin trist të

politikës, se ata ngordhin kur të ngordhë ajo politikë.

**** Nën trysninë e padurueshme ideologjike-psikologjike të kohës, Lasgushi bëri edhe disa poezi me motive prozaike të ditës, që ai i quante me tallje «Poezi socialiste». E filloi me një të tillë për ndërtimin e hekurudhës, nga e cila më*

kanë mbetur në mend disa vargje;
Vjen si gjarpër gjarpëruar
Duke shfryrë e uturuar
Hekurudha e rinisë
Plani i hekurt i partisë...

Ishte koha kur në Radio Tirana buçiste kënga që thoshte:

Para shokë përpara
Me norma, me gara...

Dhe Lasgushit i duhej të bënte poezi për normën, për normën që ia hëngri shpirtin te Ndërmarrja botuese, e cila i kërkonte realizimin e normës në përkthimin e vargjeve, që të siguronte atë rrogë prej 500 lekësh, që Lasgushi e quante «rroqë». Dhe ai shkroi;

Norma prandaj është shtruar
Shtruar edhe biseduar,
Biseduar, diskutuar,
Që të jetë realizuar.

Një ditë, kur ishte në gjendje shpirtërore të qetë, guxova t'i them; «Do të ishte më mirë sikur të mos i kishe bërë ato të shkreta poezi socialiste.» Lena, ore, dhe ti! — tha Lasgushi — e u çua i nevrikosur në çast. Heshti pak i ndejtur ulur në shtrat e pastaj vazhdoi: «Ç'të bënja, bre? Siç deshën u a bëra! Mut deshën dhe unë mut u dhashë!...»



Mund të them se në çdo faqe të këtij libri i kam shkruar mjaft besnikërisht fjalët, shprehjet dhe mendimet e Lasgushit. Por kjo është tepër pak!

Fjala e tij kishte hije në gojën e tij. Ajo shoqërohej e merrte jetë me qëndrimin e tij, me lëvizjen e shkathët të trupit, me tonin e zërit, me theksin e qartë, me të ndriturit e fytyrës me shkëlqimin e syve.

Veçanërisht me atë shkëlqimin e syve të zinj!



Pranë poetit

Qat i drejtë, bota nuk të njohu, po unë
e njoha edhe u dëfteva atyre emrin tënd.

Ungjilli pas Johanit krye 17, 25

Pranvera e vitit 1959...

Në Sanatorin ekstra-pulmonar të Vlorës, ku Lasgushi ishte shtruar për kurim, vija pothuajse çdo pasdite.

Ishte i sëmurë, por gjithmonë i gatshëm të bisedonte për artin, për poezinë. Në një nga ato

mbasditet më dha fletoren ku kishte shkruar disa nga poezitë e tij që unë nuk i njihja.

E futa atë fletore në xhep dhe s'më mbante vëndi. Desha t'i lexoj. Sapo u ndamë, nxora fletoren dhe duke ecur rrugës i lexoja ato poezi dhe s'ngopesha. Shkova, u mbylla në dhomë. S'di se sa herë mund t'i kem lexuar atë natë!

Ndërsa dëgjocja detin që ushtonte dhe dallgën që përplasej pas shkëmbinjve, ndjenja dhe gjoksin të më gufonte...

Si të mos e lexoje poezinë «Fluturimi», me atë varg të gjatë, madhështor e patetik që fillon aq dhimbshëm:

Tashi kujtomi që të gjitha... stolitë e jetës një — nga —një...

Atë vështtrimin më të parë, q'u mbvll në shpirt e s'doli më...

Duke lexuar më poshtë vija e ndalesha e i përsërisnja vargjet:

Papo pushojmë e ndërmendojmë dorë-përdorë e sy-për-sy.

Vec mall-e zjarr- e flakë- e dritë- e dehje- e prehje që të dy.

.....

.....

Apo ajo strofa e fundit!

Dh'ahere drit' e shenjt' e qiellit zbret sipër nesh nosi pëllumb.

Ngre lart në kraha zemrat tona, kaq dashuri të djegur shkrumb.

Vërrejnë yjt e buzëqeshur plot gaz e lot e
plot çudi
Tek fluturon kjo jeta jonë aq larg për në
përjetësi...

Po poezia «Kënga»? Sa e bukur!

Zunë e po ndritin ata yj të lartë
Si net-për-net që larg prej hapësire.
Nër yjt' e lartë shkrep një yll i zjarrtë
Një yll e mall e vashë e derdhur n'hire.

*Rridhnin fjalët, vargjet, strofat një-nga-një dhe
mbeteshe aty, në strofa e fundit ku ka aq shumë
brengë:*

...E mira ik, vërren që larg, së-qeti,
Në zemër time ndaj po ndehet nata,
Ndaj tundet zemra sikur tundet deti
Me bubullimë e klithmë e me shtrëngata.

*Ndërsa ndjehesha i magjijuar e i ngazëlluar nga
ky art i fjalës së shkruar më bëhej se Maja-
kovski, duke treguar me pëllëmbën e tij të ma-
dhe atë fletore, më thoshte:*

«Poezia —

e njëjta gjë, si nxjerrja e radiumit.
Për një gram

duhet të punosh një vit me radhë.
Vetëm për hir të një fjale
të çmueshme shumë,

Duhet të gërmosh mijra ton
minerale fjalësh.

Por,

me ç'forcë djegëse
këto fjalë ndizen
Franë kalbëzimit
Të fjalëve
të papërpunuara!...»

*Me ç'forcë djegëse ndizeshin ato fjalë!
Kur agimi filloi të zbardhëllojë i përfundova së
shkruari ato poezi në fletoren time. Atë fletore
ma morën pastaj adhures të tjerë të poezisë
dhe s'm'u kthye... S'di se ku ka mbetur. Po s'më
vjen keq! Ndoshta diku është duke e lexuar ta-
ni ndonjë djalë. Sa mirë! Sikur të bëhet poet!
Ca kohë më pas Perikli Jorgoni më recitoi një
poezi të Lasgushit e cila nuk ishte te fletorja që
më pati dhënë ai.*

*Nuk e shkrova këtë poezi, se e mësova pada-
shur përmendësh atë ditë. Deri më sot shumë
herë e kam recituar dhe shijuar me vete ashtu,
në heshtje... Tani është hera e parë që po e
shkruaj. Shijoheni dhe ju!*

* *

Dëbora flokët m'i ka zbardhur.
Në faqe rrudha kam tashi.
Me shkop në dorë, si plak i mardhur,
Bares liqerit, në vetmi.

Kujtoj rininë plot stolira,
Kujtoj thëllëzat lesh-flori.
Ah, fantazira, fantazira.
Në shpirt ç'më dergjeni tashi.

Dy strofa!

Dy strofa që kanë skalitur dramën e rëndë të pleqërisë dhe figurën stoike të Lasgushit brenda kësaj drame! Të gjithë ata që e kanë adhuruar në të ri poezinë e Lasgushit dhe pastaj, në moshë të thyer, vënë e kalojnë pushimet në Pogradec, gjithmonë do ta gjejnë hijen e tij të bardhë... tek baret liqerit, në vetmi...

Kthehemi përsëri në Sanatoriumin e Vlorës.

Siç thashë, mbasditeve vinja shpesh. Atje, duke shëtitur nëpër oborr, më fliste me pasion për poezinë.

Edhe sot, kur e kujtoj, çuditem se ku e gjente tërë atë forcë për të harruar gjendjen e tij të rëndë, sëmundjen e hallet e shumta dhe të më fliste mua për poezinë!

Për të kuptuar diçka rreth asaj gjendjeje po shënojmë këto rrjeshta nga një letër që më dërgonte disa muaj më vonë:

«... Unë të çqetësova ty. Petraq, po s'kam ç'bëj, jam sëmurë, si i sëmurë kam nevojë për ndihmën tuaj, vetëm për ndihmë kam nevojë prej juve që më doni, sepse ti vetë e pe. Petraq, mjerimin tim shëndetësor dhe mjerimin tim familiar...»

23 Tetor 1939

Dhe ja mjerimi i tij shëndetësor i përshkruar në një letër të asaj kohe:

«... Po të përgjigjem, i dashur Petraq, dhe për pyetjet e tjera: Unë me shëndet jam

kështu: Për nga plagët, ato, të dyja, m'u mbyllnë, njëra më 1 shkurt, tjetra më 1 mars 1959. Kjo gjë është një sukses. sukses i madh për mua, për trupin tim. Po kam disa dhembje; një nënë plagën, dhe të tjerat në bel prapa, përmbi bel dhe një dhimbje më lart, në spondilitë, një tjetër nënë mushkëritë, poshtë fare në anën e djathtë.

Dhembja nënë plagën më çan, ajo përmbi bel është dhembje me djegje-bashkë, ajo e spondilitës është si dhembje-si-djegje, kurse ajo e mushkërisë më shpon si plumb kur marr frymë, po më shumë kur e lëshoj frymën... Këmbën, d.m.th. kofshën, nënë plagë, e kam si të mpirë nga lezionimi i nervave...»

Si mund të fliste, ky njeri me aq pasion për poezinë? E megjithatë fliste! Dhe sa bukur... Sa bukur më fliste atë mbasdite tek rrinim bashkë mbështetur në muri që rrethonte oborrin nga ana e detit! Atje më vizatoi këtë grafik:

Vizatonte dhe fliste, pastaj përsëri kthehej e i mëshonte lapsit në vijën e përshkuar dhe përsëri fliste:

Çdo poezi e mirë, jo e mirë, po shumë e mirë, se ne vetëm për poezinë shumë të mirë flasim, se vetëm për të meriton të flitet, pra, çdo poezi

duhet të ketë këtë zhvillim të brendshëm ndjenjor në formë piramidale.

Ky s'duket, po ndjehet.

Nuk është kurrë një vijë e thjeshtë, lineare, se ka brenda çudira dhe harmonira dhe bukurira të pafund, por gjithmonë vjen e rritet e ngjitet e pastaj bije në formë piramidale.

Këtë zhvillim të brendshëm e ka jo vetëm poezia, por dhe të gjitha kompozimet në pikturë në skulpturë dhe në muzikë, po të duash! Shikoji të tëra pikturat e Rilindjes Italiane. Dëgjoji të tëra simfonitë, gjer tek e nënta e Bethovenit. Të tëra kështu janë.

Merr cilën të duash nga poezitë e mia. Ja: Lundra dhe flamuri.

Që larg po vi..., që larg.
Më turren valët varq-e varq.
Un' ik dh'hepohem mund si harg...

Kjo është pjesa horizontale, tregimtare.
Ja si fillon tashi ngjitja:

E sipër tyre shkas,
Valoj me sulmë-e gas;
I le tallazet pas:

Ja kulmi:

Dënimi im s'më tremb aspak!
Dënimi im nis e m'i lak
Fënaqijhtë e shpirtit varfanjak:

Strofat që vazhdojnë janë faqja tjetër e piramidës, rënia. Ja dhe pjesa tjetër horizontale:

*Tashi katarti-u çduk në det,
Tashi flamuri-u ngrit përpjet,
Valon lirisht si shpirt i let.*

Kështu janë të ndërtuara dhe poezitë e tjera, se s'mund të bëhen ndryshe. Thamë, pra, se ai duhet të jetë zhvillimi i brendshëm ndjenjor i një poezie.

Tashi do të themi se si duhet të jetë forma e jashtme që do ta veshë këtë ndjenjë.

Kjo duhet të jetë e përsosur. Origjinale dhe e përsosur!

Të jetë e rrumbullt, e limuar kudo. Në asnjë vend një çikë më shumë, në asnjë vend një çikë më pak. Jo! Kudo aq sa duhet. Dhe sa duhet, e di ti, poet!

Po për të bërë këtë duhet luftë. Luftë titanike. Gjatë këtyre afro tridhjetvjetëve që e njoh Lasgushin, sa herë që më ka folur për poezinë, gjithmonë e ka mbyllur bisedën duke thënë:

«Për këtë duhet luftë titanike me formën e jashtme! Pa këtë formë të jashtme të përsosur, poezia jo që s'rron, po as nuk vdes dot, se ngordh!»

LUFTË TITANIKE ME FORMËN E JASHTME

Ky është mesazhi madhështor që Lasgushi u le brezave të poetëve të ardhshëm.

Për luftën titanike që kërkon realizimi i poezisë së vërtetë, flasin dhe këto letra:

Sanatoriumi ekstra-pulmonar,
Vlorë (Uji-i-ftohtë) 16 Qershor 1959

I dashur Petraq.

E mora letrën t'ënde të datës 5.6.59 që më gëzoi duke mësuar për ty, sepse nuk dinja ç'ke bërë. Po më shumë u kënaqa me vjershën «Kështu të dua». Ajo përmban një ndjenjë të thellë dhe të fshehtë, të realizuar thellësisht dhe fshehtësisht për nga stili, dhe me një shprehje t'enden të veçantë në formë origjinale.

Përsa i përket realizimit artistik, më lejo këto vërejtje: «kllas» është e fortë, po ka kuptim pejorativ dhe neve na duhet këtu një fjalë-e fortë, po, por *meljorative* nga kuptimi: *kllasim* një të vdekur, jo të dashurën, të cilën e thëthijmë thellë-e-më thellë në fundin e zemrës tonë.

Mbesoj, Petraq, se më kupton...; «Tej e përtej ndër dej» duhet *inversuar*: *ndër dej tejepërtej* -për hirin e *ascensionit* dhe të *sugjestivitetit*, ashtu siç është në *realitet zhvillimi i përbrendshëm shpirtëror*. Mbi *ascendencën* dhe shprehjen *sugjestive*, si *realitet të zhvillimit të valës ndjenjore*, kemi folur dhe tjetër herë..., Gjithashu, jo «brejnë» *pastaj* «zjejnë», por «zjejnë» *pastaj* «brejnë» - sepse shpirti këtu, në këtë rast, do *krescendo*, do *thellim* dhe *rritje* do *ngritje*, *lartësim* në *apoteozë*, në *apoteozën e shprehjes*.

«Oh, siç m'a kënda
Mua!...»

Ky varg, «Oh, siç ma kënda mua!» është jashtëzakonisht i përsosur ay përsos gjithë poezinë, e

kurorëzon dhe i jep gjithë tonin, gjith origjinalitetin e saj. Poezia, me këto vërejtje, del me të vërtetë poezi. Mos i kundërshtoj, po urrej. Do të dalë poezi e gradës së parë. Në art, siç të kam shpjeguar, s'ka gradë të dytë. Ka vetëm të PARË; Është i vetmi manifestim shpirtëror i brëndshëm, i veshur me formën e jashtme të fjalës, i cili s'pranon gradacione... Arti ka vetëm Një kualitet; kualitetin e LARTË: ay është ABSOLUT, MONARK, PERANDOR, AUTOKRAT, DIKTATOR

...Tashti ti Petraq i dashur e kupton sa kuptim të madh ka kjo ndreqje e vogël e këtyre vërejtjeve të vogla të mësipërme. Ndreq-e poezinë, po të duash, dhe dërgom'a prapë. Të lurtojmë luftën e brëndshme fisnike me fjalën e jashtme titanike, për t'a mposhtur fjalën që të dalë arti plot DITË.

Me dashuri, Lasgushi.

Në letrën që më dërgoi katër ditë më vonë, më shkruante përsëri për atë poezi edhe këto:

«Më 16.6.1959 të dërgova një letër, me disa shënime estetike rreth poezisë «Kështu tëdua!» të cilat them se nuk do të të mërzhitin dhe aq shumë. Janë vërejtje të holla, vërejtje minimale (me qindra, me mijra..., po prej këtyre përbëhet shpirti i madh i një poezie të inspiruar, inspiruar nga fondi dhe nga forma, që janë një-dhe-gjithnjë -gjë. Poezia që kërkon të hyjë përje-

Lasgush Poradeci - vizatim nga Petroq Kollivica 1978



Lasgush Poradeci dhe Petroq Kollivica 1960

...në këtë, të kështjës, të kështjës...
do të jetë, kontinuitet në shprehje, në shprehje...

Oh, si më kështjës

...!

...varg, si më kështjës

...!

...!

...!

...!

...!

...!

...!

...!

...!

...!

...!

...!

...!

...!

...!

...!

...!

...!

...!

...!

...!

...!

...!

...!

...!

...!

...!

...!

...!

...!

...!

...!

...!

...mënd të dërgjesh këtë natë,

Ku mënd të dërgjesh këtë natë,

Ku mënd të flet,

Kur hëna qesh në qiut e pa matë!

Selvitë nga kjo drile,

Qatitë dhe shëtitë

Të ngjajmë mjigjet n'ar;

Ju mënd të dërgjesh këtë natë

Në shtrat pos: në varrel-

Ju rrugën marrë...

Mëngjës, mëngjës,

Fetë bota e uetuar,

Fetë... fetë...

Por mua dis më ngreh,

Më shtym për të vrapuar,

Më shtym të vij tek ti

Për të të përqaftuar,

Sespe e dij që të vi përsuar,

Ri je shprehje e mban vesh,

Pse s'mund të dërgjesh këtë natë,

Pse s'mund të flet

Kur hëna qesh në qiut e pa matë!

...të tjera.

Poezi e P. Kole-
vicës ku Lasgushi
ka shkruar ritu-
llin dhe ndreqje
të tjera.

Dorëshkrim i Las-
gushit në përkthi-
min prej tij të poe-
zisë "Kamadeva" të
M. Eminesku

KAMADEVA

Derde, shpirtin e të shënjtë
me dhanje, o dhanje, o,
She ne gjumë tërë Kamadeva,
Kamadeva o Indio

Oy esth, diabeti, mburshem,
Pamë krahun papagali,
She i pënjeshkët kufizimit
Me ato fuge prej korale

Kisha ke, dhe si shigjeta
mban hy vepërish mizer.
Vetëm lule-helm prej gjasigut,
Lumit plakt e mardhëtor

Vure ahore ne kary nje lule,
Me gëllez, ne krahore,
She qe ahore ne qe nate

Oy ne shpirtin, tim e shigjet

Me shigjeten e shigjetës
Eshk e mi gëzty, ne lule
Ore e gëllez e krahore
She e shigjetës e krahore

Largut Puarvi

EKSKURSIONI TEOLOGJIK
I SOKRATIT

Kopertina e dorëshkrimit
të Lasgushit për poemën
"Ekskursioni teologjik i
Sokratit"

Shkruar nga
25 Mars, 1960

tësisht në republikën e lirë të letrave, përbëhet prej këtyre nollësirave mikroskopike, atomike.. po të çnat janë gjeresisht dhe lartësiat dhe lartësitat e mëdha të saja. Nuk di ne se ti i pranon, po une kam një gëzim të fllas shumë, të neq shumë vërretje, të bëj shumë vërejtje për një poezi që më pelqen-atehere kur më pelqen. Veçse kam frikë se mos mbeta i errët në shpjegimet e mija. Pyetmë, në mos kuptova ndonjë gjë.

Lasgush.»

Dhjetë ditë më vonë, më 30.6.59 më shkruante përsëri:

«Më thua se në lidhje me poezinë t'ende je d'akord.

Në e ndryshofsh, dërgom'a të lutem, të shohim,

Sepse nuk është çështja jote dhe imja, po e poezisë vetë.

Të fala nga zemra

Lasgushi»

KËSHTU TË DUA

Dua

Gjithmonë të të ndjej

Më pranë gjirit tim,

Më thellë shpirtit tim,

Dhe vargut tim gjithë përvëlim.

Dua

Çdo çast të të përqs

Me Qiej e Djej
 Në zemër të të qas
 Dhe tërë gaz
 Si futesh të të ndjej
 Ndër dej
 Tej e për tej!
 Dua
 Me mua të kundrosh
 Si derdhet drit'e yjeve
 Të ma kuptosh vështrimin e syve
 Dhe që të dyve
 Të na zhurritë i njëjti zjarr.
 Dua, Po, dua,
 Mendimet të të ziejnë
 Si zgjua
 Brëndapërbrënda
 Oh! Siç ma kënda
 Mua!

Kjo është poezia për të cilën shkruan
 Lasgushi në letrat që u përmendën.

KU MUND TË DËRGJESH KËTË NATË

Ku mund të dergjesh këtë natë,
 Ku mund të flesh,
 Kur hëna qesh në qiejt e pa matë!
 Selvitë nga kjo dritë,
 Çatitë dhe shtëpitë
 Të ngjajnë ngjyer n'ar:
 Ku mund të dergjesh këtë natë
 Në shtrat posi në varr!
 Dhe rrugën marr...

Mënge, mënge,
 Fle bota e qetuar.
 Fle... fle.,
 Por mua diç më ngreh,
 Më shtyn për të vrapuar,
 Më shtyn të vij tek ti
 Për të të përqafuar,
 Sepse e dij që ti rri zgjuar,
 Rri zgjuar e mban vesh
 Pse s'mund të dërgjesh këtë natë,
 Pse s'mund të flesh
 Kur hëna qesh në qiejt e pa matë!

FOTOKOPJE E DORËSHKRIMIT

Këtë poezi që e pata shkruar më 1961 ia tregova pas disa ditësh Lasgushit dhe ai ka bërë korrigjimet me bojë, i vuri edhe titullin. Më tha të ndryshoj shprehjen sepse e dij se është — tha — prozaike dhe të përsërisnja fjalët. Rri zgjuar në vend të Je zgjuar.

*** Në fillim të vitit 1976 shkrova poezinë «Balada e Luftëtarit Kombëtar»⁺. Atëherë titullin ia kisha vënë: «Balada e Ushtarit të panjohur». Që në vitet e fëmijërisë sime, në Korçë, isha familiarizuar dhe më ishte bërë e natyrshme të dëgjoja të quhej monumenti i Luftëtarit Kombëtar me emrin «Ushtari i panjohur» ose më

+ Kjo baladë u botua në revistën «Nëntori» Nr. 4, 1977.

mirë po e them në dialekt: Ushtari i panjojtur!

*Duke i vënë poezisë titullin «Balada e Ush-
tarit të panjohur», më dukej sikur e lidhja më
tepër me vendin, kohën, ambientin, njerëzit në
mes të cilëve është ngritur ky monument dhe me
ngjarjet që janë zhvilluar rreth tij. Poezinë ia
tregova Lasgushit.*

Mirë — më — tha — mirë e ke, po
titullin nuk e ke mirë. Ne kemi monu-
mentin e Luftëtarit Kombëtar jo monumentin e
Ushtarit të panjohur. Se s'mund të kemi një mo-
nument të tillë. Francezët, po, e kanë dhe duhet
të kenë «Le monument de Soldat Inconnu» ose
italianët «del milite ignoto» po kështu dhe të
tjerët, sepse kanë pasur ushtëria koloniale, që
kanë luftuar dhe kanë humbur nëpër shkretëti-
ra. Shqiptari, jo! Shqiptari ka luftuar për Shqi-
përinë në Shqipëri. Atje, është vrarë. Dhe s'ka
mbetur i panjohur asnjë luftëtar, se shoku i tij
ose do të vritej bashkë me të ose do ta merrte
në kurriz dhe duke e hequr zvarrë do t'ia shpi-
nte t'ëmës e t'et që t'ia shikonin plumbin se ku
e kish marrë dhe të gienin ngushëllim kur ta
shihnin se e kishte marrë në ha-
llë! Ky është luftëtar i vënë kombëtar, këtij
i është ngritur monumenti, jo atij ushtarit fat-
keq që la kockat i harruar në rrëzën e nxehtë
të Saharës ose në dëborën e Korçës tënde.⁺

⁺ Këtu Lasgushi aludon për ushtarët francezë të
vlarë në rrethin e Korçës në kohën e Luftës së Parë
Botërore.

Prandaj them që poezinë mirë e ke, po titulli i duhet vënë:

«Balada e Luftëtarit Kombëtar».

*** Ka qënë fillimi i pranverës së vitit 1979 kur erdhi nga Kosova Sabri Hamiti dhe solli librin me poezi të Lasgushit të titulluar «Vdekje e Nositit».

Lasgushi atëhere ka qënë i sëmurë nga një lloj alergjie me të kruara të forta të lëkurës dhe nuk dilte nga shtëpia, po kur i thanë se kërkonte ta takonte një poet nga Kosova, nuk nguroi aspak, shkoi menjëherë.

Shkova nga Lasgushi disa ditë pasi ishte takuar me Sabri Hamitin, Sabri Hamiti, kur u paska takuar me Lasgushin, paska thirrur i gëzuar dhe i mallëngjyer: «E pashë Lasgushin!»

Këtë ma tregoi Lasgushi. Dukej që i kishte pëlqyer.

Më tregoi dhe librin që i pati falur Sabriu, «Vdekja e Nositit».

Kam dëgjuar — i thashë unë — se ata në Kosovë kanë botuar veprat e plota të Naimit, Asdrenit, Mijajenit dhe mjaft shkrimtarëve të tjerë, Mirë bëjnë — tha Kosova ka nevojë për libra. Kosova ka bërë kundër Turqisë luftë Skënderbeane, por drita e rilindjes atje nuk hyri. Asnjë libër, asnjë gazetë s'u botua nga Kosova në atë kohë kur toskëria mbushej me libra dhe me gazeta. Prandaj ata e kanë shumë të nevojshme ta shohin dritën e rilindjes, atë dritë që bëri Shqipërinë.

Po kjo, e di se ku do të na shpier? Nuk u përgjigja. As ai nuk foli, por u ngrit nga shtrati, shkoi te dollapi në anën tjetër të dhomës, e hapi mori diçka dhe me lëvizjet e tij të shkathta m'u afrua në çast. Në dorë kishte një finxan kafeje dhe një gotë rakije.

Merre — më tha — dhe më dha gotën e rakisë bosh, e vazhdoi: Nuk kam as dy gota njëlloj, as raki që t'i mbush, po kjo nuk më ndalon të them atë. që dua të them.

Do të vijë një ditë, kur do të vemë në dasmë e do të urojmë:

Mos e pifshim këtë gotë, po të mos bashkohemi me Kosovën! Dhe do të vemë në vdekje dhe do të ngushëllojmë: Mos e pifshim këtë gotë në mos u bashkofshim me Kosovën! Dhe shtë i shkëlqenin dhe i përpiqnin gotën e finxhanin bosh e prapë përsëriste: Do të vijë një kohë kur dollia do të fillojë me këto fialë: Mos e pifshim këtë gotë në mos u bashkofshim me Kosovën!

**** Ishim bashkë me Lasqushin në shtëpi të Dhimitër Paskos, pasi u kthyem nga varrimi i tij. Rrinim dhe s'na rrihej. Dëshim diçka të thoshim, po asniëri s'auxonte. Kur Lasqushi u ngrit të shkonte, e shoqërova. Rruqës ecnim të heshtur, sikushdo me brenqën e përbashkët e me mendimet e ve'at. Më kujtohet fare mirë dhe s'do ta harroi kurrë:*

Po kalonim nërpara Pallatit të Kulturës. Unë isha ende i nërlotur. Lasqushi ndaloi m'i nguli ata shtë e zinj dhe tha:

Sot unë jam më i mjerë se sa ti, sepse s'mund të qaj. S'jam i zoti të qaj. Kam qarë shumë... Dikur qanja dhe duke qarë hanja një supë të varfër... Lotët më rridhnin mbi pjatën e supës, më pikonin në lugë dhe unë i kam ngrënë lotët... Prandaj s'mund të qaj më.

S'ishte koha për ta pyetur se kur kishin ndodhur këto dhe ashtu të heshtur, pranë shtëpisë së tij, në gjysmëerrësirën e mbrëmjes, u ndamë.

S'thamë dot «natën e mirë» atë mbrëmje që i kishim thënë Mirushit «Lamtumirë»...

*** *Nuk e pyesnja kurrë se në ç'organ e kish botuar këtë apo atë shkrim, se Lasgushi e kishte parim të thoshte:*

Ai që do të bëjë shkencë, e kërkon dhe e gjen. Më pyesin mua; Kur kini lindur ju zoti Lasgush? Po unë mund të ta them datën gabim! Mund të dua të dukem i vogël, a mund të më interesojë të bëhem më i madh. Njerëz jemi! Mundet që vërtet s'e di, ose e di gabim. Ti, që do të bësh shkencë, shko në Pogradec, merr Regjistrin Themeltar, kërko në Librat e kishës dhe gjeje. Po do të humbasësh kohë! Pse, si dashke të bësh ti shkencë, me të pyetur lart e poshtë?

Shko, rrëmo bodrumet!

Le, po ç'kanë me moshën time? Mos jam unë ndonjë çupë për t'u martuar? Unë jam aq sa jam!

*** *Në vitin 1978 te Lasgushi u afrua Ismail Kadareja. I bëri vizitë në shtëpi së bashku me*

djalin e vogël të Mehmet Shehut, Bashkimin. Lasgushi u shiroi edhe një drekë në shtëpi të tij ku erdhën me gjithë gratë. Pastaj e morën ata Lasgushin për drekë në një restorant.

Në këto drekra e kisha të lehtë të merrja pjesë, sepse ismailin e njihja dhe me Bashkimin kisha një pershëndetje të jtohte, por nuk shko-va asnjehere. Këto takime i quaja fatkeqësi për Lasgushin. Kisha bindjen se diktatura me këtë afërimit po bënte përpjekje për t'i fshirë e për t'i narruar ato tridhjetë e pesë vjetë të braktisjes së plotë të Lasgushit e ta nxirrte veten të larë, A thua nuk ishin komponente të kësaj strategjie djallëzore, festimi i tetëdhjetëvjetorit të lindjes e pastaj ceremonia e varrimit e kryer sipas të gjitha rregullave të falsitetit zyrtar? Lasgushi prej tyre nuk përfitoi asgjë. Vetëm diktatura i dha të drejtë vetes të thotë me mburje: Ja! Lasgushit ia bëmë të gjitha nderet! Po ne jse, le të kthehemi tek ato takime.

Nga një shok i Ismailit e i Bashkimit mora vesh se në gostirat, Lasgushi i kishte mbajtur miqtë me muhabet të këndshëm mbi artin e poezinë, por u ishte dukur se s'prekte fare me realitetin, aq sa Bashkimi e paskësh quajtur «Banor të qiellit». Këtu ata ishin gabuar rëndë. Në ato kohë të errta, kur të fluturonte koka, të të vinte në shtëpi djali i Mehmet Shehut, ç'muhabet mund të bënte? Kodra mbas bregut! Edhe Lasgushi ka bërë atje plot shakara e biseda me pamje qëllimisht naive, sa për të kaluar rradhën. Koha e mësoi Lasgushin të dinte të mbrohej në ambientin armiqësor, ku jetonte. Ismaili dhe Bashkimi

ndejtën vërtet me Lasgushin, po fytyrën nuk mund t'ia shihnin, se me njerëz të tillë, që ishin aq afër pushtetit absolut ai s'mund të rrinte veçse me vizierë të ulur.

Po, kur duhej, ai shfaqej me të tërë madhësitë e kthjelltësinë e tij. Kështu mund të përmend rastin kur Lasgushi, në librin «Vdekja e Nositit» që ia dha Bashkim Shehut, shënoi këto vargje:

«Ngjitu lart nëpër gëzime»,
Zbrit përposh në hidhërime,
Qëndro një nëpër ndryshime,
Se kështu ke zemrën time».

Ky mësim moral stoik, mbase i ka vlejtur Bashkim Shehut, në rrugën e vështirë ku e zvarrisi sistemi i ngritur nga i ati.

Në takimet e pakta që pati me Bashkimin, Lasgushi qysh një ditë më parë ishte i nervozuar fort, por përmbahej, se i duhej. Vajza e madhe kishte mbaruar studimet e larta për gjuhë-letërsi dhe kërkonte një vend si mësuese në një shkollë tetëvjeçare në Pogradec. Kush mund t'ia mbaronte këtë punë më mirë se sa djali i Mehmetit? Dhe një ditë Lasgushi i tha: «Ore ti, Shehu i vogël, thuaji atij Shehut të madh të ma rregullojë çupën në Pogradec». Po as Shehu i vogël e as Shehu i madh nuk ishin mjaft për ta bërë çupën e Lasgushit mësuese në një shkollë të Pogradecit, që të mund t'i mbetej pak kohë t'i bënte ndonjë shërbim edhe babait të vet plak. Për çupën

e Lasgushit mezi u gjend një vend në shkollën e fshatit Buçimas, ku ajo, çdo ditë, për pesë vjet me rradhë, bënte një orë rrugë vajtje e ardhje.

Po edhe kaq — tha Lasgushi — bereqaves, bereqet mos paçin!

Në këtë kohë Ismaili më tha se po interesohet që Lasgushi të shkonte për vizitë në Kosovë. I theksova që ai është mjaft plak e i sëmurë dhe nuk di a e përballon dot gjithë atë rrugë.

Mos ki merak — tha Ismaili. Do ta shoqërojë Moikom Zeqo, që është një djalë i shëndoshë dhe do ta përkujdesë mirë. Megjithatë Lasgushi nuk shkoj dot në Kosovë jo se ishte plak apo i sëmurë, por siç mund të kuptohet, sepse dikush nuk deshi që ai të shkonte. Kush ishte ai dikushi?

Ditët kaluan ngadalë e të rënda si gjithnjë. Erdhi vera e vitit 1980. Lidhja e Shkrimtarëve dhe Artistëve të Shqipërisë (dmth Komiteti Qendror i PPSH) me gjashtë muaj vonesë, vendosi të lejojë festimin e tetëdhjetëvjetorit të lindjes së Lasgushit.

Ata, që e njihnin, bisedonin fshehtas me njëri tjetrin:

— C'është kjo ditëlindje?!

— Këtyre u a la Kosova turpin në derë — Përgjigjej tjetri.. Atje ia festuan tetëdhjetëvjetorin Lasgushit, prandaj këta nuk po i nxë lëkura. Nuk duan të mbeten prapa.

Edhe Lasgushit nuk i pëlqente aspak ky lloj festimi.

Unë e di — më tha. Këta festojnë falsitetin e

tyre, jo ditëlindjen time, po unë s'kam ç'të bëj. Jam i detyruar të dal para atyre nja njëqind vetave, që do të jenë atje, me këto rroba e me keto këpucë të vjetra. Pale, po do të më duhet edhe të flas!

Në gusht të vitit 1982 Lasgushi pati një *ishemi cerebrale*, kur ishte në Pogradec. Kjo semundje ia tronditi dhe shkatërroi kujtesën. Në këtë kohë gruan e kishte të sëmurë, gjysëm të paralizuar nga kyçet e këmbëve dhe të duarve që mesi i lëvizte. Vajzën e madhe e kishte mesuese në Starovë të Pogradecit. Një vit me vonë i vdiq gruaja. Vajza më e vogël s'e përballonte dot vetëm shërbimin për të cilin kish nevojë Lasgushi, prandaj disa të njohur e dashamires u interesuan për transferimin e vajzës së madhe në Tiranë.

Meqënëse Lasgushi nuk ishte në gjendje, më 7.2.1983 unë shkrova këtë letër për Ministrinë e Arsimit. Lasgushi mezi vuri vetëm firmën

Shoqja Ministre!

Është hera e parë dhe e fundit që ju shqetësoj. As këtë nuk do ta bëja, por kushtet e rënda shëndetësore më detyrojnë. I bindur se jini e gatshme të më dëgjoni dhe të më kuptoni po jua shpjegoj:

Prej rreth një viti jam i sëmurë rëndë. Jam tepër plak dhe tepër i sëmurë. Kam nevojë të domosdoshme për shërbim. Për një shërbim të tillë që mund t'ja bëjë vetëm fëmia prindit. Por

unë fëmijën tim, vajzën time Konstandina Lazar Gusho, nuk e kam pranë. E kam larg, mësuese gjuhe-letërsie në shkollën e fshatit Buçimas (Starovë) të Pogradecit që prej 5 vjetësh. Ju lutem të bëni ç'është e mundur dhe e pamundur për të ma transferuar këtu, në Tiranë si mësuese, që ta kem pranë të më shërbejë në këto ditë të rënda që po kaloj.

E pata vështirë të filloja. E kam të lehtë tani që mbarova, se ju shkrova Juve që kam shprese të më kuptoni siç e kupton bija babanë.

Përfundoj me nderim dhe respekt
Lasgush Poradeci

Më vonë i dërgova edhe dy letra me përmbajtje gati të njëjlojtë si kjo Kryetarit të Komitetit Ekzekutiv të Tiranës, Për këtë punë u interesua dhe ndihmoi Lazar Siliqi.

Vajza e Lasgushit u kthye u (transferua) në Tiranë dhe filloi punën në shtator 1984.


*** — Nga fundi i vitit 1982 Lasgushi ishte mjaft i sëmurë. Kishte ditë kur i humbisja shpresat... Për ta gëzuar atë disi, përktheva nga Rabindranat Tagor, poezinë e më poshtme:

Ata ty të çmendur të quajnë shpesh,
I fortë qëndro dhe mos vërë vesh,
Ata sot të shtyjnë, të shtypin sa s'ka,
Sot baltë fytyrës të hedhin ata,
Po nesër do sjellin te ti në shtëpi

Buqeta me lule me plot brohori.
Po, sot kanë forcë, sot kanë pushtet,
Ne sot nga lart poshtë na shohin vërtet,
Po nesër, nesër, ata dhe jo ne
Të bindur do ulin kokën përdhe...

Këtë poezi ia recitova dy herë si urim për vitin e ri 1983. Lasgushi e dëgjoi me vëmendje dhe u mjaftua të thoshte vetëm: «E bukur qenka». Tani, pas kaq vitesh, më vjen mirë që u vërtetua profecia e Tagorës. Ata që dje «na shihnin nga lart poshtë» sot «Të bindur ulin kokën përdhe» por ç'e do? Lasgushi nuk është...

«Kamadeva»



Ja «Kamadeva»! Merre — më tha Lasgushi. I ndritnin sytë si asnjëherë, po i kishte dhe si të mbushur me lot. Ishte i mallëngjyer dhe i gëzuar, sikur niste për një udhëtim të bukur, por të largët, njeriun e vet më të dhemshur.

— Merre dhe mbaje ti për kujtim këtë kopje të shkrojtur prej meje. Lexoje, po mos harro, më thuaj për ndonjë vend që s'është mirë.

.....

U ktheva tek Lasgushi, bashkë me «Kamadevan» pas nja dy javësh.

— Ç'u bëre? Humbe!

— S'më linte «Kamadeva» — i thashë — dhe hyra menjëherë në temë:

Më pëlqeu shumë. Kjo poemë ka strukturën, thurrijen, arkitekturën e një simfonie.

Ashtu thua?

— Po, i ka të gjithë elementët përbërës të Simfonisë.

Ky krahasim i poemës me simfoninë i pëlqeu. Unë i shtjellova disa argumentime e krahasime në mbështetje të kësaj teze. të cilat e kënaqën edhe më tepër. Qeshte i gëzuar.

Po shumë gjëra nuk i thashë dot...

Do të mundohen t'i them tani më të plota; ashtu sic i kisha në zemër atëhere:

Ajo poemë është një simfoni.

Fillon në andante, e qetë, e rëndë, e trishtuar, tregimtare. Këtu jepen temat e melodive që do të zhvillohen e pasurohen me variacione të shumta më tej, gjatë kohëve të tjera.

Si të gjithë kompozimet e mjeshtëreve të mëdhenj, simfonia ka gjuhën specifike të krijimeve të mëparshme të autorit. Që në tingujt e parë kuptohet se e kujt është.

Dhe si të gjitha simfonitë më të mira të kompozitorëve më të mirë, në bazë të melodive të veta ka meloditë e këngëve popullore të vendit të vet, por të asimiluara në shpirt dhe të rikrijuara me art.

Ç'kundron ashtu kur del,
Ti moj e mira?

.....

Kurm-holla si gargi
Për mezi thyer,
Shtat-hedhura-selvi,
Vaj-erë-lyer:

E hepuara si bar,
Llërë-kulluar,
E qruara si ar,
Gji-qumështuar.

Je vesë a menjë a je
Brymë a dëborë,
Hirploteja mi dhe
Vetull-kurorë;

Je hënë a djellë a yll
Vetëtim-naltë,
Kaprolleja në pyll,
Rritur me mjaltë.

*Në mes të tingujve të trishtuar që zotërojnë
nga fillimi në fund dhe për këtë mund ta quajmë
«Simfonia e trishtuar» — dëgjohen pasazhe të
bukura me melodi të ëmbla e sublime të da-
shurisë»:*

U çquan hënë e yll
Në mug të vonë,
Ndriçuan n'atë pyll
Takimin tonë.

Dhe pylli ndezur n'ar,
Q'u tung nga vendi,
Gjëmoj tingëllimtar
Si gjëmë ergjëndi.

Limeri u mbush përplot
Me shkrumb e hiçe,
Ne t'ikim s'ikim dot
Prej kaq magjije.

Ja, posi n'ëndërrim,
Lumtëri-dehur,
Në qjell një murmurim
Zu papandehur.

Një këng' e lart' u ndje,
Me plot jehona:
Këndonin përmbi ne
Dy shpirtrat tona:

*Dhe pasi jemi ngopur me harmoninë e tingujve
të ëmbël e thellësisht të trishtuar, ja ku ndjejmë*

të tërë orkestrën të gjallërohet për një finale të madhërishtme:

Qajnë violinat, rënkon kontrabasi, buçasin instrumentat frymorë, gjëmojnë daullet, klithin fanfarat:

Ku je, ti mall! ti mall!
O jeta! jeta!
Sa larg që zall më zall
Mezi të gjeta!

Pastaj një pauzë... dhe pianoforti përsërit meloditë e trishtuara të fillimit. Së fundi disa gishterinj të bardhë e delikatë gruaje dredhin telat e një harpe; Është harpa e zemrës së poetit.

Mendoj e shkoj nga pak
Si gjithëmonë,
Me shpirtin zemërak

Në rrugën tonë.
Ku silleshim të dy,
Me të baritur,
Me dëshërim në sy,
Me shpirt të ndritur

Ku regëtin dhe sot,
Me ato kujtime,
Buçimi gjëmë-plot
I zemrës sime.

.....

Simfonia mbaron. Kompozitori-dirigjent përshëndet kokulur, i zbehtë e i lodhur.

Betoveni i shurdhër largohet nga skena, duke vazhduar të dëgjojë finalen e simfonisë së vet dhe si shkon ndërmend të pyesë për duartrokitje... Ec i vetëm buzë liqenit, i ndjekur nga qeni besnik, Cuci dhe nga tingujt therrës të fanfarës që vazhdon të klithë:

O, Jeta! Jeta!



Pasi jola për vlerat e poemës, i thashë dhe vërejtjet që kisha për të. Cilat ishin vërejtjet?

Perpara se të flas për to duhet të përmend që Lasgushi kishte një bindje të patundur mbi përsosmërinë e poezive të tij. Unë kam besim në artin tim! Kjo ishte motoja që i pëlqente ta përsëriste herë pas here. Kur binte fjala për ndonjë varg a strofë a poezi të bukur të ndonjë poeti shqiptar ose të huaj, Lasgushi thosh:

Sa e bukur! Njëlloj, sikur ta kisha bërë unë.
Ose

E përsosur! As unë s'e bëja dot më mirë! —
dhe shtonte

Më mirë e bëja, xhanëm, unë, po ky mirë e
ka bërë, Shumë mirë.

Ky koncept e pengonte shpesh të dëgjonte, të mirëpriste dhe të analizonte vërejtjet që mund t'i bëheshin.

Për ta shpjeguar më mirë këtë, jam i detyruar të hap një parantezë të gjere: Një shkrimtar i ynë, që herë pas here botonte poezi, në pushimet e verës vinte dhe në Pogradec. Krinje ngandonjëherë në sallën e kafenesë të hotelit të vjetër ku dhe qëllonte të shkruante.

Kur Lasgushi hynte te kjo kafene vinte një pershendetje me koke për të gjune që te porta e jashtme dhe pastaј arejtoneј te naonje lavo-une bosn ose tek naonje i njohur që e jtonie.

Kështu hyri Lasgushi një aue dhe po kalonte prane tavolinës ku rrinte ai shkrimtari.

— Lasgush! Eja të pimë një kafe, — i tha ai.

Lasgushi shkoi, u pershendet me të dhe duke u ulur e pyeti:

— Ç'po shkruan kështu?

— Poezi, Lasgush!

— Ç'do me poezitë ti? Poezia, që të mbetet, do Lasgush!

Ka qenë mbase ky koncept, po mbase dhe mungesa e taktit të redaktorëve, ato që e bënë Lasgushin të shkruajë vargjet e mëposhtme, vargje që paçka se nuk u patën botuar, asi kohe, këtu e njëzet e pesë vjet më parë, i dinin mjaft veta e me to ngacmonin miqt' e tyre redaktorë:

Redaktorët, tru kokallë,
Redaktojnë profesorët,
Po, më thoni cilët vallë
Redaktojnë redaktorët?

Nga njohja e gjatë. unë e kisha fituar të drejtën të hyja në tempullin e tij të shenjtë pa i zbathur këpu-

cët e ndotura me baltën e rrugëve. Pra, mund të bëja vërejtje pa m'u zemëruar. I thashë: Duhet të hiqet kjo strofë:

Dhe me atë sy paqtor
Ma derdh në duar
Ah, hirin vajzëror
Të pacënuar.

Pse? Se në atmosferën e gjithë poemës që është krejt ndjenjë eterike dashurie të idealizuar, kjo strofë stonon, duket tepër vulgare. Kjo vërejtje i pati dhembur fort.

Nuk di në ra ndonjëherë dakord me veten e tij për ta hequr këtë strofë, por për shumë kohë — dhe pas dy-tre vjetësh — kur vinte fjala, më thosh:

— Ë. si the ti për atë strofën? Ta heq? Është tepër materiale? S'është në harmoni me të tërë poemën? Vërtet?

— Po — i thosha.

— E po, u dashka hequr atëhere! U dashka hequr!

Këmbëngula. atëherë, edhe për heqjen e disa fjalëve, që s'janë poetike — i thashë — po gastronomike, si p.sh. fjalët: Najazmë, Rigon, Merudhi, Dumbushere, bile duhen hequr krejt strofat ku janë këto fjalë. Duhet hequr dhe këto strofa të tjera që s'i shtojnë gjë poemës, por e ngarkojnë kot, si:

Me sy më vetullon,
Sy-vetullushe,

Në krah më fluturon.
Krah-fluturushe.

Rrëmovi me rrëmim
Në kraharruar
Trazovi me trazim
Të shëntëruar.

Dhe qeshe dashurisht.
Moj dashurore
Dh'u skuqe nusërisht.
Moj nusërore.

Rrinte i heshtur. Dëgjonte me kujdes, por as më kundërshtoi, as më aprovoi.

Sikur të më kishte dëgjuar!

Sikur ta tërharte këtë poemë nga disa xhinglo e zbukurime manieriste, sa do të shkëlqenin ato perla e xhevahirë e rubinë të çmuar që mban në qafë!

Ah, Lasgush!

.....
Ishin këto perla e xhevahirë e rubinë e mjalhtë shqipeje të kulluar që gjeta atëhere te kjo poemë — dhe vazhdoj të gjej të tjera sot — ato që më bënë të thur poezinë për ta uruar Lasgushin me këtë rast.

Poezinë kushtuar Lasgushit s'e bëra unë. U bë vetë. Isha i mbushur plot, atëhere, me bukuritë e «Kamadevas» dhe prej tyre buruan ato strofat e mia. S'mbaj mend të kem prishur a ndrequr ndonjë varë a ndonjë fjalë. Kur vura në fund emrin dhe datën, e lexova disa herë, ndoshta dhe me zë, s'e di, por di që ndjeva një këzim të madh.

*Ia shpura Lasgushit. E lexoi. I pëlqeu.
Pasdite më erdhi në shtëpi, Tek unë ai vinte shumë rrallë, vetëm për ndonjë festë — si për Vitin e Ri — ose për ndonjë nevojë urgjente.
Erdha — më tha — të të pyes për një fjalë në atë poezinë tënde. Çdo të thotë fjala «Lingotë?»
Ne, në Poradec, «Lingë» i themi ziles së vogël të bagëtive, që ka tingull të hollë. Ti, fjalën *Lingotë*, për *Lingë* e ke vënë?
— Jo, i thashë. *Lingot* është tjetër gjë. Ja si e përcakton *Larouss-i*:*

Lingot — *Morceau du métal solidifié après fusion: lingot d'or*(1)

Ky është kuptimi i fjalës që kam vënë unë. *Lingot d'or*, që ruhet si thesar.

U R I M

Lasgush Poradecit

Po të blatoj, Ravvi.
Gjith ç'ndjej që thellë:
Me «Kamadevan» — Ti —
Ke sjellë Djellë.

Si Djellë ndrit, Ravvi.
Kjo fjala shqipe
Nga kaqë lartësi
Ku ti e hipe.

Dhe shqipes sot, Ravvi,
I u rrit thesari.
Çdo varg që vure ti —
Lingotë ari.

Rrëfyer ke, Ravvi,
Me varg të vyer
Një art që s'njeh njeri
Më të përkryer.

Se bëre ti, Ravvi,
Me poezinë
Muzikë, simfoni,
Mbi simfoninë

Një simfoni, Ravvi
Prej shpirti bërë

Q'e thith në shpirt të tij
Një komb i tërë.

30 Prill 1978

*** Tani do të shkruaj për diçka që më ka dhembur e më dhemb fort ende sot:
Në fillim të vitit 1980 Lasgushi, me që nuk ishte mirë me shëndet, më dha të shpija në Shtëpinë Botuese «Naim Frashëri» dorëshkrimet e përkthimeve prej tij të disa vjershave të M. Emines-kut. Doemos, vetëkuptohet, përpara se t'i shpija këto poezi do t'i lexoja. I lexova. Ç'bëra që i lexova!

Duke i shfletuar e lexuar ato poezi gjeta dhe

një me titullin: «Kamadeva» Sikur më ra pika! Mitrush Kuteli që herët e ka vënë në dukje dyshimin për njëfarë influence të artit të Emineskut te poezia e Lasgushit duke e lënë argumentimin e kësaj teze për një kohë tjetër, kohë që, për fat të keq, iku bashkë me të.. Tani më del përpara një poezi e Emineskut me titull «Kamadeva»! Dorëshkrimin e përkthimit të poezisë «Kamadeva» të Emineskut nuk e çova në shtëpi botuese dhe nuk u botua. Mbeti aty në qilarin e dosjeve të mia.

Le të botohet njëherë shqip «Kamadeva» e Lasgushit — thashë — pastaj ajo e Emineskut! Apo s'kam të drejtë?

Besoj se janë tepër të pakët ata që e njohin këtë poezi të Emineskut. Po ta kisha ditur më parë, do të, isha bërë ferrë, mace, rodhëzë dhe do t'i qepesha Lasgushit që të mos e përdorte këtë titull të huajtur nga Eminesku.

Po plakut aq i bën!

Ai mbështetet te teza e vet eternele:

NE S'PYESIM SE Ç'FARË MARRIM DHE SE KU E MARRIM. NE PYESIM SE Ç'BËJMË ME ATË QË MARRIM. BËMË DOT ME TË VEPËR ARTI? PO? ATËHERE AJO QË MORËM DHE PREJ NGA E MORËM ZHDUKET? BËHET E JONA. ECCO, JA SI BËHET ARTI!

M. EMINESKU

K A M A D E V A

Desha shpirtin t'a shëronia
Me dhembjet e dashurisë,
Dhe në gjumë thirra Kama-n.
Kamadeva-n e Indisë

Ay erth, djaloshi i mburrshëm,
Përmi kraha papagali,
Dhe i gënjeshtërt buzëqeshte
Me ato buzë prej korali

Flatra ka, dhe si shigjeta
Mban ky vogëlosh mizor
Vetëm lule-helm prej Gangut,
Lumit plak e madhështor

Vuri ahëre në Harg një lule,
Më qëlloj në krahëruar,
Dhe që ahëre në çdo natë
Qaj në shtratin tim i zgjuar.

Me shigjetën e vrerosur
Erth e më qërtoj në botë
Biri i qiellit të kaltër
Dhe i ëndërrës së kotë.

Ky është përkthimi i poezisë
«Kamadeva» të M. Emineskut,
bërë nga Lasgushi dhe të cilën
unë nuk e dorëzova në Shtë-
pinë Botuese «N. Frashëri».

Lasgushi, njeri.

dhe ishte një njeri i sëmurë, që quhej
Lazar...

Ungjilli pas Johanit krye 11, 1



Dr. Profesor LASGUSH PORADECI
INSTITUTI I SHKENCAVE

Ju, që shihni këtë kartvizitë, menjëherë mund të përfytyroni një burrë në moshë të thyer, flokëthinjur, me kapele republikë, kostum të zi, me jakën e këmishës të bardhë të kollarisur, me bastun në dorën e djathtë e çantë lëkure në të majtën.

Te porta e pret vetura. Shoferi me një buzëqeshje të shtirë nxiton të përshëndesë dhe t'i hapë portën makinës. Ai hyn e ulet me kujdes, vendos çantën te vendi pranë, mbështet të dy duart mbi bastunin, që e mban në mes të këmbëve dhe vetura niset.

Dy a tre kalimtarë e përshëndesin me respekt.

— E pe kush ishte?

— Si jo! Profesor..



Mos përfytyroni një njeri të tillë prapa kësaj kartvizite! Dr. Profesor Lasgush Poradeci ishte njeriu më i thjeshtë që mund të ketë ecur në rrugët e Tiranës:

Me rroba të vjetra e dalëboje, por të pastra. Me këpucë të vjetra, por gjithmonë të llustruara. Me kapelë republikë të vjetër. Bastunin, po. E kishte! Një bastun druri të rëndë tek i cili nuk mbështetej kurrë dhe më ngjante se ishte forcë zakoni e nostalgji për kohën e rinisë.

Ecte i shoqëruar nga Cuci qeni i tij besnik — që e ndiqte pas, herë i lirë dhe herë i lidhur me një rryp të hollë lëkure. Rrugës takonte edhe njerëz që e njihnin dhe e përshëndesnin, por të shumtët e shihnin me kërshtëri:

— Ç'është ky plak me këtë qen?

— S'e njeh? Lasgush Poradeci!

— Pse, rrojtka Lasgushi?

ose:

— Ç'që ky me këtë kone?

— Lasgushi, moj, Lasgushi, ai poeti, Lasgush Poradeci.

Pse, ky qenka Lasgushi?

— Ë, ë

— Ua!

Dhe Lasgushi ecte tutje, bënte shëtitjen e mbërëmjes buzë Lanës, i mbështjellë deri te sytë me shallin e tij të vjetër bojë kafe në gri të errët.

Te porta nuk e priste vetura. Në Pogradec shkonte me kamion, përpara, pranë shoferit. Shoferët ishin gjithmonë burra nga Pogradeci, që Lasgushi i gjente, ose më mirë të themi e gjenin ata Lasgushin kur ai vinte në një pikë qëndrimi të kamionave, në rrugën që shkon për në Elbasan, pranë urës përmbi Lanë.

E dinin ata! Kur shikonin Lasgushin atje, desh të thosh që po i kërkonte. Të nesërmen ata vinin që herët përpara shtëpisë me kamion të ngarkuar me mallra dhe prishnin Lasgushin. Ngarkonin dy a tri thasët me libra dhe plaça të tjera, që ai i bënte gati me kujdes një javë më parë, merrnin Lasgushin me Cucin, që ai e mbante në prehër dhe niseshin. S'ia prishnin kurrë qejfin atij! Kur të thoshte ai niseshin, ku të thoshte ai qëndronin! Dhe ishin po këta burra nga Pogradeci që do ta sillnin me kamionat e tyre në Tiranë, sapo të binte dëbora e parë në mal të thatë.

Lasgushi s'kishte dhe s'mbante çantë lëkure. Atë që i duhej e mbante në xhepin e brendshëm të xhaketës, në anën e majtë. Dhe ajo që i duhej ishte një gjysmë panine me një qofte

për vete dhe dy qofte për vajzat e vogla. Dhe çanta e tij — xhepi i brendshëm i xhaketës — ishte gjithmonë e fryrë kur ai kthehej në shtëpi.

Nëpër ato rostiçeritë gjithë tym, ndërsa priste të merrte qoftet apo salçiqet, me kë nuk hynte në bisedë! Njerëz të thjeshtë, punëtorë, pijanecë, hamenjë, kurbatë... Me këdo e gjente një motiv për të këmbyer disa fjalë. Ulej në nivelin e tyre, bëhej si i paditur, i habitur. Ata rrëfenin, ai i dëgjonte me kujdes dhe për t'i ngacmuar të tregonin më shumë, nxirrte një klithmë habie: Jo, xhanëm dhe ti!

Nga këta njerëz, — më thoshte, — ne poetët mund të mësojmë fjalë, që nuk i gjen nëpër librat dhe nuk i mëson nëpër bisedat me intelektualët.



Kur e njoha unë, Lasgushi ishte rreth të gjashtëdhjetave. Atëherë më dukej se ia kup-toja e ia ndjeja hallet e tij të mëdha, por si i ri që isha, doemos, kuptoja tepër pak.

Tani, që po i kujtoj ato ndodhi, ai trupi i tij i pakët, i gatuar vetëm me gjak fisnik e nerva, vjen e më rritet para syve e më bëhet i madh e i fortë si shkëmb që diti t'u qëndrojë gjithë atyre vështirësive.

Përfytyrojeni vetë:

Në moshën kur të tjerët dalin në pension dhe me kostum të ri, kapele kashte e me nipin për dore shëtisin nga kodrat e bleruara të parkut, Lasgushit i duhej të nisej me nxitim për te doktor Jorgoni ta thërriste për t'i vizituar vajzën motake që e kishte me temperaturë. Pastaj, prapë me nxitim për në farmaci. Pastaj në rostiçeri...

Natë. Mesnatë. Fëmia u qetësua. Po fle. Fle dhe qyteti... Tani është koha: Lasgushi merr të përkthejë poezi, të realizojë normën, të sigurojë rrogën.

Gëte shkruan:

«Shpesh e kini shpallur veten si miq të poetit, ju Perëndira! Jepini, pra, ç'ka nevojë. Diçka e arsyeshme i nevojitet atij: Së pari shtëpi të rehatshme, pastaj të hajë e të pijë mirë. Dhe ai di ta shijojë nektarin si ju.

Pastaj veshje të hijshme dhe miq për zemërsisht të bisedojë. Pastaj një të dashur të natës që zemra ia do.

Këto pesë gjëra të natyrshme kërkoj para së gjithash.»

Gëtes ia dhanë perënditë të gjitha tepër bujarisht, por këto «pesë gjëra të natyrshme» Lasgushit ia kursyen fort!

Së pari i kursyen shëndetin.

Përveç atyre që shkrova mbi shëndetin e tij në kapitullin «Pranë poetit» duhet të them se Lasgushi pati mbajtur për gati njëzet vjet me

rradhë një korset¹ për shërimin e spondilitit në shtyllën kurrizore. Korseti i mbështillte pjesën e sipërme të trupit, kurriz e kraharor. Ishte ndërtuar prej një skeleti metalik me rripa hekuri të mbështjellë me lëkurë të fortë dhe dukej si një parzmorë kalorësish mesjetarë, por Lasgushi e mbante atë me durim e stoicizëm të papërshkrues.

Megjithatë, sëmundja e vërtetë dhe tortura më e tmerrshme e jetës së tij ka qenë pagjumësia. Edhe pse pinte rregullisht tabletat somnifere, atë mezi e merrte gjumi pas orës dy të natës e shpesh mbetej zgjuar deri afër mëngjesit, ndonëse gjatë kësaj kohe lexonte e përkthente e lodhej fort!

Dramën e rëndë të pagjumësisë së tij mund ta kuptojmë disi po të shfletojmë librin me poezi të Gëtes dhe libra të tjerë prej të cilëve përkthente ku jo rrallë gjejmë të ketë shkruar anës faqes:

Ora 1.35, O zot, nëm gjumë!

E si të kishte gjumë?

Gëte ka të drejtë, kur thotë:

«Gjithçka u japin perënditë, të pafundmet,

1) Korseti ishte i llojit të quajtur-sistem Anbert. Atë nuk di se prej nga e pati kopjuar e vizatuar vetë Lasgushi dhe për t'ia bërë sipas atij vizatimi u kujdes me një përkushtim të veçantë ish-drejtori i atëherëshëm i uzinës radiologjike në Tiranë, i ndjeri inxhinier Koço Shkurti.

Të dashurve të tyre, krejt:

Të gjitha gëzimet, të pafundmet,

Të gjitha dhimbjet, të pafundmet, krejt.»

Diçka prej dhimbjeve të Lasgushit mund të kuptojmë nga sa shkruan në këto letra:

«... Po të shkruaj me kaq insistim dhe me kaq persistim për Burns-in; (Është fjala për një libër anglisht me poezi të R. Bërnsit, të cilin duhet t'ia gjeja e t'ia dërgoja unë. Shënimi është imi P. K) me qenë që jam pa material dhe pa lekë... dhe nga ky shkak jam keq, shumë keq ekonomikisht. Fëmijët më mbetën pa çorabe pikërisht tashi në dimër (sepse çorabet që iu bëra në Poradec në Korrik -Gusht të kësaj vere, u grisnë dhe u shkatërruan fare)...)»

Po nga ai sanatorium, më 15.5.1960, shkruan;

«Burns-in fillova ta përkthej, por nuk di në do të më paguajnë. Përktheva 300 vargje të Goethes, i dërgova më 31.1.60, kam kërkuar në disa letra likuidimin, por s'm'i kanë likuiduar, nuk di ç'ndodh (dhe unë kam shumë nevojë, me qenë që, prej Qershorit 1959 e gjer më sot — plot 12 muaj — nuk kam marrë përveç se ato nja 400 e ca lekë. Jam në shtrëngim të madh ekonomik, nga ky shkak...)»

E njëjta gjëndje vazhdon edhe kur shkruan nga Pogradeci, më 17 Gusht 1961:

«I dashur Petraq,

Në mënyrën më urgjente që të jetë e mundur, dërgomi të përkthyer shqip fjalë për fjalë

prej rusishtes këto vjersha të Burnsit... Prapë po të lutem të m'i dërgosh përkthimet në mënyrën më urgjente që të jetë e mundur, sepse mora sot një urdhër prej Ndërmarrjes Shtetërore të Botimeve ku më thotë: «Ndërpritni përkthimin e Gëtes dhe filloni Burnsint...»

Petraq ti e di: po të mos kem unë *material* për punë, mbetem pa bukë, d.m.th. më mbeten të dy fëmijët e mi të vegjël pa bukë. Më fal që po të shkruaj kaq me nerva, kaq i dëshpëruar, i demoralizuar...»

Për më se tridhjetë vjet Lasgushi u mor me përkthimin e kulmeve të poezisë botërore. Tani dua të tregoj për kushtet materiale në të cilat janë bërë këto përkthime prej tij.

Ai punonte me normë, si argat, në Ndërmarrjen e Botimeve dhe merrte 5021 lekë (të vjetra) në muaj. Ja, me këtë rrogë, janë përkthyer gjithë ato kryevepra, Duke pasur një pagë kaq të vogël është e natyrshme që të ishte vazhdimisht në vështirësi materiale deri për bukën e gojës të dy fëmijëve të vegjël. Për këtë do t'ju bindë (apo do t'ju tmerrojë?) një copë letër, që më pati lënë dikur në shtëpi:

«Tiranë, 14.2.61

I dashur Petraq. Të lutem të më gjesh 500 lekë (të vjetra) dhe të m'i sjellësh sot në shtëpi meqenëse jam në shtrëngim të madh. Nesër nuk kam as një lek në xhep. Do të t'i

kthej, bashkë me të tjerat, më dt. 18.2. ora
2 ose 3. Të përqafton Lasgushi.»

*Po dhimbjet nuk mbarojnë me kaq. Tronditëse
është një letër tjetër prej së cilës po shënoj ve-
tëm disa rradhë:*

«Pogradec, 3.10.72

I dashur Petraq... në pyeç për mua, megjithë-
që prej kohës i shtyrë e i pështyrë, mirë
jam. Kam nevojë të më bësh një nder... duke
më gjetur 5000 lekë (të vjetra) që të mund
të paguaj unë doganën e një paketi me
plaçka prej Amerike... se, prej 21 vjetësh
s'kam bërë dot rroba dhe prej 16 vjetësh
s'kam blerë tjetër kapelë... Yti, me dashuri,
Lasgush.»

*Për të plotësuar disi kuadrin është rasti të për-
mend edhe këto, që më ka thënë dikur Lasgushi:*

«Ishin njëherë në Ndërmarrjen e Botimeve.
Na kishin mbledhur neve, përkthyesit, dhe na
thanë: Propozoni ç'farë libra mendoni të përk-
thehen.

Më thotë i Shkreti Mitrush: Lasgush! Do të
propozoj të përkthesh ti Emineskun, se më mirë
nga ti nuk e përkthen dot njeri. Aman! — i tha-
shë — të dija se të kisha shok, po ti qenke ar-
miku im më i madh. Aman, mos më merr në qafë!
Po pse, o Pasko — i thashë — përkthehet Emi-
nesku me normë, me shtatë lek vargun?

— S'ka gjë, Lasgush, bëje për Emineskun.

— Nuk e bëj dot! Eminesku s'fiton gjë, kurse unë humbas bukën e kalamajve.»

Për ta mbyllur këtë kapitull të dhimbshëm po shënoj dhe këtë bisedë:

Ishte prilli i vitit 1979, një prill i paqendrueshëm, me pak diell e me shumë shi e të ftohta siç ndodh shpesh në Tiranë.

Si çdo ditë, afër drekës, kur ishte pak më ngrohtë, i mbështjellë me pallto e me shall, Lasgushi rrinte në verandë shtrirë në shezëlong dhe lexonte ose përkthente. Qeni — i lidhur aty pranë, Unë isha ulur në një taburet të vjetër dhe po bisedonim. Ndërkohë filloi të frynte një erë e ftohtë.

I them: Më mirë të hymë brënda, se mos ftoheni. Kam kohë të hy për të parë tavanin — tha. Rrinë edhe pak. Kam dhimbje koke. I kam të përherëshme. E di, vjen nga ezaurimenti nervor dhe mungesa e ushqimit. Kam më shumë se njëzet e pesë vjet, që s'kam ngrënë gjalpë. Vetëm vaj hamë. Po dhe atë — me pika...

Duke lexuar faqet e mësipërme, dikujt mund t'i kujtohen vargjet e Jaseninit:

*Të njohë çdo gjë, të mos marrë kurrgjë,
Për këtë erdhi në botë poeti.*

Kurse mua më vinë ndërmend dy vargje të Gëtes:

*Valixhe s'kemi ne. S'kemi veç se dy xhepa
Dhe ata, siç dihet, poetët i kanë bosh.*

Por Lasgushi i përmbledhte të gjitha me një nënqeshje të hidhur e me një varg të Emineskut:

(Poesie-sërëçie. (Poezi-varfëri,)

*** Lasgushi hynte në atë pjesë të inteligjencës shqiptare që ishte me kulturë të plotë, talent e shpirt të pastër patriotik. Qysh në vitet e para të pasluftës, kjo shtresë shoqërore iu nënvu një persekutimi të gjithanshëm e të shumëllojshëm. Për të shpëtuar diçka prej asaj atmosfere po shënojnë ç'më ka thënë Lasgushi: «Ti e di bibliotekën time. Ty të duken ndofta shumë këto libra që kam, po ti nuk e di se sa kam pasur. Dhe çfarë libra kam pasur! Ato s'gjenden më. Po, ç'u bënë — do më thuash. Ç'u bënë! Këtë e dimë unë dhe Nafija. Kur ardhi kjo kohë — që i thanë çlirim — doli një listë me emrat e librave të cilat duhet të hiqeshin nga bibliotekat private, dmth të zhdukeshin. Po bashkë me to unë zhduka dhe shumë të tjera. Pse? Nga frika! Se të shkonte koka po të thoshte ndonjëri në sigurim se filani ka filan libër. I nxora të tjera, bëra një kopicë me libra në mes të dhomës. Një javë të tërë kemi punuar me Nafijen. (Nafija, gruaja e Lasgushit, që dëgjonte në heshtje, tundte kokën e miratonte me dëshpërim).

Atje, në vatra e bodrumit, që ti e di, një javë të tërë kam djegur libra. Kjo m'i sillte, unë i shfletoja për të fundit herë, lexoja ndonjë gjë e pastaj i fusja në zjarr. Një javë të tërë, siç të thashë, dogja libra dhe një mot isha si çmendur për atë oë bëra. E bëra! Nuk desha të hy në burg».

Në dy-tre vitet e fundit, kur pothuajse nuk dilte nga shtëpia, tek rrinte ditë e natë shtrirë në shtrat me Cucin pranë, ndërmjet pauzash të gjata meditimi, ngjante se bënte një curriculum, të veprimtarisë së tij duke folur sikur fliste me vete:

«Ndoshta kam bërë gabim që nuk shkrova më shumë. Pse nuk shkrova? Gabim. Unë kisha mundësi të shkruaja gjithaq bukur edhe poezi të tjera. Gabim.»

Pastaj pauzë. Shihthe, i menduar, tavanin dhe përsëri fillonte:

«E pse të shkruaja më shumë? Aq sa kam bërë unë, mjafton. Ç'i do? Mjaft!»

Mirë thotë ky, pak mbeten» — dhe prekte lehtë me pëllëmbë, sikur e ledhatonte librin «Was bleibt» (ç'mbetet) të Eduard Engel

Pas një pushimi të shkurtër hidhej në temë tjetër, gjithmonë sikur fliste me vete:

«Unë besoj se koha as vjen, as shkon. Si ardhka dhe shkoka? Jo! Unë them se koha Është dhe ne jemi brenda saj.»

Pastaj pauzë e gjatë... Hapte e lexonte librin: «Die Reden Gotamo Buddhos»¹ (Të thënat e

1) — Karl Eugen Neumann. «DIE REDEN GOTAMO BUDDHOS» Faqe 320.

Budës) dhe, tek e shihja të mbetej i përqëndruar në lexim, më bëhej se kishte mbërritur të lexonte faqen ku ai thotë:

«Nëse i urti zë vend në karrige ose shtrihet në shtrat apo prehet përdhe, atëherë veprat e mira, që ka bërë më parë, bëmat e mira në vepra, në fjalë, në mendime, në këtë kohë vijnë përmbi të, ulen përmbi të, ndehen përmbi të.

Posi hijet e kreshtave të maleve të lartë, që në perëndim të diellit bien përmbi fushë, ulen përmbi të, ndehen përmbi të, po ashtu ndodh nëse i urti zë vend në karrige, ose shtrihet në shtrat apo prehet përdhe, veprat e mira që ka kryer më parë, bëmat e mira në vepra, në fjalë, në mendime, në këtë kohë vijnë përmbi të, ulen përmbi të, ndehen përmbi të...»

CUCI

Figura e Lasgushit do të mbetej shumë e mangët po të mos flisnim për qenin e tij. Lasgushi ka mbajtur gjithmonë qen. Qen të vogël. I fundit ndër ta ishte një qen i bardhë flokë gjatë që Lasgushi e thërriste: Cuci. Dhe e ka mbajtur këtë qen më se nja dhjetë vjet jo si gjithë bota të lidhur diku në fund të oborrit, por në dhomë dhe mbi shtratin e tij. Ai rrinte dhe flinte atje, në këmbët e Lasgushit. Lasgushi jo vetëm lexonte e shkruante shtrirë, po dhe hante shtrirë në shtrat, mbështetur në anën e djathtë.

Mëngjesin, drekën dhe darkën e tij të pakët gjithmonë e ndante me Cucin. Dhe Cuci ja shpërblente. Ishte tepër i zgjuar e i dashur me njerëzit e shtëpisë, por shumë i egër e kafshues me të huajt.

Në shtëpinë, e veçanërisht në dhomën e Lasgushit, s'mund të hynte njeri i huaj pa u lidhur më parë Cuci, i cili edhe i lidhur priste rastin ta kafshonte atë tinëzisht.

Shumë veta i thoshin: Zoti Lasgush, ç'e mbani këtë qen këtu, se do të na hajë!

Dhe ai e mbronte: Cuci s'ka faj. Ai kryen detyrën! Pa shko hyrë në ndonjë vend ku ka roje me pushkë! Të vret? Ë?

— Po.

— Cuci s'ka pushkë, ka dhëmbët. Me ato kry-en detyrën.

Cuci ishte tepër aristokrat. Mishin e hante vetëm të zier. Bukën thatë s'bënte kabull as ta shihte — Vetëkuptohet, bukën e bardhë të panines, se të zezën s'e njihte! Hante gjysmën e mollës së Lasgushit, gjysmën e vezës, por mbi të gjitha pëlqente ëmbëlsirat. Ato ishin dobësia e tij. Edhe unë e korruptova duke i dhënë karamеле me qumësht. Me to u bëmë miq. Dhe mbetëm miq... Me këto që thashë desha të vizatoj Cucin, por harrova se portretin e tij e ka bërë të plotë e të bukur, shumë vite më parë, vetë Lasgushi:

«Meiner Cuci, Cuci klein,
Der ist adlig, nicht gemein,
Trinkt kein Wasser, trinkt nur Wein.
Isst nur Zucker und Honig fein.»

Nuk e di se sa do t'i pëlqente Lasgushit, por po përpiqem t'i jap në shqip kështu këto vargje:

«Cuci im i vogël-o
Është fisnik, jo dosido,
Ujë s'pi, veç verë do
Dhe sheqer e mjaltë-po!»

Lasgushi ndoshta e ndjente që shumëkush nuk e miratonte mbajtjen e qenit aty në shtrat dhe shpesh herë i përsëriste këto fjalë:

«Qeni të shikon dhe thotë: Or Zotëri! Unë emrin e kam të keq-Qen, po punën e kam të mirë-Besnik!»

Na ato vitet e pleqërisë së thellë, kur Lasgushi rrinte ditë e natë shtrirë dhe shihte për muaj me radhë muret e tavanin e asaj dhomës së vogël, një qenie i qëndronte pranë me besnikëri të devotshme: CUCI.

poeti austriak Johan Alxinger (1755-1797) ka shkruar poezinë e dhimshme «Der Unglückliche an seinen Hund» (Fatkeqi, qenit të tij) nga e cila po shënojmë këtë strofë:

Der Menschen böser Undank trübt
Mir jeden meiner Lebenstage;
Du bist's allein noch der mich liebt
Und dem ich meine Leiden klage.

Mosmirënjohja e njerëzve të liq
Ma turbullon çdo ditë të jetës sime.
Ti je i vetmi, që ende më do
Dhe mund t'ia qaj hallet e mia.

Në se ka pasur ndonjë njeri në botë që i përshtatet kjo poezi, ai ka qënë Lasgushi në kohën e pleqërisë së thellë. Kohë e pleqërisë! Pa grua, pa shokë, pa miq. Ata, më të dashurit, kishin vdekur. Ndonjëri, që jetonte, ishte plak dhe i sëmurë. Nuk e vizitonte dot. Më pak të moshuarit, të rrëmbyer nga hallet e veta, e kishin harruar. Të rinjtë nuk e njihnin fare. Atij nuk i mungonte shërbimi e kujdesi i vajzave, por mungesën e shokëve e vuante thellë. Gjithmonë thoshte: «Ardhka një kohë dhe të lënkan të gjithë. Të lënkan...» Dhe kishte kaq trishtim në ato fja-

*lë... pastaj zhytej përsëri në heshtje, i shtrirë në
shtrat me Cucin aty pranë.*

*Dhe kështu përditë, gjithë ditën, gjithë kohën.
Në ato ditët e gjata të vetmisë, kushedi sa herë
mund t'ia ketë thënë Cucit të vet këto dy vargje:*

«Du bist's allein noch, der mich liebt
Und dem ich meine Leiden klage.»

(Ti je i vetmi, që ende më do
Dhe mund t'ia qaj hallet e mia).

Të tjerët për Lasgushin

Figurën e Lasgushit, personalitetin e tij, jetën, kulturën, mendimet e gjithçka tjetër rreth tij, e konsideroj si një mozaik të madh shumëngjyrësh, por mjaft gurë të tij mungojnë, se kanë mbetur në duart e në kujtesën e atyre që e njohën. Për këtë arsye pyeta disa personalitete të kulturës sonë, bashkëkohës dhe miq të Lasgushit, si dhe persona që e patën njohur, të cilët më thanë shumë gjëra të vlefshme kurse disa të tjerë, — siç thotë Mitrush Kuteli — «Nuk patën kthjelltësinë shpirtërore» të ndihmonin në këtë punë.

*** *Eqrem Çabej më ka treguar:*

Lasgushi kishte shkuar në Austri përpara meje dhe ishte nja dhjetë vjet më i madh se unë, prandaj e dëgjoja për çdo gjë kur më thosh se si të vishesha, si të sillesha. E dëgjoja si perëndi.

Duhet të vishesh —më tha — shumë mirë. Elegant. Të mbash dhe bastun.

— Edhe bastun?

— Po. Edhe bastun.

U binda, bleva dhe bastun.

Vetë Lasgushi vishej shumë elegant.

Rrobat i qepnim në një rrobaqepës që e pëlente shumë poezinë, veçanërisht poezinë moderne franceze. Dinte shumë poezi përmendësh.

Kur vinim për të bërë provë na thoshte, na recitonte ndonjë poezi ose disa vargje dhe na pyeste: e kujt është kjo?

Të kujt janë këto vargje?

Doemos, shumë herë nuk i gjenim se të kujt ishin vargjet.

Këtij do t'ia punoj! — tha Lasgushi.

Një ditë shkuam përsëri te rrobaqepësi dhe përsëri na recitoi disa vargje. Të kujt janë? — pyeti.

Jo — tha Lasgushi — sot do të them unë një poezi. Të shohim a do t'a gjesh. Dhe i recitoi tetë vargje frëngjisht.

Ishin vargje të bukura.

Rrobaqepësi qëndroi i menduar.

Thuama dhe një herë.

Do të ta them edhe dy herë! — tha Lasgushi.

Mos është e këtij?

— Jo!

— Mos është e atij?

— Jo!

— E këtij?

— Jo! Jo!

Më në fund rrobaqepësi i dëshpëruar u dorëzua. S'e gjej dot tha. — S'ke si t'a gjesh — i tha Lasgushi — se këtë e kam bërë unë!

.....

Si të rinj dhe studentë që ishim, shpesh bënim dhe prapësira. Thyenim rregullat në qytet dhe na tërhiqte vërejtjen policia. Në këto raste Lasgushi na thosh: Kur të na zerë policia mos thoni që jemi shqiptarë, po bullgarë. Të mos lemë nam të keq për shqiptarët këtu në Austri.

*** Ishte një nga ditët e para të shkurtit të vitit 1981. Përpara Pallatit të Kulturës në Tiranë, rastësisht, takova profesor *Skënder Luarsin*.

Pashë kohën — tha — që ishte kaq e bukur e me diell, pashë majat e selvive që nuk tundeshin nga era dhe thashë: Do dal! Kisha për të shpënë këto libra në bibliotekë. E përcolla për në bibliotekën e vjetër e pastaj, në kthim, deri afër shtëpisë. Ecte ngadalë e me vështirësi nga rheumatizma.

Më foli për Shekspirin, Paskon, Migjenin dhe pastaj e shtyrë prej meje, rrjedha e tregimeve erdhi te Lasgushi.

Me Lasgushin — tha — ka ndodhur diçka e çuditshme:

Kur ishte i ri, bota thoshin: Po vdes, po vdes Lasgushi... Tashi që është plak thonë: More, po rron, po rron Lasgushi! Ndërsa mua më duket se Lasgushi është bërë i përjetshëm...

*** *Mitrush Kuteli* më ka treguar:

Na kishin thirrur në një mbledhje, ne, për-kthyesve, në Ndërmarrje. Gjersa vajta unë, siç e di ti ngëc e ngëc, iku ora. Kur po ngjitnja shkallët e tmerrshme të «Mihal Durit» hyri Ministri në sallë dhe porta u mbyll. Mbeta jashtë, në korridor. Të hyja, më vinte rëndë.

E po — thashë — do të pres të bëhet pushimi dhe të hyj. Kaluan nja dhjet minuta, po ndoshta edhe më shumë, kur dëgjoj tak, tak; po vjen Lasgushi. Unë, aty, pranë portës.

Ç'po bën këtu, Pasko? — më tha. Po ja, kështu, kështu — i tregova — Hyri Ministri dhe mbeta jashtë.

Respekt i tepëruar — tha Lasgushi — dhe drang i ra derës, e hapi, përshëndeti me kokë dhe zdruq, zdruq, vajti e u ul nga fundi. Pas tij edhe

unë përfitova dhe hyra pa u vënë re, se të tërë po shikonin Lasgushin.

*** *Mitrush Kuteli*, gjithashtu më ka thënë, se në tregimin «Qetësi përpara fërtyme»¹ ka vënë dhe Lasgushin. Ja, si e kam vënë — tha:

«Ata të Çukës kthyen kokën dhe panë se po vinte një si njeri, që herë humbiste në hije, herë dilte në dritë dhe herë tje'ër kredhej midis dritës e hijes, e bëhej larush, tërë vija të bardha e të zeza.»

«Me këtë — tha Mitrushi, — kam dashur të përshkruaj atë që ka ngjarë me Lasgushin. Ai herë është sharë shumë dhe është lënë në hije, herë është lëvduar shumë dhe ka dalë në dritë, po më të shumtët e kanë paraqitur «larush» duke e sharë dhe lëvduar njëkohësisht.»

Te ky shkrim Mitrushi na jep të gjallë portretin e Lasgushit, ashtu siç ishte karakteristik për të, në lëvizje;

«... njeriu me këpucë ishte i pakët nga trupi. i zeshkët, as i ri as i vjetër. me një palë rroba allafrënga. bojë hiri, as të celura as të mbyllura, me një bastun të trashë varur në krahun e mënqjër, kundruall zemrës. kurse me të djathtën çante erën për të hapur

1) — Tregimi u botua te «Nëntori» Nr. 6 viti 1966.

*udhë. Të ecurit e kish herë më të shpejtë,
herë më të ngadalshëm, pak si me dredhka.»*

Pastaj Mitrushi përshkruan besnikërisht qëndrimin e Lasgushit ndaj njerëzve me të cilët rastësisht i qëllonte të kishte të bënte. Ashtu ishte Lasgushi: asnjëherë idiferent! E shihte tjetrin, e peshonte me një vështrim dhe me njërin sillej i përzemërt e i dashur, me tjetrin naiv e i paditur, me tjetrin i habitur e përtallës, duke e ndërruar tonin e zërit sipas rastit dhe ndër ata që do takonte; rrallëkush mund të shpëtonte pa marrë thumbin që meritonte. Më falni se u zgjata, por duhej t'i jepja këto shpjegime për t'i shijuar edhe më mirë këto që thotë aq bukur Mitrushi:

«... shikoi sa shikoi, duke zhubrosur ballin dhe, së fundi sikur u çel, u kthye përgjysmë e kuturisi t'u jepte një tunqatjetë pak si të vëngërt; ngriti dorën në kapelën gështenjë për të përshëndetur evropiançe; pastaj ktheu mendjen, uli pëllëmbën në zemër, rreku dorëzën e bastunit, e ngriti dorën shpejt në ballë allaturka, dhe tha me një zë aë herë rritej, ngrihej, trashej, pastaj holllohej, ulej e këputej, ngrihej përsëri, ndërsa ai vetë qëndronte hijerëndë, i menduar. thumbonjës...»

Mitrushi nuk ka harruar të vërë në dukje atë më të rëndësishmen e portretit të Lasgushit — svtë!

«... ndërsa sytë i flakëronin në zhubrat e zeshkëta të ballit të zeshkët, as të gjerë e as të ngushtë».

Ai nuk ka harruar të verë në dukje dhe dashurinë e madhe të Lasgushit për qenin, emrin e të cilit shpesh e përdorte si trampolin për të bërë kërcime të çuditshme në bisedë me aluzione, nëntekste e thumbime, që dinte t'i qëndiste vetëm një Lasgush.

Ja si na e përshkruan Mitrushi:

«... Kësaj here iu drejtua në fillim një konke këmbëhollë, me njolla të bardha e të zeza, me një turi të mprehtë, me ca sy finokë e të ndritur si rruaza.»

— Hajde, moj Lule e dashur, t'u themi mirë mbeçi e punë të mbarë këtyre zotërinjve agallarë e dhjetarë kryepëq e kryekatundarë, që po mbajnë kuvend për të vënë në vije punët e fshatit. — Bëri sikur qeshi e sikur desh të thosh: — «Shikoni, unë jam budalla, flas me qentë» dhe shtoi me zë të butë, të hollë, pothuaj të përzemërt: — E shikoni, zotërinj. Kjo kone është e mençme, si njeri të vjen keq t'i thuash qen».

Mitrushit nuk i ka shpëtuar dhe një aspekt tjetër i rëndësishëm i jetës së Lasgushit, i cili mbeti deri në fund i pakuptuar, ose më mirë të themi i keqkuptuar nga njerëz me nivel të ulët kulturor, keqdashës e me mentalitet të ngushtë

provincial, por që ngandonjëherë nuk ishin të pakët dhe nuk i sillnin pak shqetësime.²

Ja biseda e këtyre njerëzve, prapa krahëve të Lasgushit, ashtu siç na i jep të saktë Mit-rushi:

*«Po ky si e ka terezinë, — pyeti dikush.
— Si ta ketë? Llamba-llamba; — tha një
tjetër, — shkollë ka bërë, po s'është gjë...
Del natën e numëron yjet një nga një.³ Rri
shtrirë nën arrë e bën karrabaçka.⁴ Mirë
thonë se shkolla e tepërt të prish mendjen...
Nga larg dëgjohej zëri herë me të lutur e
herë me të kërcënuar i të zot të konës:
— Na, Lule, na! ...*

2) Në bisedën që bëra me të (shih faqet në vazhdim)
Dh.S.Shuteriqi thotë:... Por kishte dhe nga ata që e mer-
rnin nëpër gojë për disa huqe të tija. Se Lasgu-
shi ka pasur dhe huqe...

....Lasgushi shoqërohej me të gjithë, deri tek më të
thjeshtët, bile dhe me ndonjë budalla. Nga kjo
merrnin shkas disa që e kishin inat për huqet e
tij dhe e tallnin, duke thënë: Budallai me bu-
dallenjtë rri!

3) Dh.Shuteriqi po aty thotë: — Harrova të them se
Lasgushi e kishte zakon të shëtiste vetëm gjer
natën vonë.:

4) Dh.Shuteriqi — Nuk e di ishte arrë a gështenjë
a çfarë pemë ishte, po Lasgushin atje, nën hi-
jen e saj, e gjeje gjithmonë.

Aleks Buda thotë: — Ai rrinte nën hijen e një dardhe
të madhe.. (shih faqet në vazhdim)

— Lule i thënka? — pyeti dikush me të qeshur.

— Lule. I ka nxjerrë dhe këngë.

— Kones — a?

— Po, kones. Thotë se Lulja e tij është më e mirë se një njeri...

— Shiko, shiko, ç'punë bën ky

— Ky, — tha Ago Zylali. — Mendohet të marrë diellin në shoshë e ta futë brenda, për dimër. E prishi shkolla..»

Në përpunimin që i bëri këtij tregimi pak më vonë,¹ Mitrushi futi edhe veten aty ku thotë:

«Kish një shok, ore. Më të vogël. Me ca gjyzlykë. Shkonin poshtë e lartëzbraz e mbush thasë me fjalë.

Rifat i qeshi:

— Kish gjetur koka kokën. Matnin ujin e gjolit me filxhan, sa okë ka. I prishi shkolla.

— C'u bë ai tjetri?

— Humbi andej nga Vllahija, pas shkollave».

*** U takova me Profesorin Aleks Buda në kabinetin e tij në Akademinë e Shkencave ku më priti me përzemërsinë, mirësjelljen, buzëqeshjen dhe zërin e tij të ëmbël karakteristik.

Të kam premtuar — tha se do të gërreveja në kujtesën time për të gjetur diçka mbi Lasgushin.

1) Tregimi i botuar në librin: Mitrush Kuteli — Tregime të zgjedhura (STZ) Tiranë 1972 (f. 288).

Ato që gjeta janë kujtime të bukura e të largëta të kohës së rinisë sime.

Para së gjithash ato kujtime lidhen me ndjenjën e bukur, të dashur, të ëmbël që na ngjallte poezia e Lasgushit mua dhe veçanërisht motrës sime që ishte më e re. Se duhet thënë që poezia e Lasgushit adhurohej shumë nga vajzat e reja të cilat gjenin në të pasqyrimin e ndjenjave të veta erotike.

Më kujtohet, e kemi takuar atëherë Lasgushin në Pogradec, në verë, te motra e tij, që e kishte shtëpinë andej nga janë sot varrezat. Ai rrinte nën hijen e një dardhe të madhe dhe ne e shihnim me frikë, por me dashuri e adhurim.

E kam takuar dhe në Dardhë. Atëherë unë isha nja njëzet vjeç. Ndër të tjera bënim dhe bisedime filozofike mbi dashurinë, Lasgushi ishte adapt i dashurisë platonike. Dashuria, — thosh, — duhet të jetë shpirtërore dhe qëndron vetëm ajo dashuri që lind nga ndjenja për të bukurën. Dashuria nuk duhet të lindë nga ndjenjat fizike, se ajo dashuri nuk qëndron shumë dhe në mbarim të saj njeriu ndjen një *Schuldgefühl* — ndjenjë faji.

Nga gjërat që më kujtohen mbi Lasgushin vlen të përmendet kjo: Ka qenë vera e vitit 1929. Lasgushi ishte për varim në Cervenakë. Atje shkuam për ta takuar unë me disa shokë. Lasgushin e gjetëm nën hijen e një lisi të madh në mes të një lëndine në faqe të malit. Ishte një kuadër i vërtetë bukolik. Atë na priti shumë mirë dhe na gostiti me fruta ai fshatari në shtëpinë e të cilit banonte Lasgushi.

E mbaj mend fare mirë. Ishte një fshatar me rroba të vjetra, të shqyera dhe me opinga të grisura. E kam dhe tani përpara syve se si shkelte me ato opinga përmbi gurët... Kur iku ai fshatari dhe ne, të kënaqur, po bisedonim qetë-qetë, Lasgushi na pyeti:

A ju pëlqeu mikpritja e këtij fshatari?

— Po u përgjigjëm ne — shumë!

Dijeni, pra, — tha Lasgushi — se këtij burri, dje, i ka ngjarë një fatkeqësi shumë e madhe. Dje ka varrosur djalin e vetëm. Ne mbetëm të habitur e të tronditur.

Kjo nuk është thjesht mikriptja shqiptare — vazhdoi Lasgushi. Kjo është fisnikëria shqiptare e rrojtur në zemrën e popullit të thjeshtë. Ja ç'fisnikëri të madhe ka ky popull i vogël e i varfër! Pesëmbëdhjetë vjet më vonë, më 1944, gjatë luftës, unë me një grup shokësh ishim në zonën më të thellë e më të prapambetur të asaj kohe të rrethit të Elbasanit, në Vërçë, në një fshat që i thonë Gribë. Këto zëna ishin të çliruar. Ushtria partizane kishte kaluar matanë Shkumbinit dhe luftonte për çlirimin e pjesës veriore të vendit. Ishte mbrëmje. Ne na shpunë në një bazë, në shtëpi të një fshatari. I zoti i shtëpisë na priti shumë mirë, me të ngrënë dhe me muhabet. Disa nga shokët tanë kishin me vete vegla muzikore — kitara e mandolina dhe filluan t'u bien e të këndojnë. I zoti i shtëpisë mundohej të na nderonte sa më mirë. Kishim kaluar disa orë të bukura me muhabet e me këngë, kur erdhi një nga shokët e këshillit të fshatit dhe mori disa nga ne për të fjetur në një bazë tjetër.

Ndër ta isha dhe unë. Te kjo baza tjetër ai shoku i këshillit na tha se të zotit të shtëpisë ku hëngrëm e kënduam, i ka ndodhur dje një fatkeqësi, një vdekje. Vdekja është — tha ai — se i është vrarë vëllai, po është më shumë se vdekje. I vëllai, që shkoi me partizanët për të luftuar në zonat veriore, u hodh në anën e reaksionarëve dhe atje u kap e u pushkatua si tradhtar. U patëm zënë ngushtë. S'flisnim. Na vinte rëndë që kishim kënduar te ajo shtëpi ku kishte ndodhur gjithë ajo gjëmë. Në ato çaste m'u kujtua takimi i dikurshëm me Lasgushin... dhe ai fshatari... dhe fjalët aq domethënëse të Lasgushit:

«Ja ç'fisnikëri të madhe ka ky popull i vogël e i varfër!»

E kam admiruar dhe e admiroj sot poezinë e Lasgushit se ne të rinjtë e asaj kohe për herë të parë pamë tek ajo ç'mundësira të mëdhe artistike kishte gjuha shqipe.

Lasgushi ishte i pari që u ngrit artistikisht shumë më lart se poezia e Naimit dhe e Asdrenit, duke dhënë një poezi moderne, moderne në kuptimin që nga ana artistike qëndronte krahas poezisë më të mirë evropiane të asaj kohe.

Lasgushi krijoi dhe e mbylli ciklin e vet deri në vitin tridhjet. Krijimet e mëvonshme në përgjithësi s'patën bukurinë e poezive të mëparshme dhe ndonjëherë ra në manierizëm.

Pas vitit tridhjet dolën edhe më të mprehtë problemet shoqërore. Në këtë periudhë disa intelektualë që kishin angazhime politike e shanin dhe e tallnin Lasgushin që nuk shkruante për

problemet e kohës. Ata nuk kuptonin se çdo poet ka etapën e vet të krijimtarisë jashtë së cilës nuk mund të dalë. Lasgushi e kishte mbyllur këtë etapë. Kohës i duhej poezia e Migjenit.

Lasgushi në poezi dhe në jetë ishte apolitik. Atij gjithnjë i ka munguar sensi politik, por ne e çmojmë poezinë e Lasgushit për periudhën kur u shkrua. Pa poezinë e Lasgushit ne nuk do të kishim bukurinë e fjalës artistike në poezinë shqipe. Poezia e Lasgushit ishte poezi moderne në kohën e vet dhe mbetet një etapë e rëndësishme në letërsinë shqipe.

Bisedë e zhvilluar në fillim të shtatorit 1987

*** Kur i telefonova profesor *Dhimitër Shuteriqit* për ta pyetur nëse kishte mundësi të më priste për t'u konsultuar mbi një problem letrar, nuk më caktoi orë, po tha: Po deshe, eja që tani!

Pas pesë minutash isha në shtëpinë e tij: I shpjegoja me dy fjalë se ç'desha të di rreth Lasgushit. Ai u gjallërua menjëherë dhe filloi të flasë rrjedhshëm, jo si për një çështje fare të papritur, po sikur lexonte një libër të madh të hapur përpara tij. Nuk e ndërpreu ligjëratën as kur pimë kafënë, që na e solli fisnikërisht e zonja e shtëpisë, por vazhdoi kështu plot dy orë: Ai më tregoi:

Kur isha i ri, katërmbëdhjetë-pesëmbëdhjetë vjeç djalë, gjatë verës shkonim me familjen për

pushime në Pogradec. Rrinim dy-tre muaj, se dhe nga ana ekonomike nuk na kushtonte më shumë se në Elbasan.

Babai im ishte mësues i gjuhës shqipe; kishte zakon të më merrte ngado që vinte. Shkonim nëpër fshatrat e Mokrës e gjetiu. Me babanë kam shkruar dhe te Lasgushi.

Lasgushi atëherë banonte jo tek ajo shtëpia e vjetër që ka sot, po në një shtëpi të vogël në të dalë të Pogradecit në rrugën që shkon për në Korçë. Ishte një shtëpi, ku unë nuk hyra ndonjëherë brenda. Nuk hyra, se Lasgushin e gjeje gjithmonë të ndenjur shtrirë, «si Pasha», mbi disa levenxe të kuqe, të shtruar përdhe nën hijen e një peme të madhe. Nuk e di, ishte arrë a gështenjë a çfarë pemë ishte, po Lasgushin atje, nën hijen e saj e gjeje gjithmonë. Me babanë kemi shkruar shumë herë.

Pogradeci ishte qytet i vogël dhe kishte disa intelektualë ndërsa mjaft të tjerë vinin për të kaluar verën. Atëherë, kurioziteti i Pogradecit ishte Lasgushi dhe shumë nga këta intelektualë do të vinin tek ai patjetër për ta takuar.

Ndër ata që shkonin më shpesh dhe që Lasgushi kishte miqësi, ishte një mjek nga Elbasani, Filip Papajani quhej. Ishte mjek, por edhe shkruante. Nuk kishte talent të vërtetë letrar, po shkruante në disa gjini. Pati nxjerrë gazetën demokratike «Shkumbini» në Elbasan,

shkroi një dramë për Moisi Golemin, shkroi tregime etj. Shkrimet e tij në gazetë kanë ndo-
një vlerë gjuhësore, po më shumë kanë vlerë
për rrahjen e problemeve politike të kohës.
Shkrimet i shtypte me paret e veta, në shtyp-
shkronjën e Dhori Kotit, në Korçë. Lasgushi
kishte miqësi me Filipin, se ky ishte mjek, kurse
poeti mendonte dhe qe sëmurë. Në këtë kohë,
për të mbledhur para për Lasgushin, që të mje-
kohej në Austri u dhanë dy-tre koncerte në
Korçë, në kinema «Majestik». Këndoi Tefta
Tashko, e shoqëruar nga një pianist francez,
mësues në Lice. Winkler-i. Salla ishte plot. Unë,
meqënëse e njihja muzikën, i ktheja fletët e
partiturave pianistit.

Nuk di në shkante te Lasgushi dhe Kostaq
Cipoja, që ishte dhëndër i Filip Papajanit, po
mua nuk më ka rastisur ta shoh atje. Besoj se
duhet të ketë shkruar; prapë e them me rezer-
vë, se Cipoja ishte njeri pak i shoqëruar. Ishte
me kulturë të gjerë, kishte mbaruar gjimnazin
në Shëmitër Koronë tek arbëreshët dhe uni-
versitetin si nxënës i një linguisti të madh ita-
lian të asaj kohe në Bolonjë, Ribezzo. Ishte i
pajisur me një kujtesë jo të zakonshme. Nuk
mund të them që e dinte të gjithë «Komedinë
Hyjnore» përmendësh, po këngë të tëra të saj
i recitonte. Në klasë na fliste shpesh për Dan-
ten, De Radën, Naimin.

Ndër intelektualët që e vizitonin Lasgushin,
ishte Mitrush Kuteli. Ai atëherë vazhdonte uni-
versitetin në Rumani. Familja e Mitrushit, si
dhe ajo e Lasgushit, ishte me tradita patriotike.

I ati, Pandi Paskoja, sillte nga Rumania e Bullgaria, fshehtas, libra shqip, dhe, — si më thosh babai im, — e kishte vënë kokën në rrezik në kohën e Turqisë. Fundi i tij ka qënë tragjik. U dogj me gjithë shtëpinë nga italianët. Mitrushi ka meritën e madhe që i botoi poezitë e Lasgushit, se, të ishte për Lasgushin, edhe sot e kësaj dite ato mund të ishin të shpërndara nëpër gazetatat e revistat ku u patën botuar. Ai shkroi dhe një studim kritik mbi poezinë e Lasgushit që, me gjithë teprimet, është shkruar me dashuri dhe ka plot gjëra me vlerë.

Lasgushi dhe Mitrushi janë dy figurat e shquara që i dha Pogradeci letërsisë shqiptare. Mitrushi nuk është i lartësisë së Lasgushit, por është nga tregimtarët tanë më të parë e më të mirë. Unë isha në Francë, për studime, kur mora vesh se u botuan «Netët Shqiptare», të Mitrushit. Shkrova në Shqipëri dhe ma dërguan. «Netët Shqiptare», pra, i lexova në Francë, dhe më mallëngjyen, aq më pëlqyen. Kështu më pëlqen dhe sot proza e tij.

Nga koha e viteve 30 më kujtohet një ndodhi që tregon karakterin e fortë të Lasgushit. Në Pogradec kishte ardhur si nënprefekt një dhëndër i Shefqet Vërlacit. Nënprefekti për atë qytet të vogël dhe duke qënë dhëndri i Vërlacit, ishte figurë me rëndësi dhe mjaft intelektualë shkuan i bënë nga një vizitë kortezie. Lasgushi nuk shkoi. Doktor Filipi, duke biseduar me poetin, i thotë:

E more vesh që na ka ardhur një nënprefekt i ri?

Lasgushi — Po, po, e mōra.

Doktori — E, po duhet t'i bësh një vizitë. Të gjithë i kanë shkuar...

Lasgushi — Nënprefekti shkon te poeti, jo poeti te nënprefekti, doktor!

Pas ca kohe, nënprefekti shkoi për vizitë te Lasgushi.

Këto qëndrime të Lasgushit bënë që ai të përmendej shpesh në bisedat e njerëzve, po kishte dhe nga ata që e merrnin nëpër gojë për disa huqe të tij, se Lasgushi ka pasur dhe huqe.

Mbante gjithmonë një qen, Lolkën. Kur ky ngordhte, i zoti e varroste me ceremoninë e një të vdekuri dhe pastaj merrte një tjetër qen, që e quante përsëri Lolkë.

Lasgushi kishte qejf të vriste rabecka me llastikë, si çunat e vegjël. I vriste rabeckat, i piqte dhe i hante me gjithë kocka. Lasgushi shoqërohej me të gjithë deri tek më të thjeshtët bile dhe me ndonjë të marrë. Nga kjo gjë merrnin shkas disa, që e kishin inat për huqet e tij dhe deshën ta tallnin, duke thënë: «Budallai me budallenjtë rri!»

Siç të thashë, unë atëherë isha nja pesëmbëdhjetë vjeç, nxënës në Liceun e Korçës. Frëngjishten e kisha mësuar mirë. Lexoja shumë, si Balzakun si Dymanë, Hygo-në si Verharerin dhe do të bija në kontakt me poezinë e madhe botërore kur fillova të shkruaj poezi, kjo që akoma poezi me nimfa, zana, figura mitologjike, ashtu siç i mësonim në shkollë. Babai im e kishte marrë vesh që shkruaja vjersha dhe, pa e ditur unë, disa prej tyre ia jep Lasgushit

për t'i parë. Një natë, nënën time e pati zënë dhimbje e fortë barku. Afër mezit të natës unë shkova tek e vetmja farmaci që ishte në Pogradec. Zgjova farmacistin, më përgatiti barnat dhe u ktheva me nxitim për në shtëpi. Rrugës takova Lasgushin. Lasgushi e kishte zakon të shëtiste me Lojkën gjër natën vonë, derisa shuheshin dritat elektrike të rralla, se atëherë ishte ngritur një hidrocentral i vogël për qytetin. Atje ku u takuam, më tregoi se i kishte lexuar poezitë e mia dhe më tha se «ka ikur koha» e zanave, e shtojzavalleve dhe e figurave mitologjike në poezi. «Duhet poezi e kohës.» Dhe nxori nga xhepi i brëndshëm i xhaketës një poezi të vetën, të kopjuar për mua në një letër të asaj kohe me vija dhe me shkrimin e tij me kaligrafi të bukur. Ishte vjersha «Vallja e luleve», ajo që fillon me vargjet:

Vijnë vashat valle-valle

Gush' e gji stolisura..,

Atë fletë e kam rojtur tërë jetën dhe është diku këtu në dokumentat e mia. Ndejtëm duke folur për poezinë gati gjysmë ore, deri sa u kujtua të më pyeste se ç'desha jashtë në atë orë aq të vonë. Kur i tregova arsyen, e preu bisedën dhe më tha të shkoja shpejt në shtëpi.

Me këtë që tregova dua të them se unë, mësimin e parë mbi poezinë e vërtetë, e kam marrë nga Lasgushi.

Lasgushi, për nga formimi i tij, është rilindës, sepse, që në vogëli, jetoi në një ambient familiar e shoqëror që kishte idealet dhe akti-

vitet në favor të Rilindjes. Për këtë e ndihmuan dhe disa kushte;

Që i ri, ai u ndodh në Greqi, në kohën kur zhvillohej luftë e ashpër ndërmjet dy palëve kundërshtare, asaj që ishte me mbretin dhe tjetrës që ishte e forcave demokratike. Shkoi në Rumani, ku ra në kontakt me patriotët e kolonisë shqiptare të Bukureshtit, sekretar i së cilës pati qenë dhe vetë. Shkoi në Austri, në kohën kur ishte shthurur perandoria austrohungareze dhe Austria kishte mbetur një shtet i vogël demokratik.

Lasgushi, i bëri të vetat, për gjithë jetën, dy vetitë e çmuara të rilindësve: si ata, ai ishte dhe mbeti demokrat patriot. Ai interesohej dhe dinte shumë gjëra rreth figurave të shquara të rilindjes. Lasgushi ka një meritë tjetër të madhe që e afron me rilindësit. Ai e deshi dhe e çmoi shumë veprën e Naimit, po dhe u mbrujt me idealet e saj. Naimit i kushtoi dy poezi të bukura. Atë që fillon me vargun:

*«Në çetete të kujtimit që dhëmkoset pak-
-nga pak...»* dhe tjetrën që fillon me vargun:

Ku psherëtin dëshir' e djegur.,»

Dy figura të tjera të letërsisë sonë, Faik Konica dhe Noli, nuk e vlerësuan veprën e Naimit. Faiku botonte revistën «Albania» që lojti dhe një rol pozitiv. Ajo financohej nga Austro-hungaria dhe kish për qëllim të tërhiqte patriotët tanë në anën e saj, po shumicë, ishin ata që ndiqnin një rrugë patriotike të shëndoshë dhe përparimtare. Asdreni për shëmbull shkroi

te kjo revistë artikullin kundër oxhakësisë (bejlerëve).

Faiku kishte kulturë të gjerë, po jo dhe kaq të thellë; ai kishte kulturë enciklopedike. Shqipen e shkruante vërtetë bukur. Naimin nuk e vlerësoi, madje e përçmoi duke e tallur për rimat, që i bën — thotë — me Ta, Ta, Ta e Ti, Ti, Ti. Faiku harronte se Naimi ishte poet që mund të bënte vjersha të bukura si kjo:

*Vera vate, shkoi,
Bilbili pushoi,
Lulet u thanë...*

no misioni i Naimit ishte më i lartë sesa të bënte vetëm poezi.

Fan Noli ishte me kulturë të gjerë, po dhe të thellë. Në krahasim me Faikun, ai është disa pashë — disa pashë të mira, — më lart. Tan po lexoj veprat e plota të Nolit; ja, po përfundoj vëllimin e dytë, por emrin e Naimit ende nuk e kam gjetur të përmendet! Faiku dhe Noli çmonin shumë Kristoforidhin, që kishte luajtur rol të veçantë me përkthimet e tij dhe me fjalorin. Lasgushi, në bazë të regjistrit kishtar, është i datëlindjes 1896. Katër vjet më i madh nga ç'thuhet. Sivjet ai mbush 91 vjet: Këto dy-tre vjet nuk e kam takuar. Kur e takova herën e fundit, vura re që në bisedim përsëriste të njëjtat gjëra, po më parë me të mund të bisedoje për çdo problem letrar e filozofik.

Lasgushi është njeri «omnikultur». Dinte me rrënjë greqishten, se bëri shkollën fillore në Pogradec dhe jetoi në Greqi; gjuhën franceze,

se bëri lyce frances; gjermanishten se jetoi dhe bëri shkollën e lartë në Austri. Italishten e kishite mësuar. Me siguri ka pasur njohuri mbi sllavishten meqë bëri disa vjet në gjimnazin e Manastirit. Ishte, pra një poliglot, që i lexoi në origjinal poetët e mëdhenj, kur ishte i ri.

Fan Noli vërtet përktheu që herët «Skënderbeun e Longfeleout, Annabel-Lee-në e ndonjë tjetër, po vjershat e tij më të mira i ka pas disfatës së Revolucionit të njëzetë e katrës, mësimëve që nxori prej tij dhe autokritikës që bëri.

Deri në vitet 1924-25 Lasgushi ishte formuar plotësisht si poet dhe krijimtaria e tij më e mirë i përket kësaj periudhe. Më vonë vazhdoi të botojë herë-herë ndonjë vjershë, por vjershat nuk ishin më në lartësinë e të parave dhe ne, kur i lexonim, nuk na kënaqnin. Me këtë dua të them se Lasgushi, si poet, vjen përpara Fan Nolit në kohë.

Për Lasgushin, në kohën e Zogut, gazetat shkruanin shpesh. Shkruanin adhuruesit e poezisë së tij pavarësisht se kush ishin ata, por Lasgushi që u bë kaq i njohur e i çmuar, mbeti një mësues i thjeshtë vizatimi. Kjo kështu edhe i pëlqente, se i linte kohë të lirë. Odise Paskali kishte miqësi me Lasgushin. Çudi si nuk i bëri një portret, se Lasgushi ka fytyrë skulpturike. Unë i kam bërë disa portrete. Vizatimet e mia të shpejta janë përshtypje çasti nga një fytyrë që më ishte familjare.

Gjatë Luftës, Lasgushi bëri një gjë shumë të mirë. Kur u bë lufta e Pojskës në Korrik 1943, ai ndodhej në Pogradec dhe mblodhi pastaj

gjithçka që thuhej rreth asaj lufte. Edhe mua më ka pyetur. Për këtë luftë ai shkroi poemën kushtuar Reshit Çollakut dhe një vjershë për vëllanë e Reshitit.

Kur u krijua Lidhja e Shkrimtarëve, Lasgushi që ndër anëtarët e parë të saj. Shkroi dhe poezi me temën e punës për ndërtimin e socializmit. U përpoq të ecë në këtë rrugë, pavarësisht nga rezultatet. Nuk mund të harrohet kontributi i Lasgushit në përkthimet. Duhet thënë se nuk e ka të fortë dellin e përkthyesit, dhe «Lasgushëron» si tepër nganjëherë, po megjithatë, ai na dha të përkthyer vepra kapitale nga letërsia botërore: «Eugjen Onieginin», poezi të Hajnes, Gëtes, Majakovski dhe poezi nga shumë të tjerë, disa herë qëlluar mirë: -

Unë e kam dashur dhe e dua shumë poezinë e Lasgushit. Flas për poezinë e mirë të tij, se ka dhe vjersha që më duken të dobta. Lasgushi bashkë më Seremben — që pati atë fat aq tragjik — mund të them se janë nga lirikët tanë më të mirë. Përveç kësaj, Lasgushi ka gjuhën e vet në poezi. Në «Historinë» e parë të letërsisë shqiptare, si dhe në botimin e poezive të Lasgushit që bëri Myzafer Xhaxhiu, të cilat dolën në kohën kur për poezinë shtroheshin detyra të reja, krijimtarisë së Lasgushit i janë vënë në dukje edhe disa të meta. Në «Historinë» e re të letërsisë shqiptare, vlerësimi i Lasgushit është bërë më i plotë, po unë mendoj se ende nuk i kemi dhënë vendin që meriton.

Tani lexova një shkrim të Fatos Arapit për Lasgushin. Fatosi këtë radhë është nxituar:

Lasgushi si poet lirik e zotëroi të gjithë periudhën midis dy luftërave. Nga fundi doli Migjeni, që u lexua relativisht pak, se nuk qarkulloi dot vëllimi i tij. Migjeni u njoh, u përhap dhe lexohet më shumë pas çlirimit. Lasgushi do të lexohet përherë shumë.

Bisedë e zhvilluar në shtator 1987.

Mjeku Misto Marko nga Pogradeci, i njohur me pseudonimin letrar Mirosh Markaj, ishte mjeku personal vullnetar i Lasgushit në muajt e verës e të vjeshtës, që ai i kalonte në Pogradecin e tij të dashur.

Mistoja, ose më mirë «Doktor Mistoja» — siç e thërriste Lasgushi — më ka treguar:

«Një pasdite, aty nga ora 3. më trokiti në derë Llazar Siliqi. U përshëndetëm dhe unë e ftova të hyjë brenda.

— Nuk kam kohë — më tha. Kam ardhur në «Albturist» me Rita Bumi Papën dhe të shoqin. Niko Papën. Në ora 6 të më sjellësh Lasgushin...

Kur e ftonin në takime të tilla, Lasgushi mezi bindej, por emri i Llazarit, kisha besim, se do të më ndihmonte. Pranova menjëherë dhe u nisa për në shtëpinë e Lasgushit. U morëm vesh lehtë, siç e kisha parashikuar.

Në ora 6 pa një çerek shkova ta marr. Lasgushi ishte gati, i veshur me kostumin e zi, «të përjetshmin», bastunin në krahun e majtë, kalorthi. Nisemi për në takim pa u nxituar... Me t'u qasur «Albturistit» vumë re se miqtë

kishin dalë të na presin te dera. Nja tri-katër metra larg tyre Lasgushi u ndal menjëherë në vend dhe recitoi greqisht:

*Në tokën e djegur të Psarasë
Zbriti Lavdia, që të numërojë të rënët.
Në krye kishte thurrur një kurorë
Me ato pak fije bari, që mbetën nga zjarri.*

Ishte vjersha e poetit grek Solomos për ishullin heroik të arbëreshëve. Miqtë, Rita Bumi Papa dhe i shoqi, të befasuar ngritën duart përpjetë me gëzim dhe zbritën nga shkallët ta përqafojnë Lasgushin.

Jo vetëm në ato grima, por dhe në orët e vona dhe të nesërmen, Lasgushi i mrekulloi miqtë.»

Poeti Llazar Siliqi më ka thënë:

Poezia e Lasgushit është në vazhdën e poezisë së Rilindies, një vazhdim i mëtejshëm i saj.

Për krijimtarinë e Lasgushit është folur shumë dhe shpesh është vënë theksi te të metat dhe te poezitë e dobta, veçanërisht tek ato të botuara në «Tomorri i vogël», që janë pa vlera, me ato rimat hije-fije, ku një poet i kalibrit të Lasgushit duket sikur tallet.

Kur flasim për një poet si Lasgushi, duhet të përmbledhim poezinë e tij më të mirë, jo poezitë e dobta për të cilat mund të flitet kallimthi në ndonjë monografi të gjatë.

Si shumë artistë edhe Lasgushi ka të meta: Disa, ndoshta, i ka më të theksuara, por ai që

shkruan biografi nuk ka pse t'i theksojë. Ja, lexojmë biografinë e Bethovenit që ka shkruar Fan Noli. Është një vepër e madhe, që mund ta shkruante vetëm një njeri i madh si Fan Noli, por mua nuk më vjen mirë kur vihen në dukje të metat e karakterit të tij, se te gjenitë njeriu kërkon të gjejë shembuj të përkryer.

Në kohën e Zogut për Lasgushin u shkrua shumë, por nga adhuruesit dhe dashamirësit e poezisë së tij, jo nga regjimi.

Lasgushi është tip i veçantë. Më kujtohet, njëherë, ishte muaji i letërsisë dhe unë me shokët Fatmir Giata e Niko Nikolla shkuam në Pogradec për të zhvilluar aktivitet me këtë rast. Ne do të shkonim për të folur dhe recituar përpara nxënësve të shkollës «Reshit Çollaku» dhe unë u propozova shokëve që të merrnim dhe Lasgushin. Shokët, në fillim, nguruan, se thanë ata — nuk të vjen Lasgushi. Megjithatë shkuam dhe e thirrëm. Ai, u vesh menjëherë dhe erdhi me gëzim. Në fillim foli unë. Kur i prezantova shokët thashë: Kemi nderin që mes tonë ndodhet dhe poeti i mirënjohur dhe bashkëqytetari juaj Lasgush Poradeci. Lasgushit iu bë qejfi dhe atje recitoi baladën për Reshit Çollakun me një zë kumbues. Atë ditë e ftuam për drekë, Lasgushi nuk deshte të vinte se është tepër krenar, nuk pranon ta qirasë njeri, megjithatë arritëm ta bindnim. Atë ditë piu dhe një gotë verë. Me sa duket nuk e mbante dot verën. Më kujtohet si iu skuqën ato mollzat e kërcyera të faqeve dhe filloi të fliste për poezinë. Ne nuk e

kishim idenë që Lasgushi të lexonte dhe të ishte i informuar për poezinë që botohej te ne. Atje na habiti.

Bisedë e zhvilluar në Shtator 1987.

*** *Piktori Nexhmedin Zajmi më ka thënë:*

Lasgushin e kam njohur; por miqësi nuk kam pasur. Bisedonim ngandonjëherë për pikturën; se Lasgushi ka studiuar dhe për pikturë. E pëlqen pikturën klasike.

Kur u hap shkolla e Artit në Tiranë më 1936. Drejtor ishte Odise Paskali, ndërsa Lasgushi jepte Historinë e artit. Më kujtohet, — atëherë rrinin e shëtisnin bashkë Odiseja, Skënder Luarasi dhe Lasgushi. Këta të dy, Skënderi me Lasgushin bënë shpesh diskutime të zjarrita. Nuk ishte e lehtë t'i qëndroje në diskutime Skënder Luarasi, po Lasgushi ishte i fortë, nuk dorëzohej lehtë dhe kur i dukej se fitonte thërriste:

Dorzohu, Skënder, se ta ngula shpatën mu në gjoks.

Në këto raste ndërhynte gjithnjë Odiseja dhe i qetësonte gjakrat. Vajza ime bëri temën e diplomës mbi Androniqi Zengon, si grua e parë piktores në Shqipëri.

Më kujtohet, në kohën e Zogut, në Tiranë, ajo hapi një ekspozitë me punime të sajat në Kafe «Berlini», që ishte aty në fillim të rrugës së Dibrës.

Atëherë ajo rrinte përpara kafes dhe i ftonte

njerëzit që kalonin rrugës: Urdhëroni, urdhëroni të shihni pikturat!

Kalimtarët e shihnin të habitur. Ç'thotë kjo grua?

Për këtë ekspozitë Lasgushi shkroi një artikull. Vajza ime e lexoi, se i duhej për temën e diplomës dhe tha:

Çudi! Duket sikur është shkruar sot.

Shtator 1987

— Mjekja Afërdita Gusho, fis me Lasgushin, më ka thënë se kishte dëgjuar nga i ati, që A. Zogu i paskësh dërguar Lasgushit dhjetë napolona flori për t'i shtuar ky poezisë «Marshi i djalërisë» edhe një stroftë kushtuar Zogut, si «prijës i djelmnis shqiptare.»

Lasgushi ia paska kthyer mbrapsht të dhjetë napolonat bashkë me këto katër vargje:

*E ku mundet një poet,
Me një copkë poezi,
Të të lëvdojë ty, o mbret,
Që bërë një mbretëri!*

Ata pak veta, që e kanë njohur Lasgushin nga afër, e dinë se sa të holla, të hidhura e shkatërrimtare ishin thumbat e Lasgushit, të cilat tjetri i ndiente se sa i thernin e s'mund të bënte gjë.

Një thumb të tillë paska marrë dhe mbreti me këto katër vargje!

P A S T H Ë N I E

Po mbaronte viti 1985, kur mbylla faqen e fundit të dorëshkrimit të këtij libri. Atëhere Lasgushi jetonte, vija më shpesh, por s'guxova t'i thosha ç'kisha bërë. Dorëshkrimin atëhere e lexuan vetëm disa miq të mi e adhures të poetit. Ata më përgëzuan me fjalë të ngrohta por, në sfondin e shprehjeve dhe të vështrimeve të tyre, ndjeja një keqardhje; Kushedi se kur mund t'i vijë dita të botohet... Vdekja e Lasgushit e lehtësoi disi punën. Mjegullat artificiale rreth tij filluan të davariten dhe interesimi për të u shtua se, për shumë veta, Lasgushi lindi kur vdiq. Ose më mirë të them, pas vdekjes së tij, pas varrimit zyrtar, pas botimit në gazetën «Drita» të fjalëve lavdëruese për të dhe të fotografisë së tij bashkë me dy tutorë — censorë të letërsisë së realizmit socialist, adhuresit e poetit s'kishin më drojtje të flisnin.

Në numërin 12/1977 të revistës «Nëntori» munda të jap njoftimin për ekzistencën e këtij libri dhe megjithë ngurimin e shkurtimet arrita të botoj disa fragmente. Ato u pritën me interesim e dëgjova plot fjalë lavdëruese e inkurajuese. Pastaj heshtje... Dikush, që i shkonte fjala, tha se «u interesua» për botimin e librit. Trokita disa herë në portën e shtëpisë Botuese «Naim Frashëri», por atje ishin shurdhuar. Po kështu te

Shtëpia Botuese «8 Nëntori». Më në fund më 12 dhjetor 1989 munda ta dorëzoj për botim te kjo shtëpi Botuese. U bënë dy recenca me një faqe lëvdata e dy faqe vërejtje dhe libri u sabotua, nuk u botua. Ndërkohë shumë adhurues e dashamirës të poetit shpesh më pyesnin:

Ç'bëhet me librin? U tregoja shkurtimisht odisenë e tij, iknin të mërzhitur, por askush nuk lëvizi as gishtin për të ndihmuar në botimin e tij. Për fat të keq, kjo është bota kulturore shqiptare... Tani, që u arrit të dalë ky libër, ndjej një gëzim të veçantë, se Lasgushi do të mundë t'u flasë dhe atyre që nuk e njohën. Gëzimi im do të ishte edhe më i plotë sikur ky të mos ishte i fundmi me shkrime e kujtime për Lasgushin.

Një ditë ndoshta do të kemi kënaqësinë të shoqim të vendosura bukur nëpër vitrinat e shtëpisë muze të tij, të gjitha gazetatat, librat e revistat ku është shkruar për të. Në raste përvjetorësh do të dëgjohen zëra kumbues të nxënësve e studentëve që recitojnë poezitë e tij, ndërsa shtëpia do të jetë e mbushur me tingujt e këngëve «Kroji i fshatit tonë» apo «E mora shoqezën përkrah». Atëhere do të ushtojnë furrishëm dallgët e liqerit e do të jehojnë vargjet e Emineskut:

*«Ai është prapë, megjithëse s'është,
I vdekur ndrit gjithmonë»*

Kolevica, Petraq.

Lasgushi më ka thënë...: (Shënime
nga bisedat me Lasgush Poradecin)
(Petraq Kolevica; Red.: F. Idrizi. —
T. 8 Nëntori. — f. 240 : me il.: 20 cm

891.983-94

K. 82

Tirazhi 8000 kopje Formati 49x78/16 Stash 2204-82

Shtypur Shtypshkronja «TIRANA» Tiranë, 1992

